<p data-bbox="401 337 527 402" style="text-align: center;">Neni 124 Detyrimi</p> <p data-bbox="186 448 737 699">1. Kushtet e përgjithshme të caktuara nga ana e një palë kontraktuese, qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale apo të referuara nga kontrata, përbëjnë marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve kontraktuese në të njëjtën kontratë dhe si rregull janë njësoj detyruese.</p> <p data-bbox="186 776 737 878">2. Kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të shpallen sipas mënyrës së zakonshme.</p> <p data-bbox="186 922 737 1065">3. Kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese në rast se kanë qenë të njohura për te ose është dashur t'i njihje në rastin e lidhjes së kontratës.</p> <p data-bbox="186 1109 737 1247">4. Në rast të mospërputhjes ndërmjet kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjeve të veçanta, vlejné këto të fundit.</p>	<p data-bbox="961 337 1108 402" style="text-align: center;">Article 124 Obligation</p> <p data-bbox="760 448 1310 735">1. The general terms and conditions set out by one contracting party, whether contained in a formulaic contract or referred to by the contract, shall supplement the special agreements between the contracting parties in the same contract and shall as a rule be equally binding.</p> <p data-bbox="760 779 1310 881">2. The general terms and conditions of a contract must be published in the customary manner.</p> <p data-bbox="760 925 1310 1063">3. The general terms and conditions shall be binding for a contracting party that knew or should have known thereof when the contract was concluded.</p> <p data-bbox="760 1107 1310 1209">4. If there is any discrepancy between the general terms and conditions and the special agreements the latter shall prevail.</p>	<p data-bbox="1545 337 1671 402" style="text-align: center;">Član 124 Obaveza</p> <p data-bbox="1333 448 1883 699">1. Opšti uslovi određeni od strane jednog ugovarača, bilo da su sadržani u formularnom ugovoru, bilo da se na njih ugovor poziva, smatraju se posebnom pogodbom utvrđenom među ugovaračima u istom ugovoru, i po pravilu obavezuju kao i ove.</p> <p data-bbox="1333 776 1883 846">2. Opšti uslovi ugovora se moraju objaviti na uobičajeni način.</p> <p data-bbox="1333 922 1883 1024">3. Opšti uslovi obavezuju ugovornu stranu ako su joj bili poznati ili morali biti poznati u času zaključenja ugovora.</p> <p data-bbox="1333 1101 1883 1170">4. U slučaju neslaganja opštih uslova i posebnih pogodbi važe ove poslednje.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 125 Nuliteti i disa dispozitave të kushteve të përgjithshme</p> <p>1. Janë nul dispozitat e kushteve të përgjithshme që janë në kundërshtim me vetë qëllimin e kontratës së lidhur ose me praktikën e mirë afariste, qoftë edhe kur kushtet e përgjithshme brenda të cilave bëjnë pjesë të jenë miratuar nga autoriteti kompetent.</p> <p>2. Gjykata mund të refuzojë zbatimin e disa dispozitave të kushteve të përgjithshme që e privojnë palën tjetër nga e drejta për të bërë kundërshtime ose apelim, ose të dispozitave në bazë të të cilave pala humbë të drejtën nga kontrata ose afatet, ose përndryshe janë të padrejta apo tepër rigorozë ndaj palës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 125 Nullity of certain general terms and conditions</p> <p>1. Any provisions of general terms and conditions that oppose the actual purpose for which the contract was concluded or good business customs shall be null and void, even if the general terms and conditions they are contained in were approved by the relevant authority.</p> <p>2. The court may reject the application of individual provisions of general terms and conditions that remove another party's right to object or appeal, or provisions based on which a party loses contractual rights or deadlines or that are otherwise unjust or too strict for the party.</p>	<p style="text-align: center;">Član 125 Ništavost nekih odredbi opštih uslova</p> <p>1. Ništave su odredbe opštih uslova koje su protivne samom cilju zaključenog ugovora ili dobrim poslovnim običajima, čak i ako su opšti uslovi koji ih sadrže odobreni od nadležnog organa.</p> <p>2. Sud može odbiti primenu pojedinih odredbi opštih uslova koje lišavaju drugu stranu prava da stavi prigovore, ili onih na osnovu kojih ona gubi prava iz ugovora ili gubi rokove, ili koje su inače nepravične ili preterano stroge prema njoj.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 126 Kolizioni në mes të kushteve të përgjithshme</p> <p>1. Nëse palët kanë arritur marrëveshje përveç se oferta dhe pranimi i saj i referohen kushteve të përgjithshme të cilat janë në kolizion në mes tyre, kontrata megjithatë konsiderohet e lidhur. Kushtet e përgjithshme janë pjesë e kontratës deri në atë masë sa janë të përbashkëta në substancë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 126 Collision between general conditions</p> <p>1. If the parties have reached an agreement where the offer and the acceptance of offer refer to the general conditions, which are in collision with each other, the contract shall be considered as entered into. The general conditions are part of contract to the extent they are common in their</p>	<p style="text-align: center;">Član 126 Sukob između opštih uslova</p> <p>1. Ako stranke su postigle sporazum, osim što se ponuda i njeno prihvatanje odnose na opšte uslove koji su u medjusobnoj, ugovor se ipak smatra zaključenim. Opšti uslovi su deo ugovora do te merei koliko su zajednički u suštini.</p>



<p>2. Sidoqoftë nuk mund të lidhet kontratë nëse njëra palë:</p> <p>2.1. Paraprakisht ka bërë me dije, në mënyrë shprehimore, dhe jo përmes kushteve të përgjithshme, qëllimin e saj për të mos qenë pjesë e kontratës në bazë të paragrafit 1. të këtij neni; ose</p> <p>2.2. Pa vonesë të panevojshme, njofton palën tjetër për qëllimin e tillë.</p> <p>VIII. CEDIMI I KONTRATAVE</p> <p>Neni 127 Kushtet e cedimit</p> <p>1. Secila palë në kontratën dypalëshe mundet po qe se për këtë jep pëlqimin pala tjetër t’ia cedojë kontratën personit të tretë i cili me këtë gjë bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tij që dalin nga kjo kontratë.</p> <p>2. Me cedimin e kontratës, marrëdhënia kontraktuese ndërmjet ceduesit dhe palës tjetër kalon në pritësin dhe në palën tjetër në momentin kur pala tjetër ka pranuar cedimin; në rast se pëlqimi është dhënë më parë, cedimi konsiderohet se ka</p>	<p>substance.</p> <p>2. The contract cannot be concluded if one of the parties:</p> <p>2.1. Preliminarily has made it known explicitly and not through the general conditions his intention not to be part of the contract under paragraph (1) of the present article; or</p> <p>2.2 Without delay, he notified the other party about such intention.</p> <p>VIII. TRANSFER OF CONTRACT</p> <p>Article 127 Conditions for transfer</p> <p>1. Either party to a bilateral contract may transfer the contract to a third person, who shall thereby become the holder of all the former’s rights and obligations deriving from the contract, if the other party consents there to.</p> <p>2. Via the transfer of a contract the contractual relationship between the transferring party and the other party shall pass to the recipient and the other party when the other party consents to the transfer; if the consent is given in advance</p>	<p>2. Međutim, nijedan ugovor ne može biti zaključen ako jedna strana:</p> <p>2.1. Unapred je izričito stavila k znanju, a ne kroz opšte uslove, svoju nameru da ne bude deo ugovora na osnovu stava (1) ovoga člana, ili</p> <p>2.2. Bez nepotrebnog odlaganja, obavesti drugu stranu o toj nameri.</p> <p>VIII. USTUPANJE UGOVORA</p> <p>Član 127 Uslovi ustupanja</p> <p>1. Svaka strana u dvostranom ugovoru može, ako na to pristane druga strana, ustupiti ugovor nekom trećem licu, koje time postaje nosilac svih njenih prava i obaveza iz tog ugovora.</p> <p>2. Ustupanjem ugovora ugovorni odnos između ustupioaca i druge strane prelazi na prijemnika i drugu stranu u času kad je druga strana pristala na ustupanje, a ako je druga strana dala svoj pristanak unapred, u času kad je obavještena o ustupanju.</p>
---	---	---



<p>ndodhur kur pala tjetër është njoftuar për cedimin.</p> <p>3. Pëlqimi për cedimin e kontratës është i vlefshëm vetëm në rast se është dhënë në formën e parashikuar me ligj për lidhjen e kontratës së ceduar.</p> <p>4. Kuptimi i dispozitave të të drejtave të palëve në lidhje me kontratën e marrjes përsipër të borxhit vlen edhe ndaj cedimit të kontratave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 128 Përgjegjësia e cedentit</p> <p>1. Cedenti i përgjigjet cesionarit për vlefshmërinë e kontratës së ceduar.</p> <p>2. Ai nuk i garanton se pala tjetër do t'i përmbushë detyrimet e saja nga kontrata e ceduar, përveç nëse për këtë është detyruar veçanërisht.</p> <p>3. Ai nuk i garanton po ashtu palës tjetër se cesionari do t'i përmbushë detyrimet nga kontrata, përveç nëse për këtë është detyruar veçanërisht.</p>	<p>the transfer shall be deemed to take place when the other party is notified of the transfer.</p> <p>3. Consent to the transfer of a contract shall only be valid if given in the form prescribed by law for the conclusion of the transferred contract.</p> <p>4. The meanings of the provisions on parties' rights in connection with a contract on takeover of debt shall also apply to the transfer of a contract.</p> <p style="text-align: center;">Article 128 Transferring party's responsibilities</p> <p>1. The transferring party shall be liable to the recipient for the validity of the transferred contract.</p> <p>2. The transferring party shall not guarantee to the recipient that the other party will perform the other party's obligations deriving from the transferred contract, unless the transferring party specifically undertakes to do so.</p> <p>3. The transferring party shall not guarantee to the other party that the recipient will perform the contractual obligations, unless the transferring party specifically undertakes to do so.</p>	<p>3. Pristanak na ustupanje ugovora je punovažan samo ako je dat u formi u zakonu propisanoj za ustupljeni ugovor.</p> <p>4. Odredbe o sporednim pravima u vezi sa ugovorom o preuzimanju duga shodno će se primeniti i na ustupanje ugovora.</p> <p style="text-align: center;">Član 128 Odgovornost ustupioaca</p> <p>1. Ustupilac odgovara prijemniku za punovažnost ustupljenog ugovora.</p> <p>2. On mu ne jemči da će druga strana ispuniti svoje obaveze iz ustupljenog ugovora, osim ako se na to naročito obavezao.</p> <p>3. On isto tako ne jemči drugoj strani da će prijemnik ispuniti obaveze iz ugovora, osim ako se na to naročito obavezao.</p>
---	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 129 Kundërshtimet</p> <p>Pala tjetër mund t'i paraqes cesionarit të gjitha kundërshtimet nga kontrata e ceduar, si edhe ato që i ka nga marrëdhëniet tjera me të, por jo edhe kundërshtimet që i ka ndaj cedentit.</p> <p><u>NËNKREU 6</u> <u>EFEKTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS</u></p> <p>I. KRIJIMI I DETYRIMEVE PËR KONTRAKTUESIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 130 Efektet e kontratave midis kontraktuesve dhe pasardhësve të tyre</p> <p>1. Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese.</p> <p>2. Kontrata krijon efekte të veta edhe për pasardhësit juridikë universal të palëve kontraktuese, përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër apo nëse diçka tjetër rezulton nga vete natyra e kontratës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 129 Objections</p> <p>The other party may exercise all the objections deriving from the transferred contract against the recipient, and all those from other relationships with the recipient; the other party may not exercise objections held against the transferring party.</p> <p><u>SUBCHAPTER 6</u> <u>GENERAL EFFECTS OF CONTRACT</u></p> <p>I. GENERATION OF OBLIGATION FOR CONTRACTING PARTIES</p> <p style="text-align: center;">Article 130 Effects of contract between contracting parties and legal successors thereof</p> <p>1. A contract shall generate rights and obligations for the contracting parties.</p> <p>2. A contract shall also have effect for the universal legal successors of the contracting parties, unless stipulated otherwise in the contract or unless it follows otherwise from the nature of the contract itself.</p>	<p style="text-align: center;">Član 129 Prigovori</p> <p>Druga strana može istaći prijemniku sve prigovore iz ustupljenog ugovora, kao i one koje ima iz drugih odnosa sa njim, ali ne i prigovore koje ima prema ustupiocu.</p> <p><u>PODGLAVLJE 6</u> <u>OPŠTA DEJSTVA UGOVORA</u></p> <p>I. STVARANJE OBAVEZA ZA UGOVARAČE</p> <p style="text-align: center;">Član 130 Dejstva ugovora među ugovaračima i njihovim pravnim sledbenicima</p> <p>1. Ugovor stvara prava i obaveze za ugovorne strane.</p> <p>2. Ugovor ima dejstvo i za univerzalne pravne sledbenike ugovornih strana, izuzev ako je što drugo ugovoreno ili što drugo proizlazi iz prirode samog ugovora.</p>
---	--	---



<p>3. Me kontratë mund të krijohet e drejta në dobi të personit të tretë.</p> <p>II. KONTRATA NË DOBI TË PERSONIT TË TRETË</p> <p>Neni 131 E drejta e drejtpërdrejtë e të tretit</p> <p>1. Kur dikush kontrakton në emër të tij ndonjë kërkesë në dobi të personit të tretë, atëherë personi i tretë fiton të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër ose nuk del nga rrethanat e punës.</p> <p>2. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë që debitori të kryejë ndaj personit të tretë atë që është kontraktuar në dobi të atij personit të tretë.</p> <p>Neni 132 Revokimi i dobive për personin e tretë</p> <p>1. Kontraktuesi mund t'i revokojë ose ti ndryshojë dobite për personin e tretë gjithnjë derisa personi i tretë të mos deklarojë se e pranon atë që është kontraktuar në dobi të tij.</p>	<p>3. A right in favor of a third person may be established via a contract.</p> <p>II. CONTRACT IN FAVOR OF THIRD PERSON</p> <p>Article 131 Direct right of third person</p> <p>1. If a contract establishes a right in favor of a third person the third person acquires the right directly against the debtor, unless agreed otherwise or unless it follows otherwise from the circumstances of the transaction.</p> <p>2. A contracting party shall have the right to request that the other contracting party perform the obligation towards the third person that the contracting party undertook to perform in the third party's favor.</p> <p>Article 132 Revocation of right in favor of third person</p> <p>1. A contracting party that is entitled to request that the fellow contracting party perform an obligation to a third person may revoke or amend the right established in favor of the third person at any time</p>	<p>3. Ugovorom se može ustanoviti pravo u korist trećeg lica.</p> <p>II. UGOVOR U KORIST TREĆEG LICA</p> <p>Član 131 Neposredno pravo trećeg</p> <p>1. Kad neko ugovori u svoje ime potraživanje u korist trećeg lica, onda treće lice stiče sopstveno i neposredno pravo prema dužniku, ako nije što drugo ugovoreno ili ne proizlazi iz okolnosti posla.</p> <p>2. Ugovarač ima pravo zahtevati da dužnik izvrši prema trećem licu ono što je ugovoreno u korist tog trećeg lica.</p> <p>Član 132 Opozivanje koristi za trećeg</p> <p>1. Ugovarač koristi za trećeg može je opozvati ili izmeniti sve dok treći ne izjavi da prihvata ono što je ugovoreno u njegovu korist.</p>
---	---	---



<p>2. Në qoftë se është kontraktuar se debitori do të përmbush atë për të cilën është detyruar në dobi të personit të tretë vetëm pas vdekjes së kontraktuesit, ky mundet deri atëherë, madje edhe me testamentin e tij, ta revokojë dobinë e kontraktuar për personin e tretë në qoftë se nga vetë kontrata ose nga rrethanat nuk del diçka tjetër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 133 Prapësimet e debitorit ndaj të tretit</p> <p>Debitori mund t'i paraqesë personit të tretë të gjitha prapësimet që i ka ndaj kontraktuesit në bazë të kontratës me të cilën është kontraktuar përfitimi për të tretin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 134 Refuzimi i të tretit</p> <p>Në qoftë se i treti e refuzon dobinë që është kontraktuar për te, apo nëse kontraktuesi e revokon, dobia i takon kontraktuesit po qe se diçka tjetër nuk është kontraktuar ose nuk del nga vetë natyra e punës.</p>	<p>until the third person declares that the right is accepted.</p> <p>2. If it is agreed that the fellow contracting party that committed in favor of the third person will only perform the obligation after the contracting party's death, the contracting party may at any time, including via his/her will, revoke the right in favor of the third person, unless it follows otherwise from the contract itself or from the circumstances.</p> <p style="text-align: center;">Article 133 Debtor's objections against third person</p> <p>The debtor may exercise all objections against the third person that the former holds against the contracting party from the contract in favor of the third person.</p> <p style="text-align: center;">Article 134 Refusal by third person</p> <p>If the third person refuses the right established in favor thereof or if the contracting party revokes it the right shall pertain to the contracting party, unless agreed otherwise or unless it follows otherwise from the nature of the transaction.</p>	<p>2. Ako je ugovoreno da će dužnik izvršiti ono na šta se obavezao u korist trećeg tek posle smrti ugovarača, ovaj može sve dotle, pa i svojim testamentom, opozvati korist ugovorenu za trećeg, ako iz samog ugovora ili iz okolnosti ne proizlazi nešto drugo.</p> <p style="text-align: center;">Član 133 Odbijenice dužnika prema trećem</p> <p>Dužnik može istaći trećem sve odbijenice koje ima prema ugovaraču po osnovu ugovora kojim je ugovorena korist za trećeg.</p> <p style="text-align: center;">Član 134 Odbijanje trećeg</p> <p>Ako treći odbije korist koja je ugovorena za njega, ili je ugovarač opozove, korist pripada ugovaraču, ako što drugo nije ugovoreno ili ne proizlazi iz prirode posla.</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 135 Premtimi i veprimit të personit të tretë</p> <p>1. Premtimi i bërë tjetrit se i treti do të kryejë ose do të lëshojë që të kryejë diçka, të tretin nuk e detyron, kurse premtuesi përgjigjet për dëmin që do të pësonte tjetri për shkak se i treti nuk don të detyrohet që ta kryejë ose të lëshojë që të mos e kryejë veprimin e caktuar.</p> <p>2. Premtuesi nuk do të përgjigjet në qoftë se i ka premtuar tjetrit se vetëm do të angazhohet tek personi i tretë që ky do të detyrohet që diçka të kryejë ose të lëshojë që të kryejë, kurse në këtë nuk ka pasur sukses përkundër gjithë angazhimit të nevojshëm.</p> <p>KREU 2 SHKAKTIMI I DËMIT</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 1</u> <u>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 136 Bazat e përgjegjësisë</p> <p>1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për</p>	<p style="text-align: center;">Article 135 Promise of action by third person</p> <p>1. A promise made to another that a third person will do something or refrain from something shall not bind the third person; the person that made the promise shall be liable for any damage incurred by the other person because the third person did not wish to commit to doing such or refraining from such.</p> <p>2. The person that makes the promise shall not be liable if the promise made to the other person was solely that the former would endeavor to have the third person undertake to do something or refrain from something and in the event the person failed despite all the necessary endeavors.</p> <p>CHAPTER 2 CAUSING OF DAMAGE</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 1</u> <u>GENERAL PRINCIPLES</u></p> <p style="text-align: center;">Article 136 Basis for liability</p> <p>1. Any person that inflicts damage on</p>	<p style="text-align: center;">Član 135 Obećanje radnje trećeg lica</p> <p>1. Obećanje učinjeno drugom da će treće lice nešto učiniti ili propustiti, trećeg ne obavezuje, a obećavalac odgovara za štetu koju bi drugi pretrpeo zbog toga što treći neće da se obaveže ili da izvrši ili propusti određenu radnju.</p> <p>2. Obećavalac neće odgovarati ako je drugom obećao da će se samo zauzeti kod trećeg da se ovaj obaveže da nešto učini ili propusti, a u tome nije uspeo i pored sveg potrebnog zalaganja.</p> <p>GLAVA 2 PROUZROKOVANJE ŠTETE</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 1</u> <u>OPŠTA NAČELA</u></p> <p style="text-align: center;">Član 136 Osnovi odgovornosti</p> <p>1. Ko drugome prouzrokuje štetu dužan je</p>
--	--	---



<p>detyrë ta shpërblejë, në qoftë se nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.</p> <p>2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.</p> <p>3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 137 Dëmi</p> <p>Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).</p> <p style="text-align: center;">Neni 138 Kërkesa për mënjanimin e rrezikut të dëmit</p> <p>1. Kushdo mund të kërkojë prej tjetrit që të mënjanojë burimin e rrezikut të dëmit të rëndësishëm që i kanoset atij ose numrit të pacaktuar njerëzish si dhe të përmbahet</p>	<p>another shall be obliged to reimburse it, unless it is proved that the damage was incurred without the culpability of the former.</p> <p>2. Persons shall be liable for material damage and activities that result in major risk of damage to the environment, irrespective of culpability.</p> <p>3. Persons shall also be liable for damage irrespective of culpability in other cases defined by law.</p> <p style="text-align: center;">Article 137 Damage</p> <p>Damage comprises the diminution of property (ordinary damage), prevention of the appreciation of property (lost profits), the infliction of physical or mental distress or fear on another person, and encroachment upon the reputation of a legal person.</p> <p style="text-align: center;">Article 138 Request for disposal of risk of damage</p> <p>1. Any person may request that another person dispose of a source of danger that threatens major damage to the former or an indeterminate number of persons and</p>	<p>naknaditi je, ukoliko ne dokaže da je šteta nastala bez njegove krivice.</p> <p>2. Za štetu od stvari ili delatnosti, od kojih potiče povećana opasnost štete za okolinu, odgovara se bez obzira na krivicu.</p> <p>3. Za štetu bez obzira na krivicu odgovara se i u drugim slučajevima predviđenim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 137 Šteta</p> <p>Šteta je umanj enje nečije imovine (obična šteta) i sprečavanje njenog povećanja (izgubljena korist), kao i nanošenje drugome fizičkog ili psihičkog bola ili straha (nematerijalna šteta).</p> <p style="text-align: center;">Član 138 Zahtev da se ukloni opasnost štete</p> <p>1. Svako može zahtevati od drugoga da ukloni izvor opasnosti od koga preti znatnija šteta njemu ili neodređenom broju lica, kao i da se uzdrži od delatnosti</p>
---	--	--



<p>nga veprimtaritë nga të cilat rezulton trazimi ose rreziku i dëmit në qoftë se lindja e trazimit ose e dëmit nuk mund të parandalohet me masa përkatëse.</p> <p>2. Gjykata do të urdhërojë sipas kërkesës së personit të interesuar që të ndërmerren masat përkatëse për parandalimin e shkakimit të dëmit ose të shqetësimit, ose të evitohet burimi i rrezikut, me shpenzime të mbajtësit të burimit të rrezikut, në qoftë se ky vetë nuk e bën këtë.</p> <p>3. Në qoftë se dëmi shkaktohet në ushtrimin e veprimtarisë me interes të përgjithshëm, për të cilën është marrë leja e organit kompetent, mund të kërkohej vetëm shpërblimi i dëmit që i tejkalon kufijtë e rëndomtë.</p> <p>4. Mirëpo edhe në këtë rast mund të kërkohej ndërmarrja e masave shoqërisht të arsyeshme për parandalimin e shkakimit të dëmit apo për zvogëlimin e tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 139 Kërkesa që të pushohet me shkeljen e të drejtave të personalitetit</p> <p>1. Secili ka të drejtë të kërkojë nga gjykata</p>	<p>refrain from the activities from which the alarm or risk of damage derives, if the occurrence of alarm or damage cannot be prevented by appropriate measures.</p> <p>2. At the request of an interested person the court shall order appropriate measures to prevent the occurrence of damage or alarm or to dispose of a source of danger to be taken at the expense of the possessor thereof should the latter fail to do so.</p> <p>3. If damage arises during the performance of generally beneficial activities for which permission has been given by the relevant authority it shall only be possible to demand the reimbursement of damage that exceeds the customary boundaries.</p> <p>4. Nevertheless, appropriate measures to prevent the occurrence of damage or to reduce damage may also be demanded in such a case.</p> <p style="text-align: center;">Article 139 Request to cease infringement of personal rights</p> <p>1. All persons shall have the right to</p>	<p>od koje proizlazi uznemiravanje ili opasnost štete, ako se nastanak uznemiravanja ili štete ne može sprečiti odgovarajućim merama.</p> <p>2. Sud će na zahtev zainteresovanog lica narediti da se preuzmu odgovarajuće mere za sprečavanje nastanka štete ili uznemiravanja, ili da se otkloni izvor opasnosti, na trošak držaoca izvora opasnosti, ako ovaj sam to ne učini.</p> <p>3. Ako šteta nastane u obavljanju opstekorisne, za koju je dobijena dozvola nadležnog organa, može se zahtevati samo naknada štete koja prelazi normalne granice.</p> <p>4. Međutim, i u tom slučaju se može zahtevati preduzimanje društveno opravdanih mera za sprečavanje nastupanja štete ili za njeno smanjenje.</p> <p style="text-align: center;">Član 139 Zahtev da se prestane sa povredom prava ličnosti</p> <p>1. Svako ima pravo zahtevati od suda ili</p>
---	--	--



<p>ose nga organi tjetër kompetent të urdhërojë pushimin e veprimit që e shkel integritetin e personalitetit të njeriut të jetës personale e familjare e të drejtave të tjera të personalitetit të tij.</p> <p>2. Gjykata, përkatësisht organi tjetër kompetent mund të urdhërojë që të pushojë veprimi nën kërcënimin e pagimit të një shume të caktuar të hollash, të caktuara gjithsejt ose në periudha të kohës në dobi të të dëmtuarit.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 2</u> <u>PËRGJEGJËSIA NË BAZË TË</u> <u>FAJËSISË</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 140 Ekzistimi i fajësisë</p> <p>Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.</p> <p style="text-align: center;">Neni 141 Personat të cilët nuk janë përgjegjës</p> <p>1. Personi i cili për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit të metë mendor apo të shkaqeve të tjera nuk është i aftë të</p>	<p>request the court or any other relevant authority to order that action that infringes the inviolability of the human person, personal and family life or any other personal right be ceased, that such action be prevented or that the consequences of such action be eliminated.</p> <p>2. The court or other relevant authority may order that the infringer cease such action, with failure to do so resulting in the mandatory payment of a monetary sum to the person affected, levied in total or per time unit.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 2</u> <u>CULPABLE LIABILITY</u></p> <p style="text-align: center;">Article 140 When culpability is given</p> <p>Culpability is given when the injurer inflicts damage intentionally or out of negligence.</p> <p style="text-align: center;">Article 141 Non-liable person</p> <p>1. Any person who for reason of disturbances in mental development or mental health problems or on any other</p>	<p>drugog nadležnog organa da naredi prestanak radnje kojom se povređuje integritet ljudske ličnosti, ličnog i porodičnog života i drugih prava njegove ličnosti.</p> <p>2. Sud, odnosno drugi nadležni organ može narediti prestanak radnje pod pretnjom plaćanja izvesne novčane svote, određene ukupno ili po jedinici vremena, u korist povređenog.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 2</u> <u>ODGOVORNOST PO OSNOVU</u> <u>KRIVICE</u></p> <p style="text-align: center;">Član 140 Postojanje krivice</p> <p>Krivica postoji kada je štetnik prouzrokovao štetu namerno ili nepažnjom.</p> <p style="text-align: center;">Član 141 Lica koja nisu odgovorna</p> <p>1. Lice koje usled dusevne bolesti ili zaostalost umnog razvoja ili drugih razloga nije sposobno za rasuđivanje, ne</p>
--	---	---



<p>gjykojë, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që dëmin e ka shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar.</p> <p>2. Kush i shkakton dëm tjetrit në gjendje të paaftësisë së përkohshme për gjykim, është përgjegjës për atë, përveç nëse provon se pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tillë.</p> <p>3. Në qoftë se në këtë gjendje është sjellë me faj të dikujt, për dëmin do të përgjigjet ai që e ka sjellë në gjendje të tillë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 142 Përgjegjësia e të miturit</p> <p>1. I mituri deri në moshën shtatë vjeç nuk përgjigjet për dëmin të cilin e shkakton.</p> <p>2. I mituri prej moshës shtatë vjeçare deri në moshën katërbëdhjetë vjeçare përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që gjatë shkaktimit të dëmit nuk ka qenë i aftë për të gjykuar.</p> <p>3. I mituri mbasi t'i ketë mbushur katërbëdhjetë vjet përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin.</p>	<p>grounds is not capable of accounting for his/her actions shall not be liable for damage inflicted on another.</p> <p>2. Any person who inflicts damage on another in a temporary state of being of unsound mind shall be liable for the damage, unless it is shown that the person did not enter such state through any fault of his/her own.</p> <p>3. If a person enters such state through the fault of another, the person that caused the former to enter such state shall be liable for the damage.</p> <p style="text-align: center;">Article 142 Liability of minors</p> <p>1. Minors under the age of seven shall not be liable for any damage they inflict.</p> <p>2. Minors aged seven and over but under fourteen shall not be liable for damage, unless it is shown that they were capable of accounting for their actions when the damage was inflicted.</p> <p>3. Minors aged fourteen and over shall be liable according to the general rules on liability for damage.</p>	<p>odgovara za štetu koju drugome prouzrokuje, osim ako se dokaže da je štetu prouzrokovao u trenutku kada je bio sposoban za rasuđivanje.</p> <p>2. Ko drugom prouzrokuje štetu u stanju prolazne nesposobnosti za rasuđivanje, odgovoran je za nju, izuzev ako dokaže da nije svojom krivicom dospeo u to stanje.</p> <p>3. Ako je u to stanje dospeo tuđom krivicom, za štetu će odgovarati onaj ko ga je u to stanje doveo.</p> <p style="text-align: center;">Član 142 Odgovornost maloletnika</p> <p>1. Maloletnik do navršene sedme godine ne odgovara za štetu koju prouzrokuje.</p> <p>2. Maloletnik od navršene sedme do navršene četrnaeste godine odgovara za štetu, osim ako se dokaže da je pri prouzrokovanju štete bio sposoban za rasuđivanje.</p> <p>3. Maloletnik sa navršenih četrnaest godina odgovara prema opštim pravilima o odgovornosti za štetu.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;">Neni 143 Mbrojtja e nevojshme, gjendja e nevojës, mënjanimi i dëmit nga tjetri</p> <p>1. Kush në mbrojtje të nevojshme i shkakton dëm sulmuesit nuk e ka për detyrë ta shpërblejë dëmin, përveç në rastin e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme.</p> <p>2. Në qoftë se dikush e shkakton dëmin në gjendje të nevojës ekstreme, i dëmtuari mund të kërkojë shpërblim nga personi që është fajtor për shkaktimin e rrezikut të dëmit ose nga personat nga të cilët është mënjanuar dëmi, por nga këta të fundit jo më tepër se sa kanë pasur përfitim nga kjo.</p> <p>3. Kush pëson dëm duke mënjanuar prej tjetrit rrezikun e dëmit ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e atij dëmi të cilit i është ekspozuar me arsye.</p>	<p style="text-align: center;">Article 143 Self-defence, emergency, aversion of damage to other</p> <p>1. Any person who in self-defence inflicts damage on an assailant shall not be obliged to reimburse the damage, except in the case of unreasonably excessive self-defence.</p> <p>2. If a person inflicts damage in an emergency the injured party may demand compensation from the person liable for the occurrence of the risk of damage or from those from whom damage was averted, but may not request compensation from the latter greater than the benefit they had therefrom.</p> <p>3. Any person that incurs damage when the risk of damage is averted from another shall have the right to demand therefrom the reimbursement of the damage to which the latter was reasonably exposed.</p>	<p style="text-align: center;">Član 143 Nužna odbrana, stanje nužde, otklanjanje štete od drugog</p> <p>1. Ko u nužnoj odbrani prouzrokuje štetu napadaču nije dužan naknaditi je, osim u slučaju prekoračenja nužne odbrane.</p> <p>2. Kad neko prouzrokuje štetu u stanju krajnje nužde, oštećenik može zahtevati naknadu od lica koje je krivo za nastanak opasnosti štete, ili od lica od kojih je šteta otklonjena, ali od ovih poslednjih, ne više od koristi koju su imala od toga.</p> <p>3. Ko pretrpi štetu otklanjajući od drugog opasnost štete, ima pravo zahtevati od njega naknadu one štete kojoj se razumno izložio.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 144 Vetëndihma e lejuar</p> <p>1. Kush në rastin e vetëndihmës së lejuar i shkakton dëm personit i cili e ka shkakuar nevojën e vetëndihmës nuk ka për detyrë ta shpërblejë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 144 Allowed self-help</p> <p>1. Any person that during allowed self-help inflicts damage on the person that caused the need for self-help shall not be obliged to reimburse.</p>	<p style="text-align: center;">Član 144 Dozvoljena samopomoć</p> <p>1. Ko u slučaju dozvoljene samopomoći prouzrokuje štetu licu koje je izazvalo potrebu samopomoći, nije dužan naknaditi je.</p>



<p>2. Me vetëndihmë të lejuar nënkuptohet e drejta e çdo personi për të mënjeluar shkeljen e të drejtës kur kanoset rreziku i drejtpërdrejtë, në qoftë se një mbrojtje e tillë është e domosdoshme dhe nëse mënyra e mënjanimet të cenimi të së drejtës i përgjigjet rrethanave në të cilat shkaktohet rreziku.</p> <p style="text-align: center;">Neni 145 Pëlqimi i të dëmtuarit</p> <p>1. Kush në dëm të vet i lejon tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi, nuk mund të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkakuar nga ky veprim.</p> <p>2. Është e pavlefshme deklarata e të dëmtuarit me të cilën e ka dhënë pëlqimin që t'i shkaktohet dëmi me veprimin e ndaluar me ligj.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 3</u> <u>PËRGJEGJËSIA PËR TJETRIN</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 146 Personat me sëmundje mendore dhe me të meta në zhvillimin mendor</p> <p>1. Për dëmin të cilin e shkakton personi i cili për shkak të sëmundjes mendore ose</p>	<p>2. The term “allowed self-help” entails the right of any person to avert the infringement of a right when immediate danger is threatened, if such protection is necessary and if the manner in which the infringement is averted accords with the circumstances in which the danger arises.</p> <p style="text-align: center;">Article 145 Injured party’s consent</p> <p>1. Any person that allows another person to do something to the former’s detriment may not demand from the latter the reimbursement of the damage that the latter thereby inflicted.</p> <p>2. A declaration by which an injured party consents to another inflicting damage thereto by an act prohibited by law shall be null and void.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 3</u> <u>LIABILITY FOR OTHER</u></p> <p style="text-align: center;">Article 146 Persons with disturbances in mental development and mental health problems</p> <p>1. The person that according to law, according to a ruling by the relevant</p>	<p>2. Pod dozvoljenom samopomoći podrazumeva se pravo svakog lica da otkloni povredu prava kad neposredno pretil opasnost, ako je takva zaštita nužna i ako način otklanjanja povrede prava odgovara prilikama u kojima nastaje opasnost.</p> <p style="text-align: center;">Član 145 Pristanak oštećenika</p> <p>1. Ko na svoju štetu dozvoli drugome preduzimanje neke radnje, ne može od njega zahtevati naknadu štete prouzrokovane tom radnjom.</p> <p>2. Ništava je izjava oštećenika kojom je pristao da mu se učini šteta radnjom koja je zakonom zabranjena.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 3</u> <u>ODGOVORNOST ZA DRUGOGA</u></p> <p style="text-align: center;">Član 146 Duševno bolesni i zaostali u umnom razvoju</p> <p>1. Za štetu koju prouzrokuje lice koje usled duševne bolesti ili zaostalog umnog</p>
--	---	---



<p>të zhvillimit mendor të metë ose të shkaqeve të tjera nuk është i aftë për të gjykuar, përgjigjet ai i cili në bazë të ligjit ose të vendimit të organit kompetent ose të kontratës ka për detyrë të bëjë mbikëqyrjen e tij.</p> <p>2. Ai mund të lirohet nga përgjegjësia në qoftë se provon se e ka kryer mbikëqyrjen për të cilën është i detyruar, apo se dëmi do të shkaktonte edhe me kryerjen e kujdeshme të mbikëqyrjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 147 Përgjegjësia e prindërve</p> <p>1. Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkakton tjetrit fëmija i tyre deri në moshën shtatë vjeçare, pavarësisht nga faji i tij.</p> <p>2. Ata lirohen nga përgjegjësia nëse ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e përgjegjësive sipas rregullave për përgjegjësinë pavarësisht nga faji.</p> <p>3. Ata nuk përgjigjen në qoftë se dëmi është shkaktuar gjersa fëmija i është besuar personit tjetër dhe në qoftë se ky person është përgjegjës për dëmin.</p> <p>4. Prindërit përgjigjen për dëmin që i</p>	<p>authority or according to a contract is obliged to supervise a person who for reason of disturbances in mental development or mental health problems or for any other reason is not capable of accounting for his/her actions shall be liable for any damage inflicted thereby.</p> <p>2. Such person may be released from liability if it is shown that such person conducted the obligatory supervision or that the damage would have occurred even under careful supervision.</p> <p style="text-align: center;">Article 147 Parental liability</p> <p>1. Parents shall be liable for damage inflicted on another by their child until the child reaches the age of seven, irrespective of culpability.</p> <p>2. They shall be released from liability if grounds for the exclusion of liability according to the rules on liability irrespective of culpability are given.</p> <p>3. Parents shall not be liable if the damage occurred while the child was entrusted to another and such person was liable therefor.</p> <p>4. Parents shall be liable for damage</p>	<p>razvoja ili drugih razloga nije sposobno za rasuđivanje, odgovara onaj koji je na osnovu zakona, ili odluke nadležnog organa, ili ugovora, dužan da vodi nadzor nad njim.</p> <p>2. On se može osloboditi odgovornosti ako dokaže da je vršio nadzor na koji je obavezan ili da bi šteta nastala i pri brižljivom vršenju nadzora.</p> <p style="text-align: center;">Član 147 Odgovornost roditelja</p> <p>1. Roditelji odgovaraju za štetu koju prouzrokuje drugom njihovo dete do navršene sedme godine, bez obzira na svoju krivicu.</p> <p>2. Oni se oslobađaju odgovornosti ako postoje razlozi za isključenje odgovornosti prema pravilima o odgovornosti bez obzira na krivicu.</p> <p>3. Oni ne odgovaraju ako je šteta nastala dok je dete bilo povereno drugom licu i ako je to lice odgovorno za štetu.</p> <p>4. Roditelji odgovaraju za štetu koju</p>
--	--	---



<p>shkakton tjetrit fëmija i mitur i tyre që ka mbushur moshën shtatë vjeç, përveç nëse provojnë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 148 Përgjegjësia solidare</p> <p>Në qoftë se përveç prindërve përgjigjet për dëmin edhe fëmija, përgjegjësia e tyre është solidare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 149 Përgjegjësia e personit tjetër për të miturin</p> <p>1. Për dëmin të cilin ia shkaktonte tjetrit i mituri derisa ndodhet nën mbikëqyrjen e kujdestarit, shkollës ose institucionit tjetër, përgjigjet kujdestari, shkolla, përkatësisht institucioni tjetër, përveç nëse provojnë se mbikëqyrjen e kanë kryer sipas mënyrës në të cilën kanë qenë të detyruar, apo se dëmi do të shkaktej edhe me kryerjen e kujdesshme të mbikëqyrjes.</p> <p>2. Në qoftë se për dëmin përgjigjet edhe i mituri, përgjegjësia është solidare.</p>	<p>inflicted on another by a child of theirs who is aged over seven but is not yet of age, unless it is shown that the damage occurred through no culpability of their own.</p> <p style="text-align: center;">Article 148 Joint and several liability</p> <p>If in addition to the parents a child is liable for damage, they shall be jointly and severally liable.</p> <p style="text-align: center;">Article 149 Liability of others for minors</p> <p>1. The guardian, school or other institution shall be liable for damage inflicted by a minor while under the supervision of the guardian, school or other institution, unless it is shown that the supervision was conducted with due care or that the damage would have occurred even under careful supervision.</p> <p>2. If the minor is also liable for damage, they shall be jointly and severally liable.</p>	<p>prouzrokuje drugom njihovo maloletno dete koje je navršilo sedam godina, osim ako dokažu da je šteta nastala bez njihove krivice.</p> <p style="text-align: center;">Član 148 Solidarna odgovornost</p> <p>Ako pored roditelja i dete odgovara za štetu, njihova je odgovornost solidarna.</p> <p style="text-align: center;">Član 149 Odgovornost drugog lica za maloletnika</p> <p>1. Za štetu koju drugom prouzrokuje maloletnik dok je pod nadzorom staratelja, škole ili druge ustanove, odgovara staratelj, škola, odnosno druga ustanova, osim ako dokažu da su nadzor vršili na način na koji su obavezni, ili da bi šteta nastala i pri brižljivom vršenju nadzora.</p> <p>2. Ako za štetu odgovara i maloletnik, odgovornost je solidarna.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 150 Përgjegjësia e veçantë e prindërve</p> <p>1. Në qoftë se detyra e mbikëqyrjes mbi personin e mitur nuk bie mbi prindërit, por mbi ndonjë person tjetër, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga prindëri kur dëmi është krijuar për shkak të edukatës së keqe të të miturit, shembujve të këqinj ose të shprehive familjare të cilat ia kanë dhënë prindërit ose kur edhe ashtu dëmi mund t'i dedikohet fajit të prindërve.</p> <p>2. Personi në të cilin në këtë rast bie përgjegjësi e mbikëqyrjes ka të drejtë të kërkojë nga prindërit që t'ia shpërblejnë shumën e paguar, në qoftë se ai ia ka paguar shpërblimin dëmtuesit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 150 Special parental liability</p> <p>1. If supervision of a minor is not the responsibility of the parents but another person the injured party shall have the right to demand compensation from the parents if the damage occurred for reason of the poor upbringing of the minor or the poor example or bad habits set by the parents, or if the damage can otherwise be attributed to their culpability.</p> <p>2. If the person responsible for supervision in this case must pay compensation to the injured party such person shall have the right to demand that the parents reimburse the sum paid out.</p>	<p style="text-align: center;">Član 150 Posebna odgovornost roditelja</p> <p>1. Ako dužnost nadzora nad maloletnim licem ne leži na roditeljima, već na nekom drugom licu, oštećenik ima pravo da zahteva naknadu od roditelja, kad je šteta nastala usled lošeg vaspitanja maloletnika, rđavih primera ili porodičnih navika koje su mu roditelji dali, ili se i inače šteta može upisati u krivicu roditeljima.</p> <p>2. Lice na kome u ovom slučaju leži dužnost nadzora ima pravo tražiti od roditelja da mu naknade isplaćeni iznos ako je ono isplatilo naknadu oštećeniku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 151 Përgjegjësia në bazë të drejtshmërisë</p> <p>1. Në rast se shkaktohet dëmi, të cilën e ka shkaktuar personi, i cili për atë dëm nuk ka qenë përgjegjës, ndërsa shpërblimi nuk mund të nxirret nga personi, i cili e ka pasur për detyrë të kryejë mbikëqyrjen mbi te, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të dëmtuesit dhe të të dëmtuarit, ta gjykojë dëmtuesin që ta shpërblejë dëmin tërësisht ose</p>	<p style="text-align: center;">Article 151 Just liability</p> <p>1. If damage was inflicted by a person not liable therefore and compensation cannot be obtained from the person that should have supervised the former the court may order the injurer to reimburse all the damage or a part thereof if justice demands such, particularly in respect of the financial situation of the injurer and the injured party.</p>	<p style="text-align: center;">Član 151 Odgovornost po osnovu pravičnosti</p> <p>1. U slučaju štete koju je prouzrokovalo lice koje za nju nije odgovorno, a naknada se ne može dobiti od lica koje je bilo dužno da vodi nadzor nad njim, sud može, kad to pravičnost zahteva, a naročito s obzirom na materijalno stanje štetnika i oštećenika, osuditi štetnika da naknadi štetu, potpuno ili delimično.</p>



<p>pjesërisht.</p> <p>2. Në qoftë se dëmin e ka shkaktuar i mituri me aftësi për të gjykuar, i cili nuk është në gjendje ta shpërblejë, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të prindërve dhe të dëmtuesit, t'i detyrojë prindërit ta shpërblejnë dëmin, tërësisht ose pjesërisht.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 4</u> <u>PËRGJEGJËSIA E PUNËDHËNËSIT</u> <u>PËR PUNËMARRËSIT</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 152 Përgjegjësia e punëdhënësit</p> <p>1. Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkaktimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete.</p> <p>2. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje.</p>	<p>2. If the damage was inflicted by a minor capable of accounting for his/her actions who cannot reimburse it the court may if justice demands such, particularly in respect of the financial situation of the parents and the injured party, order the parents to reimburse all the damage or a part thereof, even if not liable therefore.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 4</u> <u>LIABILITY FOR EMPLOYEES</u></p> <p style="text-align: center;">Article 152 Employer liability</p> <p>1. The legal or natural person with whom an employee was working at the time the damage was inflicted shall be liable for damage inflicted on a third person by an employee during work or in connection with work, unless it is shown that the employee acted as was necessary under the given circumstances.</p> <p>2. The injured party shall have the right to demand the reimbursement of damage directly from the employee if such damage is inflicted intentionally.</p>	<p>2. Ako je štetu prouzrokovao maloletnik sposoban za rasuđivanje koji nije u stanju da je naknadi, sud može, kad to pravičnost zahteva, a naročito s obzirom na materijalno stanje roditelja i oštećenika, obavezati roditelje da naknade štetu, potpuno ili delimično, iako za nju nisu krivi.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 4</u> <u>ODGOVORNOST POSLODAVCA ZA</u> <u>ZAPOSLENE</u></p> <p style="text-align: center;">Član 152 Odgovornost poslodavca</p> <p>1. Pravno ili fizičko lice za koje je zaposleni radio u vreme prouzrokovanja štete je odgovorno za štetu prouzrokovanu trećem licu od strane zaposlenog tokom rada ili u vezi sa radom, osim ako se dokaže da je zaposleni u datim okolnostima postupao onako kako je trebalo.</p> <p>2. Oštećenik ima pravo zahtevati naknadu štete i neposredno od radnika ako je štetu prouzrokovao namerno.</p>
---	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 286 Personi i autorizuar</p> <p>1. Përmbushja medoemos duhet t'i bëhet kreditorit ose personit të caktuar me ligj, me vendim gjyqësor, me kontratë midis kreditorit e debitorit, ose nga vetë kreditori.</p> <p>2. Përmbushja është e vlefshme edhe kur i është bërë personit të tretë, në qoftë se kreditori e ka lejuar më vonë apo në qoftë se e ka përdorur atë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 286 The authorized person</p> <p>1. An obligation must be performed for the creditor or a person designated by law, a court ruling or a contract between the creditor and debtor or designated by the creditor alone.</p> <p>2. Performance shall also be valid when made for a third person if the creditor subsequently approves thereof or makes use thereof.</p>	<p style="text-align: center;">Član 286 Ovlaščeno lice</p> <p>1. Ispunjenje mora biti izvršeno poveriocu ili licu određenom zakonom, sudskom odlukom, ugovorom između poverioca i dužnika, ili od strane samog poverioca.</p> <p>2. Ispunjenje je punovažno i kad je izvršeno trećem licu, ako ga je poverilac naknadno odobrio ili ako se njime koristio.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 287 Përmbushja e bërë kreditorit të paaftë për të vepruar</p> <p>1. Përmbushja e bërë kreditorit të paaftë për të vepruar e liron debitorin, në qoftë se ka qenë e dobishme për kreditorin ose objekti i përmbushjes ndodhet ende te ai.</p> <p>2. Kreditori i paaftë për të vepruar mund të pajtohet, pasi të jetë bërë i aftë për të vepruar, për përmbushjen të cilin e ka marrë në kohën e paaftësisë së tij për të vepruar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 287 Performance for creditor with incapacity to contract</p> <p>1. A debtor shall only be released by performance for a creditor with incapacity to contract if the performance was beneficial to the creditor or if the subject of the performance is still in the possession thereof.</p> <p>2. A creditor with incapacity to contract that acquires the capacity to contract may then approve performance received when the creditor had the incapacity to contract.</p>	<p style="text-align: center;">Član 287 Ispunjenje poslovno nesposobnom poveriocu</p> <p>1. Ispunjenje izvršeno poslovno nesposobnom poveriocu oslobađa dužnika ukoliko je bilo korisno za poverioca ili se predmet ispunjenja još nalazi kod njega.</p> <p>2. Poslovno nesposoban poverilac može se saglasiti, pošto postane poslovno sposoban, ispunjenje koje je primio u vreme svoje poslovne nesposobnosti.</p>



IV. LËNDA E PËRMBUSHJES	IV. SUBJECT OF PERFORMANCE	IV. PREDMET ISPUNJENJA
<p style="text-align: center;">Neni 288 Përmbajtja e detyrimit</p> <p>1. Përmbushja përbëhet nga kryerja e asaj që është përmbajtja e detyrimit, ashtu që as debitori nuk mund ta përmbush me diçka tjetër dhe as kreditori nuk mund të kërkojë diçka tjetër.</p> <p>2. Përmbushja nuk është e vlefshme, në qoftë se ajo që debitori e ka dorëzuar si send borxh dhe kreditori e ka pranuar si të tillë, gjë që në të vërtetë nuk është dhe kreditori ka të drejtë ta kthejë atë që i është dorëzuar dhe të kërkojë sendin borxh.</p>	<p style="text-align: center;">Article 288 Content of obligation</p> <p>1. Performance is the execution of that which is the content of the obligation; therefore the debtor may not perform it with anything else, and the creditor may not demand anything else.</p> <p>2. Performance shall not be deemed valid if that which the debtor delivered as the owed thing and the creditor accepted as such is not in fact such; the creditor shall have the right to return that which was delivered and to demand the owed thing.</p>	<p style="text-align: center;">Član 288 Sadržina obaveze</p> <p>1. Ispunjenje se sastoji u izvršenju onoga što čini sadržinu obaveze, te niti je dužnik može ispuniti nečim drugim, niti poverilac može zahtevati nešto drugo.</p> <p>2. Ispunjenje nije punovažno ako ono što je dužnik predao kao dugovanu stvar, i poverilac kao takvu primio to u istinu nije, i poverilac ima pravo da vrati ono što mu je predato i da zahteva dugovanu stvar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 289 Zëvendësimi i përmbushjes</p> <p>1. Detyrimi shuhet në qoftë se kreditori në marrëveshje me debitorin pranon diçka tjetër në vend të asaj që ka borxh.</p> <p>2. Në atë rast debitori përgjigjet sikurse shitësi për të metat materiale dhe juridike të sendit të dhënë në vend të asaj që ka borxh.</p>	<p style="text-align: center;">Article 289 Substitutional performance</p> <p>1. The obligation shall terminate if in agreement with the debtor the creditor accepts anything else in place of that which was owed thereto.</p> <p>2. In this case the debtor shall be liable as a seller for material and legal errors in the thing provided in place of the thing owed.</p>	<p style="text-align: center;">Član 289 Zamena ispunjenja</p> <p>1. Obaveza se gasi ako poverilac u sporazumu sa dužnikom primi nešto drugo umesto onoga što mu se duguje.</p> <p>2. U tom slučaju dužnik odgovara isto kao prodavac za materijalne i pravne nedostatke stvari date umesto onoga što je dugovao.</p>



<p>3. Megjithatë, kreditori në vend të kërkesës në bazë të përgjegjësisë së debitorit për të metat materiale ose juridike të sendit mund të kërkojë nga debitori, por jo më nga dorëzani, përmbushjen e kërkesës paraprake dhe dëmshpërblimin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 290 Dorëzimi me qëllim shitjeje</p> <p>Në qoftë se debitori ia ka dorëzuar kreditorit ndonjë send ose ndonjë të drejtë tjetër për t'i shitur dhe nga shuma e realizuar të arkëtojnë kërkesat e veta, ndërsa pjesën tjetër ia dorëzon, detyrimi shuhet vetëm kur kreditori të arkëtojë nga shuma e realizuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 291 Përmbushja e pjeshme</p> <p>1. Kreditori nuk e ka për detyrë të pranojë përmbushjen e pjeshme, përveç nëse vetë natyra e detyrimit imponon diçka tjetër.</p> <p>2. Kreditori ka për detyrë ta pranojë përmbushjen e pjeshme të detyrimit në të holla, përveç nëse ka ndonjë interes të veçantë për ta refuzuar.</p>	<p>3. Nevertheless the creditor may demand from the debtor, but no longer from the surety, the fulfillment of the original claim and compensation in place of a claim from the debtor's liability for material and legal errors in the thing.</p> <p style="text-align: center;">Article 290 Delivery for sale</p> <p>If the debtor delivers anything or any other right for the creditor to sell to repay the claim from the sum obtained and to deliver the remainder to the debtor, the obligation shall only terminate when the creditor has been repaid from the sum obtained.</p> <p style="text-align: center;">Article 291 Part performance</p> <p>1. The creditor shall not be obliged to accept part performance, unless the nature of the obligation imposes otherwise.</p> <p>2. However, the creditor shall be obliged to accept part performance of a pecuniary obligation, unless the creditor has a specific interest in refusing it.</p>	<p>3. Ipak, poverilac umesto zahteva po osnovu odgovornosti dužnika za materijalne ili pravne nedostatke stvari može zahtevati od dužnika, ali ne više od jemca, ispunjenje prvobitnog potraživanja i naknadu štete.</p> <p style="text-align: center;">Član 290 Predaja radi prodaje</p> <p>Ako je dužnik predao poveriocu neku stvar ili koje drugo pravo da ih proda i da iz postignutog iznosa naplati svoje potraživanje, a ostatak mu preda, obaveza se gasi tek kad se poverilac naplati iz postignutog iznosa.</p> <p style="text-align: center;">Član 291 Delimično ispunjenje</p> <p>1. Poverilac nije dužan priznati delimično ispunjenje, osim ako priroda obaveze drukčije ne nalaže.</p> <p>2. Poverilac je dužan primiti delimično ispunjenje novčane obaveze, osim ako ima poseban interes da ga odbije.</p>
---	---	--



<p style="text-align: center;">Neni 292 Detyrimi i dhënies së sendeve të caktuara sipas llojit</p> <p>1. Në qoftë se sendet janë caktuar vetëm sipas llojit, debitori ka për detyrë t'i jep sende të cilësisë mesatare.</p> <p>2. Në qoftë se e ka pasur të njohur destinimin e sendit, ka për detyrë t'i jepë sendet e cilësisë përkatëse.</p> <p>V. LLOGARITJA E PËRMBUSHJES</p>	<p style="text-align: center;">Article 292 Obligation to provide thing in kind</p> <p>1. If things are defined by type alone the debtor must provide a thing of medium quality.</p> <p>2. However the debtor must provide things of appropriate quality if the debtor is acquainted with the purpose thereof.</p> <p>V. ACCOUNTING OF PERFORMANCE</p>	<p style="text-align: center;">Član 292 Obaveza davanja stvari određenih po rodu</p> <p>1. Ako su stvari određene samo po rodu, dužnik je dužan dati stvari srednjeg kvaliteta.</p> <p>2. Ako je dužniku bila poznata namena stvari, dužan je dati stvari odgovarajućeg kvaliteta.</p> <p>V. URAČUNAVANJE ISPUNJENJA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 293 Radha e llogaritjes</p> <p>1. Kur midis personave të njëjtë ekzistojnë disa detyrime të njëjlojta, kështu që atë që debitori e përmbush nuk mjafton për t'i plotësuar të gjitha, atëherë, në qoftë se për këtë gjë nuk ekziston marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, llogaritja bëhet me atë radhë të cilën e cakton debitori më së voni me rastin e përmbushjes.</p> <p>2. Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje.</p>	<p style="text-align: center;">Article 293 Order of accounting</p> <p>1. When there are several obligations of the same type between the same persons and that which the debtor performs is not sufficient to be able to settle all the obligations, if the creditor and debtor have not agreed on such the obligations shall be accounted in the order stipulated by the debtor, by the time of performance at the latest.</p> <p>2. If there is no declaration on accounting by the debtor the obligations shall be settled in the order that they fell due for performance.</p>	<p style="text-align: center;">Član 293 Red uračunavanja</p> <p>1. Kad između istih lica postoje više istorodnih obaveza, pa ono što dužnik ispuni nije dovoljno da bi se mogle namiriti sve, onda se, ako o tome ne postoji sporazum poverioca i dužnika, uračunavanje vrši onim redom koji odredi dužnik najkasnije prilikom ispunjenja.</p> <p>2. Kad nema dužnikove izjave o uračunavanju, tada obaveze se namiruju redom kako je koja dospela za ispunjenje.</p>



<p>3. Në qoftë se kanë arritur disa detyrime njëkohësisht për përmbushje, së pari plotësohen ato, përmbushja e të cilave është siguruar më pak, ndërsa kur janë siguruar të gjitha njësoj, atëherë më parë përmbushën ato të cilat përbëjnë për debitorin barrë më të rëndë.</p> <p>4. Në kuptim të këtij neni detyrimet që janë të barabarta përmbushen me radhë sikur janë krijuar, e në qoftë se janë krijuar njëkohësisht, atëherë ajo që është dhënë në emër të përmbushjes pjesëtohet në të gjitha detyrimet përpjesëtimisht me shumat e tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 294 Llogaritja e kamatës dhe e shpenzimeve</p> <p>Në qoftë se debitori përpos kërkesës kryesore ka borxh edhe kamata dhe shpenzime, llogaritja bëhet në atë mënyrë që së pari paguhen shpenzimet, pastaj kamata dhe në fund kërkesa kryesore.</p> <p style="text-align: center;">VI. KOHA E PËRMBUSHJES</p> <p style="text-align: center;">Neni 295 Kur nuk është caktuar afati</p> <p>Në qoftë se afati nuk është caktuar, kurse qëllimi i punës, vetë natyra e detyrimit dhe rrethanat e tjera nuk kërkojnë një afat</p>	<p>3. If several obligations fall due at the same time those that have least security shall be settled first; if they are equally secured those that place the greatest burden on the debtor shall be settled first.</p> <p>4. If the obligations are equivalent in all the above they shall be settled in the order in which they arose; if they arose at the same time that which was provided on account of performance shall be divided among all the obligations in proportion to their size.</p> <p style="text-align: center;">Article 294 Accounting of interest and costs</p> <p>If in addition to the principal the debtor owes interest and costs these shall be settled such that costs are repaid first, then interest and then the principal.</p> <p style="text-align: center;">VI. TIME OF PERFORMANCE</p> <p style="text-align: center;">Article 295 If deadline is not stipulated</p> <p>If no deadline is stipulated and the purpose of the transaction, the nature of the obligation and</p>	<p>3. Ako je više obaveza istovremeno dospelo za ispunjenje, prvo se namiruju one čije su ispunjenje najmanje obezbeđene, a kad su sve podjednako obezbeđene, tada prvo se namiruju one koje su dužniku na najvećem teretu.</p> <p>4. U smislu ovog člana jednake obaveze se namiruju redom kako su nastale, a ako su istovremeno nastale, ono što je dato na ime ispunjenja raspoređuje se na sve obaveze srazmerno njihovim iznosima.</p> <p style="text-align: center;">Član 294 Uračunavanje kamata i troškova</p> <p>Ako dužnik pored glavnice dužuje i kamate i troškove, uračunavanje se vrši tako što se prvo otplaćuju troškovi, zatim kamate i najzad glavnica.</p> <p style="text-align: center;">VI. VREME ISPUNJENJA</p> <p style="text-align: center;">Član 295 Kad rok nije određen</p> <p>Ako rok nije određen, a svrha posla, sama priroda obaveze i ostale okolnosti ne zahtevaju izvestan rok za ispunjenje,</p>
--	---	--



<p>për përmbushje, kreditori mund të kërkojë menjëherë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori nga ana e vet mund të kërkojë nga kreditori që menjëherë të pranojë përmbushjen.</p> <p style="text-align: center;">Neni 296 Përmbushja para afatit</p> <p>1. Kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interesin e debitorit, ai ka të drejtë ta përmbushë detyrimin edhe para afatit të kontraktuar, por e ka për detyrë ta njoftojë kreditorin për qëllimin e vet dhe të kujdeset që kjo të mos jetë në kohë të papërshtatshme.</p> <p>2. Në raste të tjera, kur debitori ofron përmbushjen para afatit, kreditori mund ta refuzojë përmbushjen, ndërsa mundet edhe ta pranojë dhe ta ruajë të drejtën për shpërblim të dëmit, në qoftë se për këtë gjë pa shtyrje e njofton debitorin.</p>	<p>other circumstances do not demand a specific deadline for performance the creditor may demand immediate performance of the obligation, and the debtor may demand that the creditor immediately accept performance.</p> <p style="text-align: center;">Article 296 Early performance</p> <p>1. If the deadline was agreed exclusively in the debtor's interest the debtor shall be entitled to perform the obligation before the agreed deadline, but must inform the creditor of this intention and ensure that it is not at an inopportune time.</p> <p>2. In other cases when the debtor offers early performance the creditor may reject it, or may also accept it and reserve the right to compensation if the creditor notifies the debtor of such without delay.</p>	<p>poverilac može zahtevati odmah ispunjenje obaveze, a dužnik sa svoje strane može zahtevati od poverioca da odmah primi ispunjenje.</p> <p style="text-align: center;">Član 296 Ispunjenje pre roka</p> <p>1. Kad je rok ugovoren isključivo u interesu dužnika, on ima pravo ispuniti obavezu i pre ugovorenog roka, ali je dužan obavestiti poverioca o svojoj nameri i paziti da to ne bude u nevreme.</p> <p>2. U ostalim slučajevima, kad dužnik ponudi ispunjenje pre roka, poverilac može odbiti ispunjenje, a može ga i primiti i zadržati pravo na naknadu štete, ako o tome bez odlaganja obavesti dužnika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 297 E drejta e kreditorit për të kërkuar përmbushjen para afatit</p> <p>Kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen para afatit në qoftë se debitori nuk ia ka dhënë sigurimin e premtuar, ose në qoftë se me kërkesën e tij</p>	<p style="text-align: center;">Article 297 Creditor's right to demand early performance</p> <p>The creditor shall have the right to demand early performance if the debtor fails to provide security as promised or at the creditor's request fails to supplement</p>	<p style="text-align: center;">Član 297 Pravo poverioca da zahteva ispunjenje pre roka</p> <p>Poverilac ima pravo zahtevati ispunjenje pre roka ako mu dužnik nije dao obećano obezbeđenje ili ako na njegov zahtev nije dopunio obezbeđenje smanjeno bez</p>



<p>nuk e ka plotësuar sigurimin e zvogëluar pa fajin e tij, si dhe kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interes të tij.</p>	<p>security diminished through no fault of the creditor, or if the deadline was agreed exclusively in the creditor's interest.</p>	<p>njegove krivice, kao i kad je rok ugovoren isključivo u njegovom interesu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 298 Caktimi i afatit nga njëra palë</p>	<p style="text-align: center;">Article 298 Stipulation of deadline from one party</p>	<p style="text-align: center;">Član 298 Određivanje roka od jednog strana</p>
<p>Kur caktimi i kohës së përmbushjes i është lënë dëshirës së kreditorit ose të debitorit, pala tjetër mundet, po qe se i autorizuari nuk e cakton afatin as pas tërheqjes së vërejtjes të kërkojë nga gjykata që ajo ta caktojë afatin plotësues për përmbushje.</p>	<p>If stipulation of the time of performance is left to the volition of the creditor or the debtor and the entitled person fails to stipulate a deadline even after a reminder the other party may request that the court set an appropriate deadline for performance.</p>	<p>Kad je određivanje vremena ispunjenja ostavljeno na volju poverioca ili dužnika, druga strana može, ako ovlašćenik ne odredi rok ni posle opomene, zahtevati od suda da odredi primeren rok za ispunjenje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 299 Detyrimi monetar</p>	<p style="text-align: center;">Article 299 Pecuniary obligations</p>	<p style="text-align: center;">Član 299 Novčana obaveza</p>
<p>1. Në rast se pagesat bëhen me ndërmjetësimin e bankës ose të organizatës tjetër pranë së cilës mbahet llogaria e kreditorit dhe derisa palët kontraktuese të mos e kenë përcaktuar ndryshe, konsiderohet se borxhi është likuiduar në kohën kur bankës ose organizatës pranë së cilës mbahet llogaria t'i ketë arritur dërgesa e të hollave në dobi të kreditorit ose urdhri i bankës së debitorit ose i organizatës që t'i akordojë llogarisë së kreditorit shumën e shënuar në urdhër.</p>	<p>1. If paid through the mediation of a bank or other organization at which the creditor has an account and unless stipulated otherwise by the contracting parties a debt shall be deemed to have been settled when a money transfer in favor of the creditor or an order from the debtor's bank or organization to approve the amount stated therein for the creditor's account reaches the bank or organization at which the creditor has an account.</p>	<p>1. Ako se plaćanje vrši posredstvom banke ili druge organizacije kod koje se vodi račun poverioca i ukoliko ugovorne strane nisu drukčije odredile, smatraće se da je dug likvidiran kada banci, odnosno organizaciji kod koje se vodi račun, stigne novčana doznaka u korist poverioca ili nalog dužnikove banke, odnosno organizacije da odobri računu poverioca iznos označen u nalogu.</p>
<p>2. Në rast se me kontratë është</p>	<p>2. If payment by post is agreed upon by</p>	<p>2. Ako je ugovorom predviđeno plaćanje</p>



<p>parashikuar pagesa me anë të postës, supozohet se palët janë pajtuar se me pagesën e shumës së debituar në postë, debitori e ka likuiduar detyrimin e vet ndaj kreditorit; në rast se palët nuk janë pajtuar për një mënyrë të tillë të pagesës, borxhi është i likuiduar kur kreditori të marrë dërgesën e të hollave.</p>	<p>contract the parties shall be presumed to have agreed that by paying the stipulated sum in at the post office the debtor will have settled the liability to the creditor; if such a manner of payment is not agreed the debt shall be settled when the creditor receives the money transfer.</p>	<p>preko poste pretpostavlja se da su stranke saglasne da je uplatom dužnog iznosa pošti dužnik izmirio svoju obavezu prema poveriocu, a ako ovakav način plaćanja nije ugovoren od strana, dug je likvidiran kad poverilac primi novčanu doznaku.</p>
<p>VII. VENDI I PËRMBUSHJES</p>	<p>VII. PLACE OF PERFORMANCE</p>	<p>VII. MESTO ISPUNJENJA</p>
<p>Neni 300 Rregulla të përgjithshme</p>	<p>Article 300 General rules</p>	<p>Član 300 Opšta pravila</p>
<p>1. Debitori është i detyruar ta përmbushë detyrimin, kurse kreditori ta pranojë përmbushjen në vendin e caktuar me punën juridike ose me ligj.</p> <p>2. Kur vendi i përmbushjes nuk është caktuar, dhe nuk mund të caktohet as sipas qëllimit të punës, natyrës së detyrimit apo të rrethanave tjera, atëherë përmbushja e detyrimit bëhet në vendin ku debitori në kohën e krijimit të detyrimit e ka pasur selinë, respektivisht vendbanimin e vet, e në mungesë të vendbanimit, ku ka pasur vendqëndrimin e tij.</p> <p>3. Mirëpo, në qoftë se debitori është person juridik që ka disa njësi në vende të</p>	<p>1. The debtor shall be obliged to perform the obligation and the creditor shall be obliged to accept it at a place stipulated by the legal transaction or by law.</p> <p>2. If the place of performance is not stipulated and cannot be stipulated according to the purpose of the transaction, the nature of the obligation or any other circumstances it shall be necessary to perform the obligation in the place where the debtor had a head office or residence when the obligation originated, and if the residence is missing the place where the person resides will be considering.</p> <p>3. If the debtor is a legal person or sole trader that has units in different areas the</p>	<p>1. Dužnik je dužan ispuniti obavezu, a poverilac primiti ispunjenje u mestu određenom pravnim poslom ili zakonom.</p> <p>2. Kad mesto ispunjenja nije određeno, a ne može se odrediti ni po svrsi posla, prirodi obaveze ili ostalim okolnostima, tada ispunjenje obaveze vrši se u mestu u kome je dužnik u vreme nastanka obaveze imao svoje sedište, odnosno prebivalište, a u nedostatku prebivališta, svoje boravište.</p> <p>3. Međutim, ako je dužnik pravno lice koje ima više jedinica u raznim mestima,</p>



<p>ndryshme, atëherë si vend i përmbushjes konsiderohet selia e njësisë e cila duhet t'i zbatojë veprimet e domosdoshme për përmbushjen e detyrimit, në qoftë se kjo rrethanë për kreditorin me rastin e lidhjes së kontratës ka qenë e njohur ose është dashur të jetë e njohur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 301 Vendi i përmbushjes së detyrimeve në para</p> <p>1. Detyrimet në para përmbushen në vendin ku kreditori e ka selinë, respektivisht vendbanimin, e në mungesë të vendbanimit aty ku e ka vendqëndrimin.</p> <p>2. Në qoftë se pagimi bëhet me urdhër (virman), detyrimet në para përmbushën në selinë e institucionit financiar pranë së cilës mbahen paratë e kreditorit.</p> <p>3. Në qoftë se kreditori e ka ndërruar vendin ku e ka pasur selinë, respektivisht vendbanimin e vet në kohën e krijimit të detyrimit, kështu që për këtë arsye janë rritur shpenzimet e përmbushjes, kjo rritje bie në ngarkim të kreditorit.</p>	<p>place of performance shall be deemed to be the seat of the unit that must do what is required for the performance of the obligation if when the contract was concluded the creditor knew or should have known of this circumstance.</p> <p style="text-align: center;">Article 301 Place of performance of pecuniary obligations</p> <p>1. Pecuniary obligations shall be performed in the place where the creditor has a head office or residence, and if the residence is missing the place where the person resides will be considering</p> <p>2. If the payment is made by order the pecuniary obligations shall be performed at the head office of the organization where the creditor's cash funds are.</p> <p>3. If the creditor changes the place where the creditor had a head office or residence when the obligation originated and the costs of performance increase for this reason the increase in costs shall be at the creditor's expense.</p>	<p>kao mesto ispunjenja smatra se sedište jedinice koja treba da izvrši radnje neophodne za ispunjenje obaveze, ako je poveriocu ta okolnost pri zaključenju ugovora bila poznata ili morala biti poznata.</p> <p style="text-align: center;">Član 301 Mesto ispunjenja novčanih obaveza</p> <p>1. Novčane obaveze ispunjavaju se u mestu u kome poverilac ima sedište odnosno prebivalište, a u nedostatku prebivališta, boravište.</p> <p>2. Ako se plaćanje vrši nalogom (virmanom), novčane obaveze se ispunjavaju u sedištu organizacije kod koje se vode poveriočeva novčana sredstva.</p> <p>3. Ako je poverilac promenio mesto u kome je imao svoje sedište, odnosno prebivalište u vreme kad je obaveza nastala te su zbog toga povećani troškovi ispunjenja, to povećanje pada na teret poverioca.</p>
--	---	--



VIII. DËFTESA	VIII. RECEIPT	VIII. PRIZNANICA
<p data-bbox="247 337 678 402" style="text-align: center;">Neni 302 Prezumimet lidhur me dëftesën</p> <p data-bbox="184 483 741 621">1. Kush e përmbush detyrimin në tërësi ose pjesërisht, ka të drejtë të kërkojë që kreditori për këtë gjë t'i lëshojë dëftesën me shpenzimet e veta.</p> <p data-bbox="184 667 741 841">2. Debitori i cili e ka paguar detyrimin në para përmes bankës ose postës, mund të kërkojë që kreditori t'i lëshojë dëftesën vetëm në qoftë se për këtë gjë ka shkak të arsyeshëm.</p> <p data-bbox="184 886 741 1060">3. Në qoftë se është lëshuar dëftesa se është paguar kërkesa kryesore në tërësi, supozohet se janë paguar edhe kamatat dhe shpenzimet gjyqësore të tjera nëse ka pasur të tilla.</p> <p data-bbox="184 1105 741 1393">4. Në qoftë se debitori me prestime periodike, siç janë qiratë dhe kërkesat e tjera që përlllogariten periodikisht, siç janë ato që krijohen me harxhimin e energjisë elektrike, ose të ujit, telefonit, ka dëftesën se e ka paguar kërkesën e arritur më vonë për pagesë, supozohet se i ka paguar edhe ato që kanë arritur më përpara për pagesë.</p>	<p data-bbox="814 337 1255 443" style="text-align: center;">Article 302 Presumptions in connection with receipt</p> <p data-bbox="758 483 1314 621">1. Any person that fully or partly performs an obligation shall have the right to request that the creditor issue a receipt at the expense of the latter.</p> <p data-bbox="758 667 1314 805">2. A debtor that pays a pecuniary obligation via a bank or post office may only request a receipt from the creditor if there are justifiable grounds for so doing.</p> <p data-bbox="758 886 1314 1024">3. If a receipt is issued for the full payment of a principal, it shall be presumed that the interest and any court costs and other costs have also been paid.</p> <p data-bbox="758 1105 1314 1393">4. If a debtor with periodic charges such as rent and other claims charged periodically such as claims originating from the use of electricity, water or telephone has a receipt for payment of claims due later it shall be presumed that those falling due for payment before have been paid.</p>	<p data-bbox="1367 337 1850 402" style="text-align: center;">Član 302 Pretpostavke u vezi sa priznanicom</p> <p data-bbox="1331 483 1887 621">1. Ko ispuni obavezu potpuno ili delimično, ima pravo zahtevati da mu poverilac o tome, o svome trošku, izda priznanicu.</p> <p data-bbox="1331 667 1887 805">2. Dužnik koji je novčanu obavezu isplatio preko banke ili pošte, može zahtevati da mu poverilac izda priznanicu samo ako za to ima opravdan razlog.</p> <p data-bbox="1331 886 1887 1024">3. Ako je izdata priznanica da je potpuno isplaćena glavnica, pretpostavlja se da su isplaćene i kamate i sudski i drugi troškovi, ako ih je bilo.</p> <p data-bbox="1331 1105 1887 1393">4. Ako dužnik povremenih davanja, kao što su zakupnine, i drugih potraživanja koja se povremeno obračunavaju, kao što su ona koja nastaju utroškom električne energije, ili vode, telefona, ima priznanicu da je isplatio docnije dospelo potraživanje pretpostavlja se da je isplatio i ona koja su ranije dospela.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 303 Refuzimi i lëshimit të dëftesës</p> <p>Në qoftë se kreditori refuzon të lëshojë dëftesën, debitori mund të depozitojë në gjykatë objektin e detyrimit të vet.</p> <p>IX. KTHIMI I FLETËOBLIGACIONIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 304 Kthimi i fletëobligacionit</p> <ol style="list-style-type: none">1. Kur e përmbush detyrimin e vet në tërësi, debitori mundet, përpos dëftesës, të kërkojë nga kreditori që t’ia kthejë fletëobligacionin.2. Kur kreditori nuk mund ta kthejë fletëobligacionin, debitori ka të drejtë të kërkojë që kreditori t’i lëshojë një dokument publik të vërtetuar se detyrimi ka pushuar së ekzistuari.3. Në qoftë se debitorit i është kthyer fletëobligacioni, supozohet se detyrimi është përmbushur plotësisht.4. Debitori që e ka përmbushur detyrimin vetëm pjesërisht, ka të drejtë të kërkojë që kjo përmbushje të shënohet në fletëobligacion.	<p style="text-align: center;">Article 303 Refusal of receipt</p> <p>If the credit refuses to provide a receipt the debtor may deposit the subject of the obligation with the court.</p> <p>IX. RETURN OF IOU</p> <p style="text-align: center;">Article 304 Return of IOU</p> <ol style="list-style-type: none">1. When a debtor performs the obligation in full the debtor may request that in addition to a receipt the creditor also return the IOU thereto.2. If the creditor is unable to return the IOU the debtor shall have the right to request that the former issue a publicly certified document stating that the obligation has terminated.3. If the IOU has been returned to the debtor it shall be presumed that the obligation has been performed in full.4. A debtor that has only performed the obligation in part shall have the right to request that such performance be recorded on the IOU.	<p style="text-align: center;">Član 303 Odbijanje izdavanja priznanice</p> <p>Ako poverilac odbije izdati priznanicu, dužnik može položiti kod suda predmet svoje obaveze.</p> <p>IX. VRAĆANJE OBVEZNICE</p> <p style="text-align: center;">Član 304 Vraćanje obveznice</p> <ol style="list-style-type: none">1. Kad potpuno ispuni svoju obavezu, dužnik može, pored priznanice, zahtevati od poverioca da mu vrati obveznicu.2. Kad poverilac ne može da vrati obveznicu, dužnik ima pravo zahtevati da mu poverilac izda jednu javno overenu ispravu da je obaveza prestala.3. Ako je dužniku vraćena obveznica, pretpostavlja se da je obaveza potpuno ispunjena.4. Dužnik koji je ispunio obavezu samo delimično, ima pravo zahtevati da se to ispunjenje zabeleži na obveznici.
---	---	---



<u>NËNKREU 2</u> <u>VONESA</u>	<u>SUBCHAPTER 2</u> <u>DELAY</u>	<u>PODGLAVLJE 2</u> <u>DOCNJA</u>
<p>I. VONESA E DEBITORIT</p> <p>Neni 305 Kur debitori është në vonesë</p> <p>1. Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje.</p> <p>2. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtëgjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit.</p>	<p>I. DEBTOR'S DELAY</p> <p>Article 305 When debtor is in delay</p> <p>1. The debtor shall be deemed to be in delay if the debtor fails to perform the obligation by the deadline stipulated for performance.</p> <p>2. If no deadline for performance is stipulated the debtor shall be deemed to be in delay when, verbally or in writing via an extra-judicial reminder or by initiating any procedure whose purpose is to achieve the performance of the obligation, the creditor demands that the debtor perform the obligation.</p>	<p>I. DOCNJA DUŽNIKA</p> <p>Član 305 Kad dužnik dolazi u docnju</p> <p>1. Dužnik dolazi u docnju kad ne ispuni obavezu u roku određenom za ispunjenje.</p> <p>2. Ako rok za ispunjenje nije određen, dužnik dolazi u docnju kad ga poverilac pozove da ispuni obavezu, usmeno ili pismeno, vansudskom opomenom ili započinjanjem nekog postupka čija je svrha da se postigne ispunjenje obaveze.</p>
<p>II. VONESA E KREDITORIT</p> <p>Neni 306 Kur kreditori është në vonesë</p> <p>1. Kreditori është në vonesë në qoftë se pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon të pranojë përmbushjen, ose me sjelljet e veta e parandalon atë.</p> <p>2. Kreditori është në vonesë edhe kur</p>	<p>II. CREDITOR'S DELAY</p> <p>Article 306 When creditor is in delay</p> <p>1. The creditor shall be deemed to be in delay if without justifiable grounds the creditor refuses to accept performance or prevents it by the action thereof.</p> <p>2. The creditor shall also be deemed to be</p>	<p>II. DOCNJA POVERIOCA</p> <p>Član 306 Kad poverilac dolazi u docnju</p> <p>1. Poverilac dolazi u docnju ako bez osnovanog razloga odbije da primi ispunjenje ili ga svojim ponašanjem spreči.</p> <p>2. Poverilac dolazi u docnju i kad je</p>



<p>është i gatshëm të pranojë përmbushjen e detyrimit të njëkohshëm të debitorit, por nuk ofron përmbushjen e detyrimit të vet të arritur për pagesë.</p> <p>3. Kreditori nuk është në vonesë në qoftë se provon se në kohën e ofrimit të përmbushjes, ose në kohën e caktuar për përmbushje, debitori ka qenë në pamundësi ta përmbushë detyrimin e vet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 307 Efektet e vonesës së kreditorit</p> <p>1. Me vonesën e kreditorit shuhet vonesa e debitorit dhe në kreditorin kalon rreziku i shkatërrimit ose te dëmtimit te rastesishëm të sendit.</p> <p>2. Që nga dita e vonesës së kreditorit pushon të rrjedhë kamata.</p> <p>3. Kreditori në vonesë ka për detyrë t'i shpërblejë debitorit dëmin e krijuar për shkak të vonesës, për të cilën përgjigjet, si dhe shpenzimet rreth ruajtjes së mëtejshme të sendeve.</p>	<p>in delay if when the creditor is ready to accept the performance of the debtor's simultaneous obligation the creditor fails to offer to perform the creditor's own due obligation.</p> <p>3. The creditor shall not be deemed to be in delay if it is shown that at the time performance was offered or at the time stipulated for performance the debtor was not able to perform the debtor's obligations.</p> <p style="text-align: center;">Article 307 Effect of creditor's delay</p> <p>1. If the creditor is in delay the debtor's delay shall terminate and the risk of accidental destruction of or damage to things shall be transferred to the former.</p> <p>2. Interest shall cease to be charged from the day the creditor is first in delay.</p> <p>3. A creditor in delay shall be obliged to reimburse the debtor for damage incurred because of the delay for which the former is culpable, and any costs in connection with the further safekeeping of things.</p>	<p>spreman da primi ispunjenje dužnikove istovremene obaveze, ali ne nudi ispunjenje svoje dospele obaveze.</p> <p>3. Poverilac ne dolazi u docnju ako dokaže da u vreme ponude ispunjenja, ili u vreme određeno za ispunjenje, dužnik nije bio u mogućnosti da svoju obavezu ispuni.</p> <p style="text-align: center;">Član 307 Dejstva poveriočeve docnje</p> <p>1. Dolaskom poverioca u docnju prestaje docnja dužnika, i na poverioca prelazi rizik slučajne propasti ili oštećenja stvari.</p> <p>2. Od dana poveriočeve docnje prestaje teći kamata.</p> <p>3. Poverilac u docnji je dužan naknaditi dužniku štetu nastalu usled docnje za koju odgovara, kao i troškove oko daljeg čuvanja stvari.</p>
--	---	--



<p style="text-align:center"><u>NËNKREU 3</u> <u>DEPOZITIMI DHE SHITJA E</u> <u>SENDIT QË ËSHTË BORXH</u></p>	<p style="text-align:center"><u>SUBCHAPTER 3</u> <u>DEPOSIT OF THINGS</u></p>	<p style="text-align:center"><u>PODGLAVLJE 3</u> <u>POLAGANJE I PRODAJA</u> <u>DUGOVANE STVARI</u></p>
<p style="text-align:center">Neni 308 Depozitimi në gjykatë</p> <p>1. Kur kreditori është në vonesë ose është i panjohur apo kur është e pasigurt se kush është kreditor ose ku ndodhet ai, ose kur kreditori është i paafte për të vepruar dhe nuk ka përfaqësues debitori mund ta depozitojë sendin të cilin e ka borxh në gjykatë për kreditorin.</p> <p>2. Të njëjtën të drejtë e kanë edhe personat e tretë të cilët kanë interes juridik që detyrimi të përmbushet.</p> <p>3. Për depozitimin e bërë debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin po qe se di për te dhe për vendbanimin e tij.</p>	<p style="text-align:center">Article 308 Deposit of things with court</p> <p>1. If the creditor is in delay or is unknown, or it is not known reliably who or where the creditor is or if the creditor has incapacity to contract and does not have a representative the debtor may deposit the owed thing with the court for the creditor.</p> <p>2. Others that have a legal interest in the obligation being performed shall also have this right.</p> <p>3. The debtor must notify the creditor regarding the deposit, if the debtor knows who the creditor is and knows of the creditor's place of residence.</p>	<p style="text-align:center">Član 308 Polaganje kod suda</p> <p>1. Kad je poverilac u docnji, ili je nepoznat, ili kad je neizvesno ko je poverilac ili gde se nalazi, ili kad je poverilac poslovno nesposoban a nema zastupnika, dužnik može položiti dugovanu stvar kod suda za poverioca.</p> <p>2. Isto pravo imaju i treća lica koja imaju pravni interes da obaveza bude ispunjena.</p> <p>3. O izvršenom polaganju dužnik je dužan izvestiti poverioca ako zna za njega i za njegovo boravište.</p>
<p style="text-align:center">Neni 309 Gjykata kompetente për depozitim</p> <p>1. Depozitimi bëhet në gjykatën e kompetencës lëndore në vendin e përmbushjes, përveç nëse për shkaqet e leverdisë ekonomike ose nga vetë natyra e punës kërkohet që depozitimi të bëhet në vendin ku ndodhet sendi.</p>	<p style="text-align:center">Article 309 With which court thing is deposited</p> <p>1. A thing shall be deposited with the court of jurisdiction in the place of performance, unless economy or the nature of the transaction demands the deposit be in the place where the thing is.</p>	<p style="text-align:center">Član 309 Nadležni sud za polaganje</p> <p>1. Polaganje se vrši kod stvarno nadležnog suda u mestu ispunjenja, osim ako razlozi ekonomičnosti ili priroda posla zahtevaju da se polaganje izvrši u mestu gde se stvar nalazi.</p>



<p>2. Çdo gjykatë tjetër me kompetencë lëndore duhet ta pranojë sendin në depozitë, ndërsa debitori ka për detyrë t'i japë shpërblim kreditorit në qoftë se ky ka pësuar dëm nga depozitimi në gjykatën tjetër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 310 Dorëzimi për ruajtje personit tjetër</p> <p>1. Kur objekti i detyrimit është ndonjë send që nuk mund të ruhet në depozitin gjyqësor, debitori mund të kërkojë nga gjykata që ta caktojë personin të cilit do t'ia dorëzojë sendin për ruajtje, me shpenzime dhe për llogari të kreditorit.</p> <p>2. Në rast të detyrimit nga kontrata në ekonomi, dorëzimi i sendit të tillë në depon publike për ruajtjen për llogari të kreditorit e ka efektin e depozitimit në gjykatë.</p> <p>3. Për dorëzimin e bërë për ruajtje debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin.</p>	<p>2. Any other court of jurisdiction must accept the thing for safekeeping, and the debtor must provide the creditor with compensation if any damage is incurred thereby through the deposit of the thing at the other court.</p> <p style="text-align: center;">Article 310 Delivery to other person for safekeeping</p> <p>1. If the subject of the obligation is any kind of thing that cannot be kept at the court the debtor may request that the court designate a person to whom the thing should be delivered at the expense of and for the account of the creditor.</p> <p>2. For an obligation from a commercial contract the delivery of such a thing to a public warehouse for safekeeping for the creditor's account shall have the effect of deposit with the court.</p> <p>3. The debtor must notify the creditor regarding delivery into safekeeping.</p>	<p>2. Svaki drugi stvarno nadležni sud mora primiti stvar u depozit, a dužnik je dužan dati naknadu poveriocu ako je ovaj polaganjem kod drugog suda pretrpeo štetu.</p> <p style="text-align: center;">Član 310 Predaja na čuvanje drugom licu</p> <p>1. Kad je predmet obaveze neka stvar koja se ne može čuvati u sudskom depozitu, dužnik može zahtevati od suda da odredi lice kome će predati stvar da je čuva o trošku i za račun poverioca.</p> <p>2. U slučaju obaveze iz ugovora u privredi, predaja takve stvari javnom skladištu na čuvanje za račun poverioca proizvodi dejstvo polaganja kod suda.</p> <p>3. O izvršenoj predaji na čuvanje dužnik je dužan obavestiti poverioca.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 311 Rikthimi i sendit të depozituar</p> <p>1. Debitori mund ta rikthen sendin e depozituar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 311 Retrieval of deposited things</p> <p>1. The debtor may retrieve the deposited thing.</p>	<p style="text-align: center;">Član 311 Uzimanje položene stvari natrag</p> <p>1. Dužnik može uzeti natrag položenu stvar.</p>



<p>2. Për rikthimin e sendit të depozituar ka për detyrë ta njoftojë kreditorin.</p> <p>3. E drejta e debitorit për ta rikthyer sendin e depozituar shuhet kur debitori i deklaron gjykatës se heq dorë nga kjo e drejtë, kur kreditori deklaron se e pranon sendin e depozituar, si dhe kur vërtetohet me aktgjykim të plotfuqishëm se depozitimi i plotëson kushtet e përmbushjes së rregullt.</p> <p style="text-align: center;">Neni 312 Efekti i depozitimit</p> <p>1. Me depozitim të sendit që është borxh, debitori lirohet nga detyrimi në çastin kur e ka bërë depozitim.</p> <p>2. Në qoftë se debitori ka qenë në vonesë, vonesa e tij shuhet.</p> <p>3. Që nga çasti kur sendi është depozituar, rreziku i shkatërrimit të rastësishëm ose i dëmtimit të sendit kalon në kreditorin.</p> <p>4. Që nga dita e depozitimit shuhet rrjedha e kamatës.</p> <p>5. Në qoftë se debitori e merr sendin e depozituar, konsiderohet njësoj sikur të mos ta kishte depozituar fare dhe bashkëdebitorët dhe dorëzanët e tij mbeten në detyrim.</p>	<p>2. The debtor must inform the creditor that the thing has been retrieved.</p> <p>3. The debtor's right to retrieve the deposited thing shall expire if the debtor declares to the court that this right is being waived, if the creditor declares that the deposited thing is accepted or if a final legal ruling determines that the deposit fulfils the conditions for correct performance.</p> <p style="text-align: center;">Article 312 Effect of deposit</p> <p>1. By depositing the owed thing the debtor shall be released from the obligation when the thing is deposited.</p> <p>2. If the debtor was in delay the delay shall terminate.</p> <p>3. After the thing is deposited the risk of the accidental destruction thereof or damage thereto shall thenceforth be transferred to the creditor.</p> <p>4. Interest shall cease to be charged from the day of the deposit.</p> <p>5. If the debtor retrieves the deposited thing the deposit shall be deemed never to have been made, and the debtor's fellow debtors and sureties shall remain bound.</p>	<p>2. O uzimanju stvari dužnik je dužan obavestiti poverioca.</p> <p>3. Pravo dužnika da uzme položenu stvar prestaje kad dužnik izjavi sudu da se odriče tog prava, kad poverilac izjavi da prima položenu stvar, kao i kad bude utvrđeno pravnosnažnom odlukom da polaganje ispunjava uslove urednog ispunjenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 312 Dejstvo polaganja</p> <p>1. Polaganjem dugovane stvari dužnik se oslobađa obaveze u času kad je izvršio polaganje.</p> <p>2. Ako je dužnik bio u docnji, njegova docnja prestaje.</p> <p>3. Od časa kada je stvar položena, rizik slučajne propasti ili oštećenja stvari prelazi na poverioca.</p> <p>4. Od dana polaganja prestaje teći kamata.</p> <p>5. Ako dužnik uzme natrag položenu stvar, smatraće se kao da nije bilo polaganja, a njegovu sadužnici i jemci ostaju u obavezi.</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 313 Shpenzimet e depozitimit</p> <p>Shpenzimet e depozitimit të plotfuqishëm e të parevokueshëm i përballon kreditori në qoftë se i kalojnë shpenzimet e përmbushjes që ka për detyrë t'i paguaj debitori.</p>	<p style="text-align: center;">Article 313 Costs of deposit</p> <p>The costs of a valid, unconcealed deposit shall be paid by the creditor in the part that exceeds the costs of performance, which must be paid by the debtor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 313 Troškovi polaganja</p> <p>Troškove punovažnog i neopozvanog polaganja snosi poverilac ukoliko prelaze troškove ispunjenja koje je dužan snositi dužnik.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 314 Shitja në vend të depozitimit të sendit</p> <p>1. Në qoftë se sendi është i papërshtatshëm për ruajtje apo në qoftë se për ruajtjen ose për mirëmbajtjen e tij nevojiten shpenzime të cilat nuk janë në përpjestim me vlerën e tij, debitori mund ta shesë, në shitjen e bërë publike në vendin e caktuar për përmbushje apo në ndonjë vend tjetër në qoftë se kjo është në interesin e kreditorit, kurse shumën e arritur, pasi të jenë zbritur shpenzimet e shitjes, ta depozitojnë në gjykatën e atij vendi.</p> <p>2. Në qoftë se sendi ka çmimin vijues, apo në qoftë se ka vlerë të vogël në krahasim me shpenzimet e shitjes publike, debitori lirisht mund ta shesë.</p> <p>3. Në qoftë se sendi është i tillë që mund të shkatërrohet apo të prishet, debitori ka për detyrë ta shesë pa shtyrje në një mënyrë sa më të përshtatshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 314 Sale instead of deposit of thing</p> <p>1. If a thing is not suitable for safekeeping or if the costs required for the safekeeping or maintenance thereof are in disproportion to its value the debtor may sell it at a public auction in the place stipulated for performance or in any other place if such is in the creditor's interest, and after allowing for expenses shall deposit the sum thus obtained with the court in such place.</p> <p>2. If the thing has a daily price or if it is of little value in comparison to the cost of a public auction the debtor may sell it out of hand.</p> <p>3. If the thing is such that it could be rapidly destroyed or spoiled the debtor must sell it without delay in the most suitable manner.</p>	<p style="text-align: center;">Član 314 Prodaja umesto polaganja stvari</p> <p>1. Ako je stvar nepodesna za čuvanje, ili ako su za njeno čuvanje ili za njeno održavanje potrebni troškovi nesrazmerni sa njenom vrednošću, dužnik je može prodati na javnoj prodaji u mestu određenom za ispunjenje, ili nekom drugom mestu ako je to u interesu poverioca, a postignuti iznos, po odbitku troškova prodaje, položiti kod suda tog mesta.</p> <p>2. Ako stvar ima tekuću cenu, ili ako je male vrednosti u poređenju sa troškovima javne prodaje, dužnik je može prodati iz slobodne ruke.</p> <p>3. Ako je stvar takva da može brzo propasti ili se pokvariti, dužnik je dužan prodati je bez odlaganja na najpogodniji način.</p>



<p>4. Në çdo rast, debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin për shitjen që ka ndërmend ta bëjë kurdo që të jetë e mundur, e pas shitjes së bërë ta njoftojë për çmimin e realizuar dhe për depozitimin e tij në gjykatë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 315 Dorëzimi i sendit kreditorit</p> <p>Gjykata do t'ia dorëzojë kreditorit sendin e depozituar sipas kushteve që i ka caktuar debitori.</p> <p style="text-align: center;">Neni 316 Shitja për të mbuluar shpenzimet e ruajtjes</p> <p>1. Në qoftë se shpenzimet e ruajtjes nuk paguhen brenda afatit të arsyeshëm, gjykata do të urdhërojë me kërkesën e ruajtësit, që sendi të shitet dhe do të caktojë mënyrën e shitjes.</p> <p>2. Nga shuma e realizuar prej shitjes do të zbriten shpenzimet e shitjes dhe shpenzimet e ruajtjes, ndërsa KREU që mbetet do të depozitohet në gjykatë për kreditorin.</p>	<p>4. In each case the debtor must whenever possible notify the creditor regarding the intended sale and, after the sale, regarding the price obtained and the deposit thereof with the court.</p> <p style="text-align: center;">Article 315 Delivery of thing to creditor</p> <p>The court shall deliver the deposited thing to the creditor under the conditions set by the debtor.</p> <p style="text-align: center;">Article 316 Sale to cover costs of safekeeping</p> <p>1. If the costs of safekeeping are not paid by an appropriate deadline the court shall at the request of the depositary order the sale of the thing and shall stipulate the manner of sale.</p> <p>2. The costs of the sale and the costs of safekeeping shall be deducted from the sum obtained and the remainder shall be deposited with the court for the creditor.</p>	<p>4. U svakom slučaju, dužnik je dužan obavestiti poverioca o nameravanoj prodaji kad god je to moguće, a po izvršenoj prodaji, o postignutoj ceni i njenom polaganju kod suda.</p> <p style="text-align: center;">Član 315 Predavanje stvari poveriocu</p> <p>Sud će predati poveriocu položenu stvar pod uslovima koje je dužnik postavio.</p> <p style="text-align: center;">Član 316 Prodaja radi pokrića troškova čuvanja</p> <p>1. Ako troškovi čuvanja ne budu isplaćeni u razumnom roku, sud će, na traženje čuvara, narediti da se stvar proda i odrediti način prodaje.</p> <p>2. Od iznosa dobijenog prodajom odbiće se troškovi prodaje i troškovi čuvanja, a ostatak položiti kod suda za poverioca.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;">KREU 3 MËNYRAT TJERA TË SHUARJES SË DETYRIMIT</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER 3 OTHER WAYS FOR OBLIGATION TO TERMINATE</p>	<p style="text-align: center;">GLAVA 3 OSTALI NAÇINI GAŠENJA OBAVEZA</p>
<p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 1</u> <u>KOMPENSIMI</u></p>	<p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 1</u> <u>OFFSET (COMPENSATION)</u></p>	<p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 1</u> <u>KOMPENZACIJA</u></p>
<p style="text-align: center;">Neni 317 Kushtet e përgjithshme</p>	<p style="text-align: center;">Article 317 General conditions</p>	<p style="text-align: center;">Član 317 Opšti uslovi</p>
<p>kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi.</p> <p>4. Kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë (15) vite pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 358 Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale</p> <p>1. Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.</p> <p>2. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.</p> <p>3. E njëjta vlen edhe për ndaljen e parashkrimit.</p>	<p>contractual obligation shall become statute-barred after the period stipulated for the statute-barring of the obligation.</p> <p>4. Compensation claims for damage inflicted through an act of sexual abuse of a minor shall become statute-barred fifteen years after the minor comes of age.</p> <p style="text-align: center;">Article 358 Compensation claims for damage inflicted by criminal offence</p> <p>1. If the damage was inflicted by a criminal offence and a longer statute-barring period is stipulated for criminal prosecution, a compensation claim against the person responsible shall become statute-barred when the period stipulated for the statute-barring of criminal prosecution expires.</p> <p>2. The discontinuance of statute-barring of criminal prosecution shall have as a consequence the discontinuance of statute-barring of the compensation claim.</p> <p>3. This shall also apply to the suspension of statute-barring.</p>	<p>vreme određeno za zastarelost te obaveze.</p> <p>4. Potraživanja štete nastale zbog seksualnog zlostavljanja maloletnika, zastarevaju petnaest (15) godina od trenutka kada je maloletnik stupio u punoletstvo.</p> <p style="text-align: center;">Član 358 Potraživanje naknade štete prouzrokovane krivičnim delom</p> <p>1. Kad je šteta prouzrokovana krivičnim delom, a za krivično gonjenje je predviđen duži rok zastarelosti, zahtev za naknadu štete prema odgovornom licu zastareva kad istekne vreme određeno za zastarelost krivičnog gonjenja.</p> <p>2. Prekid zastarevanja krivičnog gonjenja povlači za sobom i prekid zastarevanja zahteva za naknadu štete.</p> <p>3. Isto važi i za zastoje zastarevanja.</p>
---	--	---



Neni 359 Kompensimi i kërkesave për arsye të korrupsionit	Article 359 Compensation claims for reason of corruption	Član 359 Kompenzacija potraživanja zbog korupcije
<p>Në rast se dëmi është shkaktuar nga akti në të cilin ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkesa e “ryshfetit“ ose ndonjë përfitimi tjetër ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ose nga mosveprimi apo veprimi që do të kishte parandaluar aktin e korrupsionit, ose nga ndonjë akt tjetër që sipas ligjit ose traktatit ndërkombëtar paraqet korrupsion, kërkesa parashkruhet pesë (5) vite pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë; në cilindo rast, ajo parashkruhet pesëmbëdhjetë (15) vite pas kryerjes së aktit.</p>	<p>If the damage was inflicted by an act on which the offering, provision, acceptance or demanding of a bribe or any other benefit or the promise thereof had a direct or indirect influence, or by the omission of action that would have prevented an act of corruption, or by any other act that according to law or international treaty entails corruption, the claim shall become statute-barred five years after the injured party learnt of the damage and of the person that inflicted it; in any case it shall become statute-barred fifteen years after the act was committed.</p>	<p>Ako je šteta prouzrokovana radnjom u kojoj je ponuda, davanje, primanje ili traženje "mita" ili bilo kakve druge koristi imala direktan ili indirektan uticaj, bilo nečinjenjem ili radnjom kojom bi se mogao sprečiti čin korupcije, ili bilo koja druga radnja koja na osnovu zakona ili međunarodnog ugovora predstavlja korupciju, potraživanje zastareva pet (5) godina nakon što je oštećena strana saznala za štetu i lice koje je prouzrokovalo, a u svakom slučaju, ono zastareva petnaest (15) godina nakon radnje.</p>
Neni 360 Afati njëvjeçar i parashkrimit	Article 360 One-year statute-barring period	Član 360 Jednogodišnji rok zastarelosti
<p>1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti:</p> <p>1.1. Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;</p> <p>1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit;</p>	<p>1. The following shall become statute-barred after one year:</p> <p>1.1. claims for supplied electricity, thermal energy, gas, and water, for chimney-sweeping services and for municipal cleaning services, if the supply or service was carried out for the needs of a household;</p> <p>1.2. radio and television stations' claims for station reception;</p>	<p>1. Potraživanja koja zastarevaju za jednu godinu:</p> <p>1.1. potraživanje naknade za isporučenu električnu i toplotnu energiju, plin, vodu, za dimničarske usluge i za usluge održavanje čistoće, kad je isporuka odnosno usluga izvršena za potrebe domaćinstva;</p> <p>1.2. potraživanje radija i televizije za upotrebu stanice;</p>



<p>1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtëra;</p> <p>1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi;</p> <p>1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e “faqes elektronike“, dhe shërbimet e lidhura me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtëra;</p> <p>1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtëra.</p> <p>2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.</p> <p>3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë.</p>	<p>1.3. claims by the post office and telecom companies for the use of telephones and PO boxes, and other claims thereby paid at three-monthly or shorter intervals;</p> <p>1.4. claims for subscription fees for periodic publications, counted from the end of the period for which the publication was ordered.</p> <p>1.5. claims for internet access services, services for the use of e-mail and e-mailboxes, website maintenance services, and services connected to access to cable and satellite radio and television stations paid at three-monthly or shorter intervals</p> <p>1.6. claims by the administrators of apartment blocks for services and other claims thereby paid at three-monthly or shorter intervals</p> <p>2. The statute-barring period shall run from the end of the year in which the claim fell due for payment.</p> <p>3. The statute-barring period shall run even if the supply and services continue.</p>	<p>1.3. potraživanje pošte i telekom kompanija za upotrebu telefona i poštanskih pregradaka, kao i druga njihova potraživanja koja se naplaćuju u tromesečnim ili kraćim rokovima;</p> <p>1.4. potraživanje pretplate na povremene publikacije, računajući od isteka vremena za koje je publikacija naručena.</p> <p>1.5. potraživanje za usluge priključka na internet, usluge korišćenja e-maila, usluge održavanja „elektronske stranice“, i usluge povezane sa pristupom kablovskim i satelitskim radio i televizijskim stanicama koje se naplaćuju u tromesečnim ili kraćim rokovima;</p> <p>1.6. potraživanja administratora blokova stambenih zgrada za usluge i druga potraživanja koja se naplaćuju u tromesečnim ili kraćim rokovima.</p> <p>2. Zastarevanje teče od kraja godine u kojoj potraživanje dospeva na naplatu.</p> <p>3. Zastarevanje teče iako su isporuke ili usluge produžene.</p>
---	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 361 Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente</p> <p>1. Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.</p> <p>2. Megjithatë, të gjitha kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujditë e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e paraparë për parashkrimin e kërkesave periodike.</p>	<p style="text-align: center;">Article 361 Claims determined before court or other relevant authority</p> <p>1. All claims determined by a final court ruling or by a ruling by another relevant authority or through settlement before the court or another relevant authority shall become statute-barred after ten years, including those for which a shorter period is stipulated by the statute of limitations.</p> <p>2. All periodic claims originating from such rulings or settlement and falling due in the future shall become statute-barred after the period stipulated for the statute-barring of periodic claims.</p>	<p style="text-align: center;">Član 361 Potraživanja utvrđena pred sudom ili drugim nadležnim organima</p> <p>1. Sva potraživanja koja su utvrđena pravnosnažnom sudskom odlukom ili odlukom drugog nadležnog organa, ili poravnanjem pred sudom ili drugim nadležnim organom, zastarevaju za deset godina, pa i ona za koja zakon inače predviđa kraći rok zastarelosti.</p> <p>2. Ipak, sva povremena potraživanja koja proističu iz takvih odluka ili poravnanja i dospevaju na naplatu u budućnosti, zastarevaju u roku predviđenom za zastarelost povremenih potraživanja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 362 Afatet e parashkrimit te kontratat për sigurimin</p> <p>1. Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, respektivisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë vjet, kurse nga kontratat e tjera për sigurimin – për tre vjet, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa.</p> <p>2. Në qoftë se personi i interesuar provon</p>	<p style="text-align: center;">Article 362 Statute-barring periods for insurance contracts</p> <p>1. Claims by the policyholder or a third person from a life assurance contract shall become statute-barred after five years, and claims from other insurance contracts shall become statute-barred after three years, counted from the first day after the end of the calendar year in which the claim originated.</p> <p>2. If the person concerned shows that such</p>	<p style="text-align: center;">Član 362 Rokovi zastarelosti kod ugovora o osiguranju</p> <p>1. Potraživanja ugovarača osiguranja, odnosno trećeg lica iz ugovora o osiguranju života zastarevaju za pet, a iz ostalih ugovora o osiguranju - za tri godine, računajući od prvog dana posle proteka kalendarske godine u kojoj je potraživanje nastalo.</p> <p>2. Ako zainteresovano lice dokaže da do</p>



<p>se deri në ditën e caktuar në paragrafin paraprak nuk ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, parashkrimi fillon që nga dita kur të ketë marrë dijëni për këtë, ashtu që në çdo rast kërkesa parashkruhet te sigurimi i jetës për dhjetë vjet, kurse te sigurimet e tjera për pesë vjet nga data e caktuar në paragrafin paraprak.</p> <p>3. Kërkesat e siguresit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre vjet.</p> <p>4. Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguarit ndaj siguresit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin.</p> <p>5. Kërkesa e drejtpërdrejtë e personit të tretë të dëmtuar ndaj siguresit parashkruhet për të njëjtën kohë për të cilën parashkruhet kërkesa e tij ndaj të siguarit përgjegjës për dëmin.</p> <p>6. Parashkrimi i kërkesës që i takon siguresit ndaj personit të tretë përgjegjës</p>	<p>person did not know that the insurance case had occurred by the day stipulated in the previous paragraph the statute-barring period shall run from the day such person learnt thereof; in any case the claim shall become statute-barred ten years after the day stipulated in the previous paragraph for life assurance and after five years for other types of insurance.</p> <p>3. Insurance agencies' claims from insurance contracts shall become statute-barred after three years.</p> <p>4. If in third party liability insurance an injured party claims or obtains compensation from an insured person the statute-barring period for the insured person's claim against the insurance agency shall run from the day the injured party made a judicial claim for compensation against the insured person or when the insured person reimbursed the damage.</p> <p>5. A direct claim by a third injured party against an insurance agency shall become statute-barred at the same time as the claim against the insured person liable for the damage becomes statute-barred.</p> <p>6. The statute-barring period for a claim held by an insurance agency against the</p>	<p>dana određenog u prethodnom stavu nije znalo da se osigurani slučaj dogodio, zastarevanje počinje od dana kad je za to saznalo, s tim da u svakom slučaju potraživanje zastareva kod osiguranja života za deset, a kod ostalih za pet godina od dana određenog u prethodnom stavu.</p> <p>3. Potraživanja osiguravača iz ugovora o osiguranju zastarevaju za tri godine.</p> <p>4. Kad u slučaju osiguranja od odgovornosti trećeg, oštećeno lice zahteva naknadu od osiguranika, ili je dobije od njega, zastarevanje osiguranikovog zahteva prema osiguravaču počinje od dana kada je oštećeno lice tražilo sudskim putem naknadu od osiguranika, odnosno kad ga je osiguranik obeštetio.</p> <p>5. Neposredan zahtev trećeg oštećenog lica prema osiguravaču zastareva za isto vreme za koje zastareva njegov zahtev prema osiguraniku odgovornom za štetu.</p> <p>6. Zastarevanje potraživanja koje pripada osiguravaču prema trećem licu</p>
--	--	--



<p>për paraqitjen e rastit të sigurimit fillon të rrjedhë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj këtij personi, dhe mbaron në të njëjtin afat.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 3</u> <u>NDALJA E PARASHKRIMIT</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 363 Kërkesat ndërmjet personave të caktuar</p> <p>1. Parashkrimi nuk rrjedh:</p> <p>1.1. ndërmjet bashkëshortëve;</p> <p>1.2. ndërmjet prindërve dhe fëmijëve derisa zgjat e drejta prindërore;</p> <p>1.3. ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit të tij si dhe të organit të kujdestarisë, gjatë kohës së kujdestarisë dhe derisa të mos paraqiten llogaritë;</p> <p>1.4. ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë, derisa ekziston ajo bashkëjetesë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 364 Kërkesat e personave të caktuar</p> <p>1.Parashkrimi nuk rrjedh:</p> <p>1.1. gjatë kohës së mobilizimit në rastin e</p>	<p>third person liable for the origin of the insurance case shall begin to run when the insured person's claim against such person begins to run, and shall end after the same time.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 3</u> <u>SUSPENSION OF STATUTE-BARRING</u></p> <p style="text-align: center;">Article 363 Claims between specific persons</p> <p>1. The statute-barring period shall not run:</p> <p>1.1. between spouses;</p> <p>1.2. between parents and children, as long as the parental right lasts;</p> <p>1.3. between a ward and the guardian thereof or between a ward and the care authority, as long as the guardianship lasts and as long as bills are not issued;</p> <p>1.4. between persons cohabiting in an extra-marital union.</p> <p style="text-align: center;">Article 364 Claims by specific persons</p> <p>1. The statute-barring period shall not run:</p> <p>1.1. during mobilization, immediate risk</p>	<p>odgovornom za nastupanje osiguranog slučaja počinje teći kad i zastarevanje potraživanja osiguranika prema tom licu i navršava se u istom roku.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 3</u> <u>STAJANJE ZASTAREVANJA</u></p> <p style="text-align: center;">Član 363 Potraživanja između određenih lica</p> <p>1.Zastarevanje ne teče:</p> <p>1.1. između bračnih drugova;</p> <p>1.2. između roditelja i dece dok traje roditeljsko pravo;</p> <p>1.3. između štićenika i njegovog staraoca, kao i organa starateljstva, za vreme trajanja starateljstva i dok ne budu položeni računi;</p> <p>1.4. između dva lica koja žive u bračnoj (va nbračnoj) zajednici, dok ta zajednica postoji.</p> <p style="text-align: center;">Član 364 Potraživanja određenih lica</p> <p>1.Zastarevanje ne teče:</p> <p>1.1. za vreme mobilizacije, u slučaju</p>
---	--	---



<p>rezikut të drejtpërdrejt të luftës ose gjatë luftës lidhur me kërkesat e personave në detyrë ushtarake;</p> <p>1.2. në pikëpamje të kërkesave që kanë personat e punësuar në ekonomi të huaj shtëpiake ndaj punëdhënësve ose anëtarëve të familjes së tij që bashkëjetojnë me te, derisa zgjat ajo marrëdhënie.</p> <p style="text-align: center;">Neni 365 Pengesat e papërballueshme</p> <p>Parashkrimi nuk rrjedh për gjithë kohën për të cilën kreditori nuk ka pasur mundësi që për shkak të pengesave të papërballueshme të kërkojë përmes gjykatës përmbushjen e detyrimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 366 Ndikimi i shkaqeve të ndaljes në rrjedhën e parashkrimit</p> <p>1. Në qoftë se parashkrimi nuk ka mundur të fillojë të rrjedhë për arsye të ndonjë shkakut ligjor, ai fillon të rrjedhë posa ai shkak të ketë pushuar së ekzistuari.</p> <p>2. Në qoftë se parashkrimi ka filluar të rrjedhë përpara se të ketë ndodhur shkakut i cili e ka ndaluar rrjedhën e tij të mëtejshëm, ai vazhdon të rrjedhë kur të</p>	<p>of war, a state of emergency, or a state of war, and for claims by persons on military service</p> <p>1.2. for claims held by persons employed in the household of another against the employer or the family members thereof as long as such employment lasts</p> <p style="text-align: center;">Article 365 Insurmountable obstacles</p> <p>The statute-barring period shall not run while for reason of insurmountable obstacles the creditor is unable to demand the performance of the obligation through the court.</p> <p style="text-align: center;">Article 366 Influence of grounds for suspension on statute-barring period</p> <p>1. If a statute-barring period cannot run because of any lawful grounds, it shall begin to run when such grounds cease.</p> <p>2. If the statute-barring period began to run before the grounds for which it was suspended arose, it shall resume when such grounds cease; the time that passed</p>	<p>neposredne ratne opasnosti ili rata u pogledu potraživanja lica na vojnoj dužnosti;</p> <p>1.2. u pogledu potraživanja koja imaju lica zaposlena u tuđem domaćinstvu prema poslodavcu ili članovima njegove porodice koji zajedno sa njima žive, sve dok taj radni odnos traje.</p> <p style="text-align: center;">Član 365 Nesavladive prepreke</p> <p>Zastarevanje ne teče za sve vreme za koje poveriocu nije bilo moguće zbog nesavladivih prepreka da sudskim putem zahteva ispunjenje obaveze.</p> <p style="text-align: center;">Član 366 Uticao uzroka zastoja zastarevanja</p> <p>1. Ako zastarevanje nije moglo početi da teče zbog nekog zakonskog uzroka, ono počinje teći kad taj uzrok prestane postojati.</p> <p>2. Ako je zastarevanje počelo teći pre nego što je nastao uzrok koji je zaustavio njegov dalji tok, ono nastavlja da teče kad taj uzrok prestane postojati, a vreme koje</p>
---	--	---



<p>pushojë së ekzistuari ai shkak, ndërsa koha që ka kaluar para ndaljes llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 367 Kërkesat ndaj personave të paaftë për të vepruar dhe kërkesat e tyre</p> <p>1. Parashkrimi rrjedh edhe ndaj të miturit dhe personit tjetër të paaftë për të vepruar, pavarësisht nëse kanë ose jo përfaqësuesin ligjor të tyre.</p> <p>2. Megjithatë, parashkrimi i kërkesës së të miturit i cili nuk ka përfaqësues, dhe i personit tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të fillojë të rrjedhë derisa të mos kenë kaluar dy vjet nga data kur janë bërë plotësisht të aftë për të vepruar ose kur iu është caktuar përfaqësuesi.</p> <p>3. Në qoftë se për parashkrimin e një kërkesë është caktuar një kohë më e shkurtër se dy vjet, ndërsa kreditori është i mitur dhe nuk ka përfaqësues ose ndonjë person tjetër i paaftë për të vepruar pa përfaqësues, parashkrimi i asaj kërkesë fillon të rrjedhë kur kreditori është bërë i aftë për të vepruar ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi.</p>	<p>before the suspension shall be counted towards the period stipulated by the statute of limitations.</p> <p style="text-align: center;">Article 367 Claims by persons with incapacity to contract</p> <p>1. The statute-barring period shall run against minors and other persons with incapacity to contract, irrespective of whether they have a lawful representative.</p> <p>2. However the statute-barring of a claim by a minor without a representative or by any other person with incapacity to contract without a representative may not occur until two years have passed since such person gained full capacity to contract or obtained a representative.</p> <p>3. If a period of less than two years is stipulated for the statute-barring of any claim and the creditor is a minor without a representative or any other person with incapacity to contract without a representative the statute-barring period for the claim shall begin to run when the creditor gains capacity to contract or obtains a representative.</p>	<p>je isteklo pre zaustavljanja računa se u zakonom određeni rok za zastarelost.</p> <p style="text-align: center;">Član 367 Potraživanja prema poslovno nesposobnim licima i njihova potraživanja</p> <p>1. Zastarevanje teče i prema maloletniku i drugom poslovno nesposobnom licu, bez obzira na to da li imaju zakonskog zastupnika ili ne.</p> <p>2. Ipak, zastarelost potraživanja maloletnika koji nema zastupnika i drugog poslovno nesposobnog lica bez zastupnika, ne može nastupiti dok ne protekne dve godine od kad su postala potpuno poslovno sposobna, ili od kad su dobila zastupnika.</p> <p>3. Ako je za zastarelost nekog potraživanja određeno vreme kraće od dve godine, a poverilac je maloletnik koji nema zastupnika ili neko drugo poslovno nesposobno lice bez zastupnika, zastarevanje tog potraživanja počinje teći od kad je poverilac postao poslovno sposoban, ili od kad je dobio zastupnika.</p>
--	---	---



<u>NËNKREU 4</u> <u>NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT</u>	<u>SUBCHAPTER 4</u> <u>DISCONTINUANCE OF STATUTE-</u> <u>BARRING</u>	<u>PODGLAVLJE 4</u> <u>PREKID ZASTAREVANJA</u>
<p style="text-align: center;">Neni 368 Pranimi i borxhit</p> <p>1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.</p> <p>2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 368 Acknowledgement of debt</p> <p>1. Statute-barring shall discontinue when the debtor acknowledges the debt.</p> <p>2. A debt may be acknowledged by the debtor not only through a declaration made to the creditor but also indirectly, for example by paying something into an account, by paying interest or by providing security.</p>	<p style="text-align: center;">Član 368 Priznanje duga</p> <p>1. Zastarevanje se prekida kada dužnik prizna dug.</p> <p>2. Priznanje duga može se učiniti ne samo izjavom poveriocu, nego i na posredan način, kao što su davanje otplate, plaćanje kamate, davanje obezbeđenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 369 Paraqitja e padisë</p> <p>Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 369 Filing of suit</p> <p>Statute-barring shall discontinue with the filing of a suit or any other act by the creditor against the debtor before the court or other relevant authority to determine, secure or collect a claim.</p>	<p style="text-align: center;">Član 369 Podnošenje tužbe</p> <p>Zastarevanje se prekida podnošenjem tužbe i svakom drugom poveriočevom radnjom preduzetom protiv dužnika pred sudom ili drugim nadležnim organom, u cilju utvrđivanja, obezbeđenja ili ostvarenja potraživanja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 370 Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë</p> <p>1. Ndërprerja e parashkrimit e bërë me paraqitjen e padisë ose me ndonjë veprim</p>	<p style="text-align: center;">Article 370 Withdrawn, dismissed or refused suit</p> <p>1. Statute-barring shall be deemed not to have discontinued with the filing of a suit</p>	<p style="text-align: center;">Član 370 Odustajanje, odbacivanje ili odbijanje tužbe</p> <p>1. Prekid zastarevanja izvršen podnošenjem tužbe ili bilo kojom drugom</p>



<p>tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë.</p> <p>2. Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se masa e kërkuar ose e ndërmarrur e përmbarimit apo e sigurimit është shpallur e pavlefshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 371 Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës</p> <p>1. Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të jokompetencës së gjykatës ose për ndonjë arsye tjetër i cili nuk i përket esencës së çështjes, kështuqë kreditori përsëri paraqet padi brenda afatit prej tre muajsh nga data kur vendimi mbi hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formën e prerë do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë.</p> <p>2. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjen në mbrojtje si dhe për paraqitjen e kompensimit të kërkesës në kontest si dhe</p>	<p>or any other act by the creditor against the debtor before the court or other relevant authority done with the intent of determining, securing or collecting a claim if the creditor withdraws the suit or abandons such an act.</p> <p>2. Statute-barring shall also be deemed not to have discontinued if the creditor's suit is dismissed or refused or if a measure procured or performed for execution or security is annulled.</p> <p style="text-align: center;">Article 371 Suit dismissed owing to lack of jurisdiction</p> <p>1. If a suit against the debtor is dismissed owing to the court's lack of jurisdiction or for any other grounds not affecting matters themselves and the creditor files a new suit within three months of the ruling by which the suit was dismissed becoming final, statute-barring shall be deemed to have discontinued with the first suit.</p> <p>2. The same shall apply in the case of the naming of a predecessor and the exercise of an offset of a claim in a civil suit, even</p>	<p>poveriočevom radnjom preduzetom protiv dužnika pred sudom ili drugim nadležnim organom u cilju utvrđivanja, obezbeđenja ili ostvarenja potraživanja, smatra se da nije nastupio ako poverilac odustane od tužbe ili radnje koju je preduzeo.</p> <p>2. Smatra se da nije bilo prekida ako poveriočeva tužba ili zahtev bude odbačen ili odbijen, ili ako izdejstvovana ili preduzeta mera izvršenja ili obezbeđenja bude oglašena nevažećom.</p> <p style="text-align: center;">Član 371 Odbacivanje tužbe zbog nenadležnosti</p> <p>1. Ako je tužba protiv dužnika odbačena zbog nenadležnosti suda ili kog drugog uzroka koji se ne tiče suštine stvari, pa poverilac podnese ponovo tužbu u roku od tri meseca od dana pravnosnažnosti odluke o odbacivanju tužbe, smatra se da je zastarevanje prekinuto prvom tužbom.</p> <p>2. Isto vredi i za pozivanje u zaštitu, i za isticanje kompenzacije potraživanja u sporu, kao i u slučaju kad je sud ili drugi</p>
--	--	---



<p>në rastin kur gjykata ose ndonjë organ tjetër e ka drejtuar debitorin që kërkesën e tij të deklarojë ta realizojë në procedurë civile.</p> <p style="text-align: center;">Neni 372 Thirrja e kreditorit</p> <p>Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 373 Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes</p> <p>1. Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim.</p> <p>2. Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi).</p> <p>3. Kur ndërprerja e parashkrimit ka filluar me paraqitjen e padisë ose me thirrjen në mbrojtje, ose duke paraqitur kompensimin e kërkesave në kontest, respektivisht me</p>	<p>if the court or other authority directs the creditor to exercise the creditor's registered claim in a civil procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 372 Creditor's demand</p> <p>The creditor demanding verbally or in writing that the debtor perform the obligation shall not suffice for the discontinuance of statute-barring.</p> <p style="text-align: center;">Article 373 Statute-barring period in event of discontinuance</p> <p>1. After discontinuance the statute-barring period shall begin to run anew, and the time that passed prior to the discontinuance shall not count towards the period stipulated by the statute of limitations.</p> <p>2. A statute-barring period discontinued by the debtor's acknowledgement shall begin to run a new from the acknowledgement.</p> <p>3. If the statute-barring period discontinued with the filing of a suit or any other act by the creditor against the debtor before the court or any other</p>	<p>organ uputio dužniku da svoje prijavljeno potraživanje ostvaruje u parničnom postupku.</p> <p style="text-align: center;">Član 372 Pozivanje dužnika</p> <p>Za prekid zastarevanja nije dovoljno da poverilac pozove dužnika pismeno ili usmeno da obavezu ispuni.</p> <p style="text-align: center;">Član 373 Rok zastarelosti u slučaju prekida</p> <p>1. Posle prekida zastarevanje počinje teći iznova, a vreme koje je proteklo pre prekida ne računa se u zakonom određeni rok za zastarelost.</p> <p>2. Zastarevanje prekinuto priznanjem (tvrdnjom) od strane dužnika počinje teći iznova od priznanja (tvrdnje).</p> <p>3. Kad je prekid zastarevanja nastao podnošenjem tužbe ili pozivanjem u zaštitu, ili isticanjem kompenzacije potraživanja u sporu, odnosno</p>
--	---	--



<p>paraqitjen e kërkesave në ndonjë proces tjetër, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita kur kontesti të ketë marrë fund definitivisht ose të ketë përfunduar në ndonjë mënyrë tjetër.</p> <p>4. Kur ndërprerja e parashkrimit të jetë shkaktuar me paraqitjen e kërkesës në procedurën e falimentimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita e përfundimit të asaj procedure.</p> <p>5. E njëjta gjë vlen edhe kur ndërprerja e parashkrimit të jetë shkaktuar me kërkesën e përmbarimit të dhunshëm ose të sigurimit.</p> <p>6. Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar atë kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 374 Parashkrimi në rastin e përtrirjes së detyrimit</p> <p>Në qoftë se ndërprerja ka filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, ndërsa kreditori dhe debitori janë marrë vesh që ta ndryshojnë bazën ose objektin e detyrimit, kërkesa e re parashkruhet për kohën që është caktuar për parashkrimin e saj.</p>	<p>relevant authority to determine, secure or collect a claim, by the exercise of an offset of the claim in a dispute or by the registration of the claim in any other procedure it shall begin to run anew on the day the dispute is completed or is otherwise settled.</p> <p>4. If the statute-barring period discontinued with the registration of the claim in bankruptcy proceedings it shall begin to run anew on the day such proceedings are completed.</p> <p>5. This shall also apply if the statute-barring period discontinued with a petition for compulsory execution or security.</p> <p>6. A statute-barring period that begins to run anew after discontinuance shall end when the time stipulated by the statute of limitations for the discontinued statute-barring period passes.</p> <p style="text-align: center;">Article 374 Statute-barring in event of novation</p> <p>If the statute-barring period discontinued with the debtor's acknowledgement of the debt and the creditor and debtor undertook to change the basis or the subject of the obligation the new claim shall become statute-barred after the period stipulated for the statute-barring thereof.</p>	<p>prezentacijom potraživanja u nekom drugom postupku, zastarevanje počinje teći iznova od dana kad je spor okončan ili svršen na neki drugi način.</p> <p>4. Kad je prekid zastarevanja nastao prijavom potraživanja u stečajnom postupku, zastarevanje počinje teći iznova od dana okončanja ovog postupka.</p> <p>5. Isto važi i kad je prekid zastarevanja nastao zahtevom prinudnog izvršenja ili obezbeđenja.</p> <p>6. Zastarevanje koje počinje teći iznova posle prekida, navršava se kad protekne onoliko vremena koliko je zakonom određeno za zastarevanje koje je prekinuto.</p> <p style="text-align: center;">Član 374 Zastarelost u slučaju novacije obaveze</p> <p>Ako je prekid nastao priznanjem duga od strane dužnika, a poverilac i dužnik su se sporazumeli da izmene osnov ili predmet obaveze, novo potraživanje zastareva za vreme koje je određeno za njegovu zastarelost.</p>
--	--	---



PJESA V	PART V	DEO V
LLOJET E NDRYSHME TË DETYRIMEVE	VARIOUS TYPES OF OBLIGATION	RAZNE VRSTE OBAVEZA
KREU 1 DETYRIMET MONETARE	CHAPTER 1 PECUNIARY OBLIGATIONS	GLAVA 1 NOVČANE OBAVEZE
<u>NËNKREU 1</u> <u>RREGULLAT E PËRGJITHSHME</u>	<u>SUBCHAPTER 1</u> <u>GENERAL PROVISIONS</u>	<u>PODGLAVLJE 1</u> <u>OPŠTA PRAVILA</u>
Neni 375 Parimi i nominalizmit monetar	Article 375 Principle of monetary nominalism	Član 375 Načelo monetarnog nominalizma
<p>Kur detyrimi ka si subjekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë shumën e njëjtë të të hollave, përveç nëse kreditori dhe debitori merren vesh ndryshe në pajtim me ligjin.</p>	<p>If the subject of an obligation is a sum of money, the debtor must pay the amount of currency in which the obligation is declared, unless the creditor and the debtor agree otherwise in accordance with the law.</p>	<p>Kad obaveza ima za predmet svotu novca, dužnik je dužan isplatiti isti iznos novca, izuzev kada se poverilac i dužnik drugačije u skladu sa zakonom.</p>
Neni 376 Rivlerësimi i detyrimeve monetare	Article 376 Revaluation of pecuniary obligations	Član 376 Revalorizacija novčane obaveze
<p>1. Palët kontraktuese mund të pajtohen që shumata e detyrimeve monetare të debitorit të përcaktohet në raport me ndryshimet në çmim të mallrave dhe shërbimeve të shprehura në indeksin e çmimeve të shitjeve dhe të përcaktuara nga një</p>	<p>1. The contracting parties may agree that the amount of the debtor's pecuniary obligation be stipulated in respect of changes in the price of goods and services expressed by the retail price index determined by the authorized organization</p>	<p>1. Strane se mogu dogovoriti da se iznos novčane obaveze dužnika utvrdi u odnosu na promene cena roba i usluga izraženih u prodajnom indeksu cena i definisanih od strane ovlašćene organizacije, u vezi promena u kursu razmene strane valute, ili</p>



<p>organizatë e autorizuar, në lidhje me ndryshimet në kursin valutor të huaj, ose në lidhje me ndryshimet në çmimet e tjera, përveç nëse një marrëveshje e këtillë është në kundërshtim me ligjin.</p> <p>2. Në rast se palët kontraktuese pajtohen me rivlerësimin e detyrimeve monetare, rivlerësimi bëhet për periudhën nga fillimi i detyrimit e deri në përmbushjen e detyrimit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 377 Përmbushja e parakohshme</p> <p>1. Debitori mund t'i përmbushë detyrimet në para edhe para kohe.</p> <p>2. Është nul dispozita e kontratës me të cilën debitori heq dorë nga kjo e drejtë.</p> <p>3. Në rast të përmbushjes së detyrimit në të holla para kohe, debitori ka të drejtë të zbresë kamatën nga shuma e borxhit për kohën prej datës së pagesës deri në ditën kur detyrimi të ketë arritur për pagesë, vetëm kur për këtë është i autorizuar me kontratë apo nëse kjo rrjedh nga doket.</p>	<p>(index-linking clause), in respect of fluctuation in a foreign exchange rate (foreign currency clause), or in respect of changes in other prices, unless such an agreement is in contravention of the law.</p> <p>2. If the contracting parties agree on the revaluation of pecuniary obligations the revaluation shall be performed for the period from the origin of the obligation to the performance of the obligation, unless the parties agree otherwise.</p> <p style="text-align: center;">Article 377 Early payment</p> <p>1. The debtor may perform a pecuniary obligation early.</p> <p>2. A contractual provision by which the debtor waives this right shall be null and void.</p> <p>3. A debtor that performs a pecuniary obligation early shall only have the right to deduct from the debt the interest for the period between the day of payment to the day payment falls due ifso entitled by the contract or if such is in accordance with custom.</p>	<p>u vezi sa promenama u drugim cenama, osim ako taj sporazum nije u suprotnosti sa zakonom.</p> <p>2. Ako se strane dogovore o revalorizaciji novčane obaveze, revalorizacija se vrši za period od početka obaveze do njenog ispunjenja, osim ako se strane dogovore drugačije.</p> <p style="text-align: center;">Član 377 Ispunjenje pre roka</p> <p>1. Dužnik može ispuniti novčanu obavezu i pre roka.</p> <p>2. Ništava je odredba ugovora kojom se dužnik odriče ovog prava.</p> <p>3. U slučaju ispunjenja novčane obaveze pre roka, dužnik ima pravo da od iznosa duga odbije iznos kamate za vreme od dana isplate do dospelosti obaveze, samo ako je na to ovlašćen ugovorom ili to proizlazi iz običaja.</p>
--	---	--



<u>NËNKREU 2</u> <u>KAMATA</u>	<u>SUBCHAPTER 2</u> <u>INTEREST</u>	<u>PODGLAVLJE 2</u> <u>KAMATA</u>
Neni 378 Përkufizim	Article 378 Definition	Član 378 Pojam
<p>Përveç borxhit kryesor (kryegjëja), debitori po ashtu ka për detyrim edhe kamatën, në qoftë se e njëjta është përcaktuar nga ligji ose në rast se kreditori dhe debitori ashtu kanë kontraktuar.</p>	<p>In addition to the principal the debtor shall also owe interest if so stipulated by law of if the creditor and the debtor so agree.</p>	<p>Osim glavnog duga (glavnice), dužnik isto tako ima za obavezu i kamatu, ako je ista određena zakonom ili u slučaju da je poverilac i dužnik tako ugovore.</p>
Neni 379 Ndalimi i kamatës në kamatë	Article 379 Prohibition of interest on interest	Član 379 Zabrana kamate na kamatu
<p>1. Në kamatën e kontraktuar e cila ka arritur për pagesë, por nuk është paguar nuk rrjedh kamatëvonesa, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.</p> <p>2. Është nule dispozita e kontratës me të cilën parashikohet kamatë në kamatën e cila ka arritur për pagesë por nuk është paguar.</p> <p>3. Megjithatë, palët mund të pajtohen që më parë në kontratë se shkalla e kamatës do të jetë më e lartë në rast se debitori nuk i paguan kamatat e rrjedha për pagesë në kohën e duhur.</p> <p>4. Në shumën e papaguar të kamatës mund të kërkohet kamatëvonesa vetëm</p>	<p>1. No penalty interest shall run on interest that has fallen due for payment but has not been paid, unless stipulated otherwise by law.</p> <p>2. A contractual provision that interest shall run on interest that has fallen due for payment but has not been paid shall be null and void.</p> <p>3. However it may be agreed in advance in a contract that the interest rate will be higher if the debtor fails to pay the interest that has fallen due on time.</p> <p>4. Penalty interest may be requested on the unpaid amount of interest only from</p>	<p>1. Na ugovorenu kamatu koja je dospela za isplatu, ali nije isplaćena, ne teče zatezna kamata, izuzev kad je to zakonom određeno.</p> <p>2. Ništava je odredba ugovora kojom se predviđa kamata na kamatu koja je dospela za isplatu, ali nije isplaćena.</p> <p>3. Ipak, strane mogu unapred ugovoriti da će se stopa kamate biće veća ako dužnik ne isplati dospele kamate na vreme.</p> <p>4. Na iznos neisplaćene kamate može se zahtevati zatezna kamata samo od dana</p>



<p>nga dita kur gjykatës i është paraqitur kërkesa për pagimin e saj.</p> <p>Neni 380 Kur kamata pushon të rrjedhë</p> <p>Kamata pushon të rrjedhë kur shuma e kamatave të arritura për pagesë, arrin lartësinë e borxhit kryesor.</p> <p>Neni 381 Supozimi i kontratës me fajde</p> <p>1. Në rast se niveli i kamatës për të cilin janë pajtuar palët është për 50 për qind (%) më i lartë sesa niveli i kamatëvonesës, i përlllogaritur sipas nenit në vijim, një marrëveshje e tillë konsiderohet kontratë me fajde, përveç nëse kreditori provon se nuk ka shfrytëzuar gjendjen e pavolitshme të debitorit, vështirësinë e situatës së tij financiare, pamaturinë ose varësinë e krijuar prej saj, ose që përfitimet e rezervuara për kreditorin ose personin e tretë nuk janë në shpërpjesëtim me atë që kreditori ka ofruar ose ka ndërmarrë të ofrojë ose të bëjë.</p> <p>2. Supozimi i saktësuar në paragrafin paraparak nuk zbatohet në kontratat komerciale.</p>	<p>the date when the request for its payment has been submitted to court.</p> <p>Article 380 When interest ceases to run</p> <p>Interest shall cease to run when the amount of interest that has fallen due for payment but has not been paid reaches the principal.</p> <p>Article 381 Presumption of usurious interest</p> <p>1. If the agreed interest rate for penalty or contractual interest is more than 50% higher than the prescribed penalty interest rate, calculated as per the following Article, such an agreement shall be deemed a usurious contract, unless the creditor shows that the creditor has not exploited the debtor's distress, the severity of the pecuniary situation thereof, or the inexperience, recklessness or dependence thereof, or that the benefits reserved for the former or for a third person are not in clear disproportion to that which the former provided or did or undertook to provide or do.</p> <p>2. The presumption specified in the previous paragraph shall not apply to a commercial contract.</p>	<p>kad je sudu podnesen zahtev za njenu isplatu.</p> <p>Član 380 Kada kamata prestaje da teče</p> <p>Kamata prestaje da teče kada iznos dospelih kamata dostigne visinu glavnog duga.</p> <p>Član 381 Pretpostavka zelenaškog ugovora</p> <p>1. Ako je nivo kamate za koju su se strane dogovorile za 50 procenata (%) veći od nivoa zatezne kamate, izračunate na osnovu člana ispod, takav ugovor se smatra zelenaškim ugovorom, osim ukoliko poverilac dokaže da nije koristio nepovoljnu situaciju dužnika, njegovu tešku finansijsku situaciju, ili indiskreciju ili zavisnost stvorenu od nje, ili da pogodnosti rezervisane za poverioca ili treće lice nisu u nesrazmeri sa onim što poverilac dao ili je preduzeo da se obezbedi ili da.</p> <p>2. Pretpostavka iz prethodnog stava ne sprovođi se na komercijalne ugovore.</p>
--	--	--



<u>NËNKREU 3</u>	<u>SUBCHAPTER 3</u>	<u>PODGLAVLJE 3</u>
<u>VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA</u>	<u>DELAY IN PERFORMANCE OF PECUNIARY OBLIGATIONS</u> <u>PENALTY INTEREST</u>	<u>DOCNJA U ISPUNJENJU NOVČANIH OBAVEZA</u>
Neni 382 Kamatëvonesa	Article 382 penalty interest	Član 382 Zatezna kamata
1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë (8) për qind (%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.	1. A debtor that is in delay in performing a pecuniary obligation shall owe penalty interest in addition to the principal. 2. The interest rate for penalty interest shall amount to 8% per annum, unless stipulated otherwise by a separate act of law.	1. Dužnik koji zadocni u ispunjavanju novčanih obaveza duuguje, osim glavnice, i zateznu kamatu. 2. Iznos zatezne kamate je osam (8) procenta (%) godišnje, osim ako nije drugačije određeno posebnim zakonom.
Neni 383 Kamatëvonesa e kontraktuar	Article 383 Contractually agreed penalty interest rate	Član 383 Ugovorena zatezna kamata
Kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët ose më e lartë sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me Ligj.	The creditor and the debtor may agree that the penalty interest rate be lower or higher than the penalty interest rate prescribed by law.	Poverilac i dužnik mogu ugovorom saglasiti da iznos zatezne kamate bude niži ili viši nego nivo zatezne kamata utvrđene zakonom.
Neni 384 E drejta e shpërblimit të plotë	Article 384 Right to full compensation	Član 384 Pravo na punu naknadu
1. Kreditori ka të drejtë në kamatëvonesën pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonesës së debitorit.	1. The creditor shall have the right to penalty interest irrespective of any damage incurred thereby owing to the	1. Poverilac ima pravo na zateznu kamatu bez obzira da li je pretrepo bilo kakvu štetu zbog docnje dužnika.



<p>2. Në qoftë se dëmi të cilin e ka pësuar kreditori për shkak të vonesës së debitorit, është më i madh nga shuma të cilën do ta merrte në emër të kamatëvonësës, ai ka të drejtë të kërkojë diferencën deri në shpërblimin e plotë të dëmit.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 4</u> <u>KAMATA KONTRAKTORE</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 385 Kamata kontraktore</p> <p>1. Palët kontraktuese mund të pajtohen që, përveç shumës kryesore (kryegjësë), debitori duhet të paguajë kamatën kontraktore nga periudha e lindjes së detyrimit në të holla deri në kohën e arritjes për pagesë të detyrimit.</p> <p>2. Në rast se palët janë pajtuar për kontratën kamatore (me interes) por niveli i kamatës dhe koha e arritjes për pagesë së interesit nuk është përcaktuar, niveli i kamatës është gjashtë për qind (6 %) në vit dhe kamata rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të kryegjësë (shumës kryesore).</p>	<p>debtor's delay.</p> <p>2. However if the creditor has incurred damage owing to the debtor's delay that is greater than the sum that would be obtained at the account of penalty interest the creditor shall have the right to demand the difference up to full compensation.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 4</u> <u>CONTRACTUAL INTEREST</u></p> <p style="text-align: center;">Article 385 Contractual interest</p> <p>1. The contracting parties may agree that in addition to the principal the debtor must pay contractual interest for the period from the origin of the pecuniary obligation to the time it falls due.</p> <p>2. If contractual interest is agreed but the interest rate and the time it falls due are not stipulated the interest rate shall be 6% per annum and the interest shall fall due at the same time the principal falls due.</p>	<p>2. Ako je šteta koju je poverilac pretrpeo zbog docnje dužnika veća od iznosa koji bi dobio na ime zatezne kamate, on ima pravo da zatraži razliku do pune naknade oštećenja.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 4</u> <u>UGOVORNA KAMATA</u></p> <p style="text-align: center;">Član 385 Ugovorna kamata</p> <p>1. Strane se mogu dogovoriti da pored glavnog duga (glavnice), dužnik mora da plati ugovornu kamatu od perioda nastanka novčanih obaveza u gotovini do vremena kada obaveza dospe na plaćanje.</p> <p>2. U slučaju da se strane složile za ugovor sa kamatom (sa interesom), ali nivo interesa i vreme dospevanja za plaćanje interesa nisu definisani, nivo kamate je šest odsto (6%) godišnje i kamata teče za plaćanje istovremeno sa dospevanjem sa plaćanjem glavnog duga (glavnice).</p>
---	---	--



Neni 386 Kamata në detyrimet jomonetare	Article 386 Interest for non-pecuniary obligations	Član 386 Kamata u nenovčanim obavezama
<p>Dispozitat e këtij Ligji për kamatën kontraktuese zbatohen përshtatshëmrisht edhe për marrëdhëniet e tjera të detyrimeve të shquara sipas llojit, gjegjësisht detyrimet të cilat kanë për lëndë sendet e zëvendësueshme dhe të shquara sipas llojit.</p>	<p>The sense of the provisions of the present Law on contractual interest shall apply to other obligations of which the subject is things of fungible nature.</p>	<p>Odredbe ovog zakona o ugovornoj kamati shodno se primenjuju i za ostale obaveze koje imaju za predmet stvari određene po rodu, odnosno obaveze koje za predmet imaju zamenjive i stvari određene po rodu.</p>
KREU 5 DETYRIMET ME DISA OBJEKTE	CHAPTER 2 OBLIGATIONS WITH MULTIPLE SUBJECTS	GLAVA 5 OBAVEZE SA VIŠE PREDMETA
<u>NĒNKREU 1</u> <u>DETYRIMET ALTERNATIVE</u>	<u>SUBCHAPTER 1</u> <u>ALTERNATIVE OBLIGATIONS</u>	<u>PODGLAVLJE 1</u> <u>ALTERNATIVNE ODREDBE</u>
Neni 387 E drejta e zgjedhjes	Article 387 Right to choose	Član 387 Pravo izbora
<p>Në qoftë se ndonjë detyrim ka dy ose më tepër objekte, por debitori ka për detyrë të jep vetëm një për t'u liruar nga detyrimi, atëherë, po qe se nuk është kontraktuar ndryshe, e drejta e zgjedhjes i takon debitorit dhe detyrimi shuhet kur ky ta ketë dorëzuar objektin të cilin e ka zgjedhur vet.</p>	<p>If an obligation has two or more subjects of which the debtor must provide only one to be released from the obligation, unless agreed otherwise the debtor shall have the right to choose and the obligation shall terminate when the debtor delivers the chosen subject.</p>	<p>Ako neka obaveza ima dva ili više predmeta, ali je dužnik dužan dati samo jedan da bi se oslobodio obaveze, onda, ako nije što drugo ugovoreno, pravo izbora pripada dužniku i obaveza prestaje kad on bude predao predmet koji je izabrao.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 388 Parevokueshmëria dhe efekti i zgjedhjes së bërë</p> <p>1. Zgjedhja quhet e bërë kur pala të cilës i takon e drejta e zgjedhjes e njofton palën tjetër për atë që e ka zgjedhur dhe nga ky moment zgjedhja nuk mund të ndryshohet.</p> <p>2. Me zgjedhjen e bërë konsiderohet se detyrimi ka qenë që në fillim i thjesht dhe se që në fillim ka pasur si objekt sendin e zgjedhur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 388 Irrevocability and effect of choice</p> <p>1. The choice is made and may no longer be altered when the party that has such right notifies the other party regarding the choice made.</p> <p>2. Once the choice is made the obligation shall be deemed to have been simple from the beginning and the subject thereof shall be deemed to have been the chosen thing from the beginning.</p>	<p style="text-align: center;">Član 388 Neopozivost i dejstvo izvršenog izbora</p> <p>1. Izbor je izvršen kad strana kojoj pripada pravo izbora obavesti drugu stranu o tome šta je izabrala, i od tog časa izbor se više ne može menjati.</p> <p>2. Izvršenjem izbora smatra se da je obaveza od početka bila jednostavna i da je njen predmet od početka bila izabrana stvar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 389 Kohëzgjatja e të drejtës së zgjedhjes</p> <p>1. Debitori ka të drejtë të zgjedhë gjithnjë derisa në procedurën e përmbarimit të dhunshëm një prej sendeve që është borxh të mos i dorëzohet plotësisht ose pjesërisht kreditorit sipas zgjedhjes së tij.</p> <p>2. Në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit dhe ky nuk deklarohet rreth zgjedhjes brenda afatit të caktuar për përbushje, debitori mund ta ftojë që të bëjë zgjedhjen dhe për këtë t'i caktojë një afat të ri, pas skadimit të të cilit e drejta e zgjedhjes kalon në debitorin.</p>	<p style="text-align: center;">Article 389 Duration of right</p> <p>1. The debtor shall have the right to choose at any time until one of the owed things is fully or partly delivered to the creditor in compulsory execution at the latter's choice.</p> <p>2. If the creditor has the right to choose but fails to pronounce thereon by the deadline stipulated for performance the debtor may demand that the creditor choose, stipulating an appropriate deadline for such; after such deadline passes the right to choose shall pass to the debtor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 389 Trajanje prava izbora</p> <p>1. Dužnik ima pravo izbora sve dok u postupku prinudnog izvršenja jedna od dugovanih stvari ne bude potpuno ili delimično predata poveriocu po njegovom izboru.</p> <p>2. Ako pravo izbora pripada poveriocu, a on se ne izjasni o izboru u roku određenom za ispunjenje, dužnik ga može pozvati da izvrši izbor i za to mu odrediti primeren rok, posle čijeg isteka pravo izbora prelazi na dužnika.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 390 Zgjedhja që i besohet personit të tretë</p> <p>Në qoftë se zgjedhjen duhet ta bëjë ndonjë person i tretë dhe këtë gjë ai nuk e bën, secila palë mund të kërkojë që zgjedhjen ta bëjë gjykata.</p>	<p style="text-align: center;">Article 390 Choice entrusted to third person</p> <p>If the choice should be made by a third person but the third person fails to do so either party may request that the court do so.</p>	<p style="text-align: center;">Član 390 Izbor poveren trećem licu</p> <p>Ako izbor treba da izvrši neko treće lice, a ono to ne učini, svaka strana može zahtevati da izbor izvrši sud.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 391 Kufizimi në objektin e mbetur</p> <p>Në qoftë se një objekt i detyrimit është bërë i pamundshëm për shkak të ndonjë ngjarje për të cilën nuk mbajnë përgjegjësi asnjëra palë, detyrimi kufizohet në objektin e mbetur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 391 Limitation to remaining subject</p> <p>If any subject of an obligation becomes impossible because of a development for which neither party is responsible the obligation shall be limited to the remaining subject.</p>	<p style="text-align: center;">Član 391 Ograničenje na preostali predmet</p> <p>Ako je jedan predmet obaveze postao nemoguć usled nekog događaja za koji ne odgovara ni jedna strana, obaveza se ograničava na preostali predmet.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 392 Kufizimi në rast të përgjegjesisë së njëjës palë</p> <p>1. Kur një objekt i detyrimit është i pamundur për shkak të ngjarjes për të cilën përgjegjësia e mban debitori, detyrimi kufizohet në objektin e mbetur në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon këtij, e nëse e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit, ky mundet pas zgjedhjes së vet të kërkojë objektin e mbetur ose shpërblimin e dëmit.</p> <p>2. Kur një objekt i detyrimit është bërë i pamundur për shkak të ngjarjeve për të cilat është përgjegjës kreditori, detyrimi i</p>	<p style="text-align: center;">Article 392 Limitation in event of one party's responsibility</p> <p>1. If any subject of an obligation becomes impossible because of a development for which the debtor is responsible and the debtor has the right to choose the obligation shall be limited to the remaining subject; if the creditor has the right to choose the creditor may choose to demand the remaining subject or compensation.</p> <p>2. If any subject of an obligation becomes impossible because of a development for which the creditor is responsible the</p>	<p style="text-align: center;">Član 392 Ograničenje u slučaju odgovornosti jedne strane</p> <p>1. Kad je jedan predmet obaveze postao nemoguć usled događaja za koji je odgovoran dužnik, obaveza se ograničava na preostali predmet u slučaju da pravo izbora pripada njemu, a ako pravo izbora pripada poveriocu, on može po svom izboru tražiti preostali predmet ili naknadu štete.</p> <p>2. Kad je jedan predmet obaveze postao nemoguć usled događaja za koji je odgovoran poverilac, dužnikova obaveza</p>



<p>debitorit shuhet, por në qoftë se këtij i takon e drejta e zgjedhjes ky mund të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe ta kryejë detyrimin e vet nga objekti i mbetur, e në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit – ky mund të japë shpërblimin e dëmit dhe të kërkojë objektin e mbetur.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 2</u> <u>DETYRIMET FAKULTATIVE DHE</u> <u>KËRKESAT FAKULTATIVE</u></p> <p>I. DETYRIMET FAKULTATIVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 393 Autorizimi i debitorit në detyrimin fakultativ</p> <p>Debitori, detyrimi i të cilit ka një objekt, por të cilit i lejohet që të lirohet nga detyrimi i vet duke dhënë ndonjë objekt tjetër të caktuar, mund ta shfrytëzojë këtë mundësi gjithnjë derisa kreditori në procedurën e përmbarimit të detyrueshëm të mos ta ketë marrë tërësisht ose pjesërisht objektin e detyrimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 394 Autorizimi i kreditorit në detyrimin fakultativ</p> <p>1. Kreditori në detyrimin fakultativ mund</p>	<p>debtor's obligation shall terminate; however if the debtor has the right to choose the debtor may demand compensation and perform the obligation with the remaining subject, and if the creditor has the right to choose the creditor may provide compensation and demand the remaining subject.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 2</u> <u>FACULTATIVE OBLIGATIONS AND</u> <u>FACULTATIVE CLAIMS</u></p> <p>I. FACULTATIVE OBLIGATIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 393 Debtor's right in facultative obligation</p> <p>A debtor whose obligation has a single subject and that is allowed to discharge the obligation by delivering any other specific subject may exploit this possibility at any time until the creditor fully or partly obtains the subject of the obligation in compulsory execution.</p> <p style="text-align: center;">Article 394 Creditor's right in facultative obligation</p> <p>1. In a facultative obligation the creditor</p>	<p>prestaje, ali u slučaju da njemu pripada pravo izbora, on može tražiti naknadu štete i izvršiti svoju obavezu preostalim predmetom, a ako pravo izbora ima poverilac - on može dati naknadu štete i tražiti preostali predmet.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 2</u> <u>FAKULTATIVNE OBAVEZE I</u> <u>FAKULTATIVNA POTRAŽIVANJA</u></p> <p>I. FAKULTATIVNE OBAVEZE</p> <p style="text-align: center;">Član 393 Ovlašćenje dužnika u fakultativnoj obavezi</p> <p>Dužnik čija obaveza ima jedan predmet, ali kome je dopušteno da se oslobodi svoje obaveze dajući neki drugi određeni predmet, može se koristiti tom mogućnošću sve dok poverilac u postupku prinudnog izvršenja ne uzme potpuno ili delimično predmet obaveze.</p> <p style="text-align: center;">Član 394 Ovlašćenja poverioca u fakultativnoj obavezi</p> <p>1. Poverilac u fakultativnoj obavezi može</p>
---	--	---



<p>të kërkojë nga debitori vetëm objektin e detyrimit, por jo edhe objektin tjetër me të cilin debitori, në qoftë se dëshiron mundet gjithashtu ta përmbushë detyrimin e vet.</p> <p>2. Kur objekti i detyrimit bëhet i pamundur për shkak të ngjarjeve për të cilat debitori nuk përgjigjet, kreditori mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit, por debitori mund të lirohet nga detyrimi duke dhënë objektin të cilin është i autorizuar ta japë në vend të objektit që është borxh.</p> <p>II. KËRKESAT FAKULTATIVE</p> <p>Neni 395 Rregulla e përgjithshme</p> <p>1. Kur me kontratë ose ligj është parashikuar që kreditori mundet në vend të objektit që është borxh të kërkojë nga debitori ndonjë objekt tjetër të caktuar, debitori ka për detyrë t'ia dorëzojë atë objekt, po që se atë e kërkon kreditori.</p> <p>2. Përndryshe, për kërkesa të këtilla fakultative vlejné sipas qëllimit të kontraktuesve dhe sipas rrethanave të punës, rregullat përkatëse mbi detyrimet fakultative dhe ato alternative.</p>	<p>may only demand the subject of the obligation from the debtor, not any other subject by which the debtor could perform the obligation should the latter so desire.</p> <p>2. If the subject of the obligation becomes impossible because of a development for which the debtor is responsible the creditor may only demand compensation; however the debtor may discharge the obligation by delivering a subject that the debtor was entitled to deliver instead of the owed subject.</p> <p>II. FACULTATIVE CLAIMS</p> <p>Article 395 General rule</p> <p>1. If the contract or the law stipulates that the creditor may instead of the owed subject demand any other specific subject from the debtor, the debtor shall obliged to deliver such subject to the creditor if demanded thereby.</p> <p>2. The appropriate rules on facultative and alternative obligations shall otherwise apply to such facultative claims with regard to the contracting parties' intent and the circumstances of the transaction.</p>	<p>zahtevati od dužnika samo predmet obaveze, ali ne i drugi predmet, kojim dužnik, ako hoće, može takođe ispuniti svoju obavezu.</p> <p>2. Kad predmet obaveze postane nemoguć usled događaja za koji dužnik ne odgovara, poverilac može tražiti samo naknadu štete, ali se dužnik može osloboditi obaveze dajući predmet koji je ovlašćen dati umesto dugovanog predmeta.</p> <p>II. FAKULTATIVNA POTRAŽIVANJA</p> <p>Član 395 Opšte pravilo</p> <p>1. Kad je ugovorom ili zakonom predviđeno da poverilac može umesto dugovanog predmeta zahtevati od dužnika neki drugi određeni predmet, dužnik je dužan predati mu taj predmet ako poverilac to zahteva.</p> <p>2. U suprotnosti, za ovakva fakultativna potraživanja važe prema nameri ugovarača i prema prilikama posla odgovarajuća pravila o fakultativnim i o alternativnim obavezama.</p>
--	---	--



<p>KREU 6 DETYRIMET ME DISA DEBITORË OSE KREDITORË</p> <p><u>NËNKREU 1</u> <u>DETYRIMET E PJSËTUESHME</u></p> <p>Neni 396 Pjesëtimi i detyrimeve dhe i kërkesave</p> <p>1. Detyrimi është i pjesëtueshëm në qoftë se ajo që debitohet mund të pjesëtohet dhe të përmbushet në pjesët që kanë cilësi të njëjta siç ka i tërë objekti dhe në qoftë se me këtë pjesëtim nuk humbë asgjë nga vlera e vet, ndërsa në të kundërtën detyrimi është i papjesëtueshëm.</p> <p>2. Kur në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm ka disa kreditorë, detyrimi pjesëtohet midis tyre në pjesë të barabarta, në qoftë se nuk është caktuar pjesëtimi tjetër dhe secili prej tyre përgjigjet për pjesën e vet të detyrimit.</p> <p>3. Kur në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm ka disa kreditorë, kërkesa pjesëtohet midis tyre në pjesë të barabarta, në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër dhe secili kreditor mund të kërkojë vetëm pjesën e vet të kërkesës.</p>	<p>CHAPTER 6 OBLIGATIONS WITH MULTIPLE DEBTORS OR MULTIPLE CREDITORS</p> <p><u>SUBCHAPTER 1</u> <u>DIVISIBLE OBLIGATIONS</u></p> <p>Article 396 Division of obligations and claims</p> <p>1. An obligation shall be deemed divisible if that which is owed can be divided into and performed in parts that have the same attributes as the entire subject, and if none of its value is lost through such a division; otherwise it shall be deemed indivisible.</p> <p>2. If there are several debtors for a divisible obligation and division is not otherwise stipulated the obligation shall be divided among them into equal parts, and they shall each be responsible for their own part of the obligation.</p> <p>3. If there are several creditors for a divisible obligation, unless stipulated otherwise, the claim shall be divided among them into equal parts, and each creditor may only demand such creditor's own part of the claim.</p>	<p>GLAVA 6 OBAVEZE SA VIŠE DUŽNIKA ILI POVERILACA</p> <p><u>PODGLAVLJE 1</u> <u>DELJIVE OBAVEZE</u></p> <p>Član 396 Deljenje obaveze i potraživanja</p> <p>1. Obaveza je deljiva ako se ono što se duguje može podeliti i ispuniti u delovima koji imaju ista svojstva kao i ceo predmet, i ako ono tom podelom ne gubi ništa od svoje vrednosti, inače obaveza je nedeljiva.</p> <p>2. Kad u nekoj deljivoj obavezi ima više dužnika, obaveza se deli među njima na jednake delove, ako nije određena drukčija podela, i svaki od njih odgovara za svoj deo obaveze.</p> <p>3. Kad u nekoj deljivoj obavezi ima više poverilaca, potraživanje se deli među njima na jednake delove, ako nije što drugo određeno, i svaki poverilac može zahtevati samo svoj deo potraživanja.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 397 Prezumimi i solidaritetit</p> <p>Kur ka disa debitorë në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm të krijuar me kontratë, në ekonomi ata i përgjigjen kreditorit solidarisht, përveç në qoftë se kontraktuesit e kanë eliminuar shprehimisht përgjegjësinë solide.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 2</u> <u>DETYRIMET SOLIDARE</u></p> <p>I. SOLIDARITETI I DEBITORËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 398 Përmbajtja e solidaritetit të debitorëve</p> <p>1. Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigjet kreditorit për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido që dëshiron, gjithnjë derisa të mos përmbushet krejtësisht, por kur një debitor ta ketë përmbushur detyrimin ai shuhet dhe të gjithë debitorët lirohen.</p>	<p style="text-align: center;">Article 397 Presumption of joint and several liability</p> <p>If there are several debtors for a divisible obligation originating through a commercial contract they shall be jointly and severally liable to the creditor, unless the contracting parties expressly reject joint and several liability.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 2</u> <u>JOINT AND SEVERAL OBLIGATIONS</u></p> <p>I. DEBTORS' JOINT AND SEVERAL LIABILITY</p> <p style="text-align: center;">Article 398 Content of debtors' joint and several liability</p> <p>1. Each debtor in a joint and several obligations shall be liable to the creditor for the entire obligation and the creditor may demand the performance thereof from any of them as desired at any time until it is fully performed; however the obligation shall terminate when one debtor performs it, and all the debtors shall be released from the obligation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 397 Pretpostavka solidarnosti</p> <p>Kad ima više dužnika u nekoj deljivoj obavezi nastaloj ugovorom u privredi, oni odgovaraju poveriocu solidarno, osim ako su ugovarači izrično otklonili solidarnu odgovornost.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 2</u> <u>SOLIDARNE OBAVEZE</u></p> <p>I. SOLIDARNOST DUŽNIKA</p> <p style="text-align: center;">Član 398 Sadržina solidarnosti dužnika</p> <p>1. Svaki dužnik solidarne obaveze odgovara poveriocu za celu obavezu i poverilac može zahtevati njeno ispunjenje od koga hoće sve dok ne bude potpuno ispunjena, ali kad jedan dužnik ispuni obavezu, ona prestaje i svi se dužnici oslobađaju.</p>
--	---	---



<p>2. Nga disa debitorë solidarë secili mund të ketë borxh me afat tjetër të përmbushjes, në kushte të tjera dhe në përgjithësi me alternativa të ndryshme.</p>	<p>2. Among several joint and several debtors each may owe with a different deadline for performance, under different conditions and with various deviations in general.</p>	<p>2. Od više solidarnih dužnika, svaki može dugovati sa drugim rokom ispunjenja, pod drugim uslovima i uopšte sa različitim odstupanjima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 399 Kompensimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 399 Offset</p>	<p style="text-align: center;">Član 399 Kompenzacija</p>
<p>1. Secili debitor solidar mund t’i referohet kompensimit që e ka bërë bashkëdebitori i tij.</p> <p>2. Debitori solidar mund të bëjë kompensimin e kërkesës së bashkëdebitorit të vet ndaj kreditorit me atë, që kreditori i detyrohet por vetëm për atë pjesë e borxhit të këtij bashkëdebitori në detyrimin solidar.</p>	<p>1. Each joint and several debtor may make reference to an offset of a fellow debtor.</p> <p>2. Each joint and several debtor may offset a fellow debtor’s claim on the creditor against a claim by the creditor, but only in the amount of that part of the fellow debtor’s debt in the joint and several obligation.</p>	<p>1. Svaki solidarni dužnik može se pozvati na kompenzaciju koju je izvršio njegov sadužnik.</p> <p>2. Solidarni dužnik može potraživanje svog sadužnika prema poveriocu kompenzirati sa poveriočevim potraživanjem, ali samo za onoliko koliko iznosi deo duga tog sadužnika u solidarnoj obavezi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 400 Falja e borxhit</p>	<p style="text-align: center;">Article 400 Release from debt</p>	<p style="text-align: center;">Član 400 Oprost duga</p>
<p>1. Falja e borxhit që bëhet në marrëveshje me një debitor solidar i liron nga detyrimi edhe debitorët e tjerë.</p> <p>2. Megjithatë, në qoftë se falja ka pasur për qëllim ta lirojë nga detyrimi vetëm debitorin ndaj të cilit është falë borxhi, detyrimi solidar zvogëlohet për pjesën e cila sipas marrëdhënieve reciproke të</p>	<p>1. Upon any of the joint and several debtors being released from the debt under an agreement all the other debtors shall be released from the obligation.</p> <p>2. If the purpose of the release was solely to release the debtor that was released from the debt from the obligation, the joint and several obligation shall be reduced by the part that with regard to the</p>	<p>1. Oprost duga izvršen sporazumno sa jednim solidarnim dužnikom oslobađa obaveze i ostale dužnike.</p> <p>2. Međutim, ako je oprost imao za svrhu da oslobodi obaveze samo dužnika kome je dug oprošten, solidarna obaveza smanjuje se za deo koji prema međusobnim odnosima dužnika pada na</p>



<p>debitorëve i takon atij, kurse debitorët e tjerë përgjigjen solidarisht për pjesën e mbetur të detyrimit.</p>	<p>mutual relations among the debtors fell thereto, and the other debtors shall be ointly and severally liable for the remainder of the obligation.</p>	<p>njega, a ostali dužnici odgovaraju solidarno za ostatak obaveze.</p>
<p>Neni 401 Përtrirja (Novacioni)</p>	<p>Article 401 Novation</p>	<p>Član 401 Novacija</p>
<p>1. Me përtrirjen të cilin kreditori e ka bërë me një debitor solidar, lirohen edhe debitorët e tjerë.</p> <p>2. Megjithatë, në qoftë se kreditori dhe debitori e kanë kufizuar përtrirjen vetëm në pjesën e detyrimit që i takon këtij, detyrimi i të tjerëve nuk shuhet, por vetëm zvogëlohet për atë pjesë.</p>	<p>1. Through a novation concluded by the creditor with any of the joint and several debtors the other debtors shall be released.</p> <p>2. If the creditor and the debtor restricted the novation to the part of the obligation falling to the debtor the obligation of the others shall not terminate but shall be reduced by such part.</p>	<p>1. Novacijom koju je poverilac izvršio sa jednim solidarnim dužnikom oslobađaju se i ostali dužnici.</p> <p>2. Ipak, ako su poverilac i dužnik novaciju ograničili na deo obaveze koji dolazi na tog dužnika, obaveza ostalih ne prestaje, nego se samo smanjuje za taj deo.</p>
<p>Neni 402 Ujdia</p>	<p>Article 402 Settlement</p>	<p>Član 402 Poravnanje</p>
<p>Ujdia të cilën e ka kontraktuar një nga debitorët solidarë me kreditorin, nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë, por këta kanë të drejtë ta pranojnë këtë ujdj në qoftë se ai nuk është i kufizuar vetëm në debitorin me të cilin është kontraktuar.</p>	<p>A settlement concluded by one of the joint and several debtors with the creditor shall not have any effect against the other debtors; however they shall have the right to accept it if it is not restricted to the debtor with whom it was concluded.</p>	<p>Poravnanje koje je zaključio jedan od solidarnih dužnika sa poveriocem nema dejstva prema ostalim dužnicima, ali ovi imaju pravo da prihvate to poravnanje, ako ono nije ograničeno na dužnika sa kojim je zaključeno.</p>
<p>Neni 403 Konfondimi</p>	<p>Article 403 Confusion</p>	<p>Član 403 Sjedinjenje</p>
<p>Kur në një person bashkohen cilësia e kreditorit dhe cilësia e debitorit të</p>	<p>If the attributes of creditor and debtor for the same joint and several obligations are</p>	<p>Kad se u jednom licu sjedini svojstvo poverioca i svojstvo dužnika iste solidarne</p>



<p>detyrimeve të njëjta solidarë, atëherë detyrimi i debitorëve të tjerë zvogëlohet për shumën e pjesës që i bie atij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 404 Vonesa e kreditorit</p> <p>Kur kreditori bie në vonesë ndaj një debitori solidar, atëherë ky është në vonesë edhe ndaj debitorëve të tjerë solidarë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 405 Vonesa e një debitori dhe pranimi i borxhit</p> <p>1. Vonesa e një debitori solidar nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë.</p> <p>2. E njëjta vlen edhe për pranimin e borxhit që do ta bënte një prej debitorëve solidarë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 406 Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit dhe heqja dorë nga parashkrimi</p> <p>1. Në qoftë se parashkrimi nuk rrjedh ose është ndërprerë ndaj njërit debitor, ai vazhdon të rrjedhë për debitorët e tjerë</p>	<p>combined in a single person, the obligation of the other debtors shall be reduced by the part falling to such person.</p> <p style="text-align: center;">Article 404 Creditor's delay</p> <p>A creditor that is in delay against one joint and several debtor shall be in delay against the other joint and several debtors.</p> <p style="text-align: center;">Article 405 One debtor's delay and acknowledgement of debt</p> <p>1. A delay on the part of one joint and several debtor shall have no effect against the other debtors.</p> <p>2. The same shall apply to a debt acknowledged by one of the joint and several debtors.</p> <p style="text-align: center;">Article 406 Suspension and discontinuance of statute-barring and waiver of statute-barring</p> <p>1. If the statute-barring period is not running or is discontinued against one debtor it shall continue to run for the other</p>	<p>obaveze, obaveza ostalih dužnika smanjuje se za iznos dela koji na njega pada.</p> <p style="text-align: center;">Član 404 Docnja poverioca</p> <p>Kad poverilac dođe u docnju prema jednom solidarnom dužniku, on je u docnji i prema ostalim solidarnim dužnicima.</p> <p style="text-align: center;">Član 405 Docnja jednog dužnika i priznanje duga</p> <p>1. Docnja jednog solidarnog dužnika nema dejstvo prema ostalim dužnicima.</p> <p>2. Isto važi i za priznanje duga koje bi izvršio jedan od solidarnih dužnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 406 Zastoj i prekid zastarevanja i odricanje od zastarelosti</p> <p>1. Ako zastarevanje ne teče ili je prekinuto prema jednom dužniku, ono teče za ostale solidarne dužnike i može se</p>
---	--	--



<p>solidarë dhe mund të përfundoj, por debitori ndaj të cilit detyrimi nuk është parashkruar dhe i cili është dashur ta përmbushë ka të drejtë të kërkojë nga debitorët e tjerë ndaj të cilëve detyrimi është parashkruar që t'ia shpërblejë secili pjesën e vet të detyrimit.</p> <p>2. Heqja dorë nga parashkrimi i kryer nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 407 E drejta e përmbushësit në kompensim</p> <p>1. Debitori i cili e ka përmbushur detyrimin ka të drejtë të kërkojë prej secilit bashkëdebitorë që t'i kompensojë pjesën e detyrimit që bie në të.</p> <p>2. Ndërkaq, nuk ka ndikim rrethana së kreditori e ka liruar ndonjë nga bashkëdebitorët nga borxhi ose ia ka pakësuar borxhin.</p> <p>3. Pjesa që bie në debitorin nga e cila nuk mund të merret kompensimi, pjesëtohet përpjestimisht në të gjithë debitorët.</p>	<p>joint and several debtors and may reach completion; however a debtor against whom the obligation has not become statute-barred and that must perform the obligation shall have the right to demand that the other debtors against whom the obligation has become statute-barred each reimburse their part of the obligation to such debtor.</p> <p>2. The waiver of completed statute-barring shall have no effect against the other debtors.</p> <p style="text-align: center;">Article 407 Performer's right to reimbursement</p> <p>1. The debtor that performs the obligation shall have the right to demand that each of the fellow debtors reimburse the part of the obligation falling thereto to such debtor.</p> <p>2. The circumstance whereby the creditor has released any of the fellow debtors from the debt or has reduced their debt shall have no influence on this process.</p> <p>3. The part falling to a fellow debtor from whom reimbursement cannot be obtained shall be distributed proportionately among the remaining fellow debtors.</p>	<p>završiti, ali dužnik prema kome obaveza nije zastarela i koji je morao da je ispuni ima pravo zahtevati od ostalih dužnika prema kojima je obaveza zastarela da mu naknade svaki svoj deo obaveze.</p> <p>2. Odricanje od navršene zastarelosti nema dejstva prema ostalim dužnicima.</p> <p style="text-align: center;">Član 407 Pravo ispunioaca na naknadu</p> <p>1. Dužnik koji je ispunio obavezu ima pravo zahtevati od svakog sadužnika da mu naknadi deo obaveza koji pada na njega.</p> <p>2. Pri tome nije od uticaja okolnost što je poverilac nekog od sadužnika oslobodio duga ili mu je dug smanjio.</p> <p>3. Deo koji pada na dužnika od koga ne može da se dobije naknada deli se srazmerno na sve dužnike.</p>
---	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 408 Pjesëtimi në pjesë të barabarta dhe përjashtimi</p> <p>1. Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, ose nuk rezulton nga marrëdhëniet juridike të pjesëmarrësve në punë, mbi secilin debitor bie pjesa e barabartë.</p> <p>2. Megjithatë, në qoftë se detyrimi solidar është kontraktuar në interes ekskluziv të një debitori solidar, atëherë ky ka për detyrë t'ia shpërblejë krejt shumën e detyrimit bashkëdebitorit, i cili e ka paguar kreditorin.</p>	<p style="text-align: center;">Article 408 Division into equal parts and exception</p> <p>1. Unless agreed otherwise or unless it follows otherwise from the legal relationships among the participants in a transaction, an equal part shall fall to each debtor.</p> <p>2. However if joint and several liability was concluded in the exclusive interest of a particular joint and several debtor, such debtor shall be obliged to reimburse the entire sum of the obligation to the fellow debtor that repaid the creditor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 408 Podela na jednake delove i izuzetak</p> <p>1. Ako nije što drugo ugovoreno ili inače ne proizlazi iz pravnih odnosa učesnika u poslu, na svakog dužnika dolazi jednak deo.</p> <p>2. Ipak, ako je solidarna obaveza zaključena u isključivom interesu jednog solidarnog dužnika, on je dužan naknaditi ceo iznos obaveze sadužniku koji je namirio poverioca.</p>
<p style="text-align: center;">II. SOLIDARITETI I KREDITORËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 409 Solidariteti nuk prezumohet</p> <p>Kur në anën e kreditorit ka disa persona, këta janë solidarë vetëm kur solidariteti është i kontraktuar ose i caktuar me ligj.</p>	<p style="text-align: center;">II. JOINT AND SEVERAL CREDITORS</p> <p style="text-align: center;">Article 409 Non-presumption of joint and several liability</p> <p>If there are several persons on the creditor side they shall only be jointly and severally liable if joint and several liability is agreed or stipulated by law.</p>	<p style="text-align: center;">II. SOLIDARNOST POVERILACA</p> <p style="text-align: center;">Član 409 Solidarnost se ne pretpostavlja</p> <p>Kad na poverilačkoj strani ima više lica, ona su solidarna samo kad je solidarnost ugovorena ili zakonom određena.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 410 Përmbajtja e solidaritetit</p> <p>1. Secili kreditor solidar ka të drejtë të kërkojë nga debitori përmbushjen e tërë detyrimit, por kur njëri prej tyre paguhet, detyrimi shuhet edhe ndaj kreditorëve të tjerë.</p> <p>2. Debitori mund t'ia përmbushë detyrimin kreditorit të cilin e zgjedh vet, gjithnjë derisa një kreditor të mos kërkojë përmbushjen.</p>	<p style="text-align: center;">Article 410 Content of joint and several liability</p> <p>1. Each joint and several creditor shall have the right to demand from the debtor the performance of the entire obligation; however the obligation shall also terminate against the other creditors when one of them is repaid.</p> <p>2. The debtor may perform the obligation for a creditor of the debtor's own choosing at any time until a particular creditor demands performance.</p>	<p style="text-align: center;">Član 410 Sadržina solidarnosti</p> <p>1. Svaki solidarni poverilac ima pravo zahtevati od dužnika ispunjenje cele obaveze, ali kad jedan od njih bude namiren, obaveza prestaje i prema ostalim poveriocima.</p> <p>2. Dužnik može ispuniti obavezu poveriocu koga sam izabere, sve dok neki poverilac ne zatraži ispunjenje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 411 Kompensimi</p> <p>1. Debitori mund të bëjë kompensimin e detyrimit të vet me kompensimin që ka ndaj kreditorit i cili ia kërkon përmbushjen.</p> <p>2. Kompensimi me kërkesën që ka ndaj ndonjë kreditori tjetër debitori mund ta bëjë vetëm deri në masën e pjesës së kërkesës solidare që i takon këtij kreditori.</p>	<p style="text-align: center;">Article 411 Offset</p> <p>1. The debtor may offset his obligation against a claim of the creditor that demands performance therefrom.</p> <p>2. The debtor may only offset the debtor's obligation against another creditor's claim up to the amount of that part of the joint and several claim pertaining to such creditor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 411 Kompenzacija</p> <p>1. Dužnik može izvršiti kompenzaciju svoje obaveze sa potraživanjem koje ima prema poveriocu koji mu zahteva ispunjenje.</p> <p>2. Kompenzaciju sa potraživanjem koje ima prema nekom drugom poveriocu, dužnik može izvršiti samo do visine dela solidarnog potraživanja koje pripada tom poveriocu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 412 Falja e borxhit dhe përtrirja</p> <p>Me faljen e borxhit dhe me përtrirjen</p>	<p style="text-align: center;">Article 412 Release from debt and novation</p> <p>Through a release from debt and a</p>	<p style="text-align: center;">Član 412 Oprost duga i novacija</p> <p>Oprostom duga i novacijom između</p>



<p>ndërmjet debitorit dhe një kreditori, zvogëlohet detyrimi solidar për aq sa është shuma e pjesës së kësaj kërkesë të kreditorit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 413 Ujdia</p> <p>Ujdia të cilën e ka lidhur një nga kreditorët solidarë me debitorin nuk ka efekt ndaj kreditorëve të tjerë, por këta kanë të drejtë që ta pranojnë këtë ujdi, me përjashtim kur ai ka të bëjë vetëm me pjesën e kreditorit me të cilin është lidhur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 414 Konfondimi</p> <p>Kur në një person të një kreditori solidar bashkohet edhe cilësia e debitorit, secili prej kreditorëve të tjerë solidarë mund të kërkojë prej tij vetëm pjesën e vet të kërkesës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 415 Vonesa</p> <p>1. Kur debitori bie në vonesë ndaj një kreditori solidar, atëherë ai është në vonesë edhe ndaj kreditorëve të tjerë. 2. Vonesa e një kreditori solidar ka efekt edhe ndaj kreditorëve të tjerë.</p>	<p>novation between the debtor and one creditor the joint and several obligation shall be reduced by the amount of the creditor's share in the claim.</p> <p style="text-align: center;">Article 413 Settlement</p> <p>A settlement concluded by one of the joint and several creditors with the debtor shall have no effect against the other creditors; however they shall have the right to accept it, unless it only relates the share of the creditor with whom it was concluded.</p> <p style="text-align: center;">Article 414 Confusion</p> <p>If the person of one joint and several creditor also combines the attributes of the debtor each of the other joint and several creditors may demand only their part of the claim therefrom.</p> <p style="text-align: center;">Article 415 Delay</p> <p>1. A debtor that is in delay against one joint and several creditor shall be in delay against the other creditors. 2. A delay on the part of one joint and several creditor shall have an effect against the other creditors.</p>	<p>dužnika i jednog poverioca smanjuje se solidarna obaveza za onoliko koliko iznosi deo tog potraživanja poverioca.</p> <p style="text-align: center;">Član 413 Poravnanje</p> <p>Poravnanje koje je zaključio jedan od solidarnih poverilaca sa dužnikom nema dejstva prema ostalim poveriocima, ali ovi imaju pravo da prihvate to poravnanje, izuzev kad se ono odnosi samo na deo poverioca sa kojim je zaključeno.</p> <p style="text-align: center;">Član 414 Sjedinjenje</p> <p>Kad se u licu jednog solidarnog poverioca sjedini i svojstvo dužnika, svaki od ostalih solidarnih poverilaca može od njega zahtevati samo svoj deo potraživanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 415 Docnja</p> <p>1. Kad dužnik dođe u docnju prema jednom solidarnom poveriocu, on je u docnji i prema ostalim poveriocima. 2. Docnja jednog solidarnog poverioca dejstvuje i prema ostalim poveriocima.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 416 Pranimi i borxhit</p> <p>Pranimi i borxhit që i është bërë një kreditori është në favor për të gjithë kreditorët.</p>	<p style="text-align: center;">Article 416 Acknowledgement of debt</p> <p>The acknowledgement of a debt to one creditor shall be in favour of all the creditors.</p>	<p style="text-align: center;">Član 416 Priznanje duga</p> <p>Priznanje duga učinjeno jednom poveriocu koristi svim poveriocima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 417 Parashkrimi</p> <p>1. Në qoftë se një kreditor e ndërpreu parashkrimin ose në qoftë se ndaj tij nuk rrjedh parashkrimi, kjo nuk u shkon në favor kreditorëve të tjerë dhe ndaj tyre parashkrimi rrjedh edhe mëtej.</p> <p>2. Heqja dorë nga parashkrimi që bëhet ndaj njërit kreditor u shkon në favor edhe kreditorëve tjerë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 417 Statute-barring</p> <p>1. If one creditor discontinues statute-barring or the statute-barring period is not running thereagainst, this shall not benefit the other creditors and the statute-barring period shall continue to run against them.</p> <p>2. The waiver of statute-barring against one creditor shall be in favour of all the creditors.</p>	<p style="text-align: center;">Član 417 Zastarelost</p> <p>1. Ako jedan poverilac prekine zastarevanje, ili ako prema njemu ne teče zastarevanje, to ne koristi ostalim poveriocima i prema njima zastarevanje teče i dalje.</p> <p>2. Odricanje od zastarelosti izvršeno prema jednom poveriocu koristi i ostalim poveriocima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 418 Marrëdhëniet ndërmjet kreditorëve pas përmbushjes</p> <p>1. Secili kreditor solidar ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që e ka marrë përmbushjen nga debitori, që t'ia japë pjesën e cila i takon.</p> <p>2. Në qoftë se nga marrëdhënia ndërmjet kreditorëve nuk rrjedh diçka tjetër, secilit kreditor solidar u takon pjesa e barabartë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 418 Relationship among creditors after performance</p> <p>1. Each joint and several creditor shall have the right to demand that the creditor that received performance from the debtor deliver thereto the share pertaining thereto.</p> <p>2. Unless it follows otherwise from the relationship among the creditors an equal share shall go to each joint and several creditor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 418 Odnosi između poverilaca posle ispunjenja</p> <p>1. Svaki solidarni poverilac ima pravo zahtevati od poverioca koji je primio ispunjenje od dužnika da mu preda deo koji mu pripada.</p> <p>2. Ako iz odnosa među poveriocima ne proističe što drugo, svakom solidarnom poveriocu pripada jednak deo.</p>



<u>NËNKREU 3</u> <u>DETYRIMET E PAPJESËTUESHME</u>	<u>SUBCHAPTER 3</u> <u>INDIVISIBLE OBLIGATIONS</u>	<u>PODGLAVLJE 3</u> <u>NEDELJIVE OBAVEZE</u>
<p data-bbox="268 337 655 402">Neni 419 Detyrimet e papjesëtueshme</p> <p data-bbox="184 446 739 548">1. Për detyrimet e papjesëtueshme ku ka disa debitorë përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat mbi detyrimet solidarë.</p> <p data-bbox="184 630 739 1026">2. Kur në detyrimin e papjesëtueshëm ka disa kreditorë ndërmjet të cilëve nuk është kontraktuar solidariteti dhe as që është caktuar me ligj, një kreditor mund të kërkojë që debitori t'i përmbushë atij vetëm në qoftë se është i autorizuar nga kreditorët e tjerë që të pranojë përmbushjen, ndërsa secili kreditor mund të kërkojë nga debitori përmbushjen e gjithë detyrimit ose atë ta depozitojë në gjykatë.</p>	<p data-bbox="877 337 1192 402">Article 419 Indivisible Obligations</p> <p data-bbox="758 446 1312 548">1. The provisions on joint and several obligations shall apply to indivisible obligations with multiple debtors.</p> <p data-bbox="758 630 1312 1026">2. If in the case of an indivisible obligation there are several creditors among whom joint and several liability is neither agreed by contract nor stipulated by law, an individual creditor may only demand performance from the debtor if the other creditors have authorised acceptance by such creditor; otherwise each creditor may demand that the debtor perform the obligation for all of them together or deposit it with the court.</p>	<p data-bbox="1486 337 1738 402">Član 419 Nedeljive obaveze</p> <p data-bbox="1331 446 1885 548">1. Za nedeljive obaveze u kojima ima više dužnika shodno se primenjuju propisi o solidarnim obavezama.</p> <p data-bbox="1331 630 1885 954">2. Kad u nedeljivoj obavezi ima više poverilaca među kojima nije ni ugovorena ni zakonom određena solidarnost, jedan poverilac može zahtevati da dužnik ispuni njemu samo ako je ovlašćen od ostalih poverilaca da primi ispunjenje, a inače svaki poverilac može zahtevati od dužnika da obavezu ispuni svim poveriocima zajedno, ili da je položi sudu.</p>



PJESA VI NDËRRIMI I KREDITORIT OSE I DEBITORIT	PART VI CHANGE OF CREDITOR OR DEBTOR	DEO VI PROMENA POVERIOCA ILI DUŽNIKA
KREU 1	CHAPTER 1	GLAVA 1
CEDIMI I KËRKESËS ME KONTRATË	ASSIGNMENT OF CLAIM BY CONTRACT (CESSION)	USTUPANJA POTRAŽIVANJA UGOVOROM
<u>NËNKREU 1</u> <u>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</u>	<u>SUBCHAPTER 1</u> <u>GENERAL PROVISIONS</u>	<u>PODGLAVLJE 1</u> <u>OPŠTE ODREDBE</u>
Neni 420 Cilat kërkesa mund të kalohen me kontratë	Article 420 Which claims may be transferred by contract	Član 420 Koja se potraživanja mogu preneti ugovorom
<p>1. Kreditori mundet që me kontratën e lidhur me personin e tretë t'i kalojë këtij kërkesat e veta, me përjashtim të atyre kërkesave kalimi i të cilave është i ndaluar me ligj, si dhe i atyre që lidhen me personalitetin e kreditorit, ose të cilat nga vetë natyra e tyre nuk mund t'i barten tjetrit.</p> <p>2. Në rast se debitori dhe kreditori janë pajtuar që kreditori nuk mund të bartë kërkesën te tjetri, bartja nuk ka efekt ligjor.</p>	<p>1. Through a contract concluded with a third person the creditor may transfer the creditor's claim thereto, with the exception of claims whose transfer is prohibited by law and those that are connected to the creditor's personality or whose nature opposes transfer to another.</p> <p>2. If the debtor and the creditor agreed that the creditor could not transfer the claim to another the transfer shall have no legal effect.</p>	<p>1. Poverilac može ugovorom zaključenim sa trećim preneti na ovoga svoje potraživanje, izuzev onog čiji je prenos zabranjen zakonom ili koje je vezano za ličnost poverioca, ili koje se po svojoj prirodi protivi prenošenju na drugoga.</p> <p>2. U slučaju da su dužnik i poverilac pristali da poverilac ne može preneti potraživanje kod drugog, prenos nema zakonsko dejstvo.</p>



<p>3. Nëse me bartjen është dorëzuar dokumenti që vërteton ekzistencën e kërkesës nga e cila nuk rrjedh asnjë ndalesë e bartjes, bartja ke efekt në rast se pranuesi nuk e ka ditur dhe nuk ka qenë i detyruar të dijë për ndalesën e bartjes.</p> <p>4. Në rast se debitori dhe kreditori në një kontratë komerciale janë pajtuar që kreditori nuk mund të bartë kërkesën monetare te tjetri, bartja megjithatë ka efekt. Në këtë rast, debitori po ashtu lirohet nga detyrimi në rast se ajo është përbushur për personin që ka bërë kërkesën.</p> <p style="text-align: center;">Neni 421 Të drejtat aksesore</p> <p>1. Me kërkesën kalojnë në pranuesin të drejtat aksesore, siç janë e drejta e para arkëtimit, hipoteka, pengu, të drejtat nga kontrata me dorëzanimë, e drejta në kamatë, dënimi kontraktues etj.</p> <p>2. Megjithatë, ceduesi mund t'ia dorëzojë sendin peng pranuesit vetëm në qoftë se pengdhënësi e ka dhënë pëlqimin për këtë, përndryshe ajo mbetet pranë ceduesit për ta ruajtur për llogari të pritësit.</p>	<p>3. If upon transfer a document was submitted demonstrating the existence of a claim from which no prohibition of transfer derives the transfer shall have effect if the recipient did not know and was not obliged to know of a prohibition of transfer.</p> <p>4. If the debtor and the creditor from a commercial contract agreed that the creditor could not transfer a pecuniary claim to another the transfer shall nevertheless have effect. In this case the debtor shall also be released from the obligation if it is performed for the assignor of the claim.</p> <p style="text-align: center;">Article 421 Accessory rights</p> <p>1. The accessory rights, such as the right to priority repayment, a mortgage, a pledge, the right from the surety contract, the right to interest and the right to penalty, shall be transferred to the recipient with the claim.</p> <p>2. However the assignor may only deliver a pledged thing to the recipient if the pledger consents thereto; otherwise the thing shall remain with the assignor, in safekeeping for the recipient.</p>	<p>3. Ako je prenosom predat dokument kojim se potvrđuje postojanje potraživanja od koga ne potiče nijedna zabrana prenosa, prenos ima dejstvo ako primalac ne zna i nije bio dužan da zna o zaustavljanju prenosa.</p> <p>4. Ako su se dužnik i poverilac u komercijalnom ugovoru složili da poverilac ne može da prebaci novčanu obavezu drugom, prenos ipak ima dejstvo. U ovom slučaju, dužnik je takođe oslobođen obaveze ako je ispunjena za lice koje je potraživalo.</p> <p style="text-align: center;">Član 421 Sporedna prava</p> <p>1. Sa potraživanjem prelaze na prijemnika sporedna prava, kao što su pravo prvenstvene naplate, hipoteka, zaloga, prava iz ugovora sa jemcem, prava na kamatu, ugovornu kaznu i sl.</p> <p>2. Ipak, ustupilac može predati založenu stvar prijemniku samo ako zalagodavac pristane na to, inače ona ostaje kod ustupioca da je čuva za račun prijemnika.</p>
--	---	---



<p>3. Presupozohet se kanë arritur për pagesë dhe se nuk janë paguar kamatat e ceduara me kërkesën kryesore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 422 Njoftimi i debitorit</p> <p>1. Për bartjen e kërkesës nuk nevojitet pëlqimi i debitorit, por ceduesi ka për detyrë ta njoftojë debitorin mbi cedimin e bërë.</p> <p>2. Përmbushja e kryer ndaj cedusit para njoftimit mbi cedimin është i plotfuqishëm dhe e shkarkon debitorin nga detyrimi, por vetëm në qoftë se nuk ka ditur për cedimin, përndryshe detyrimi mbetet dhe ai ka për detyrë t’ia përmbushë detyrimin cesionarit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 423 Cedimi i shumëfishtë</p> <p>Në qoftë se kreditori iu ka ceduar të njëjtën kërkesë personave të ndryshëm, kërkesa i takon cesionarit për të cilin kreditori e ka njoftuar së pari debitorin përkatësisht i pari i cili i është lajmëruar debitorit.</p>	<p>3. It shall be presumed that interest that has fallen due but has not been paid is assigned with the principal claim.</p> <p style="text-align: center;">Article 422 Notification of debtor</p> <p>1. The debtor’s consent shall not be required for the transfer of a claim, but the assignor must notify the debtor regarding the assignment.</p> <p>2. Performance for the assignor prior to the notification of assignment shall be valid, and the debtor shall thereby be released from the obligation, but only if the debtor did not know of the assignment; otherwise the obligation shall remain and the debtor must perform it for the recipient.</p> <p style="text-align: center;">Article 423 Multiple assignment</p> <p>If the creditor assigned the same claim to various persons the claim shall pertain to the recipient regarding whom the creditor first notified the debtor or that first made himself/herself/itself known to the debtor.</p>	<p>3. Pretpostavlja se da su dospele, a neisplaćene kamate ustupljene sa glavnim potraživanjem.</p> <p style="text-align: center;">Član 422 Obaveštavanje dužnika</p> <p>1. Za prenos potraživanja nije potreban pristanak dužnika, ali je ustupilac dužan obavestiti dužnika o izvršenom ustupanju.</p> <p>2. Ispunjenje izvršeno ustupiocu pre obaveštenja o ustupanju punovažno je i oslobađa dužnika obaveze, ali samo ako nije znao za ustupanje, inače obaveza ostaje i on je dužan da je ispuni prijemniku.</p> <p style="text-align: center;">Član 423 Višestruko ustupanje</p> <p>Ako je poverilac ustupio isto potraživanje raznim licima, potraživanje pripada prijemniku o kome je ustupilac prvo obavestio dužnika, odnosno koji se prvi javio dužniku.</p>
--	---	--



<p style="text-align:center"><u>NËNKREU 2</u> <u>RAPORTI MIDIS PRANUESIT DHE DEBITORIT</u></p> <p style="text-align:center">Neni 424 Raporti midis pranuesit dhe debitorit</p> <p>1. Pranuesi ka ndaj debitorit të njëjtat të drejta të cilat ceduesi i ka pasur ndaj debitorit përpara cedimit.</p> <p>2. Debitori mund t'i theksojë pranuesit përpos prapësimeve që ka ndaj tij edhe ato prapësime të cilat ka mundur t'ia theksojë ceduesit deri në momentin kur ka mësuar për cedim.</p>	<p style="text-align:center"><u>SUBCHAPTER 2</u> <u>RELATIONSHIP BETWEEN RECIPIENT AND DEBTOR</u></p> <p style="text-align:center">Article 424 Relationship Between Recipient and Debtor</p> <p>1. The recipient shall have the same rights against the debtor as those held thereagainst until the assignment by the assignor.</p> <p>2. In addition to the objections held against the recipient the debtor may also exercise thereagainst those objections that could have been exercised against the assignor until the debtor learnt of the assignment.</p>	<p style="text-align:center"><u>PODGLAVLJE 2</u> <u>ODNOS PRIJEMNIKA I DUŽNIKA</u></p> <p style="text-align:center">Član 424 Odnos prijemnika i dužnika</p> <p>1. Prijemnik ima prema dužniku ista prava koja je ustupilac imao prema dužniku do ustupanja.</p> <p>2. Dužnik može istaći prijemniku pored prigovora koje ima prema njemu i one prigovore koje je mogao istaći ustupiocu do časa kad je saznao za ustupanje.</p>
<p style="text-align:center"><u>NËNKREU 3</u> <u>RAPORTI I CEDUESIT DHE I PRANUESIT</u></p> <p style="text-align:center">Neni 425 Dorëzimi i dokumenteve mbi borxhin</p> <p>1. Ceduesi ka për detyrë t'i dorëzojë pranuesit obligacionin apo dokumentin tjetër mbi borxhin, në qoftë se ka një gjë të tillë si dhe provat e tjera mbi kërkesën e ceduar dhe mbi të drejtat aksesore.</p>	<p style="text-align:center"><u>SUBCHAPTER 3</u> <u>RELATIONSHIP BETWEEN ASSIGNOR AND RECIPIENT</u></p> <p style="text-align:center">Article 425 Delivery of IOU</p> <p>1. The assignor must deliver an IOU to the recipient if the assignor holds such, and other evidence on the assigned claim and accessory rights.</p>	<p style="text-align:center"><u>PODGLAVLJE 3</u> <u>ODNOS USTUPIOCA I PRIJEMNIKA</u></p> <p style="text-align:center">Član 425 Predaja isprava o dugu</p> <p>1. Ustupilac je dužan predati prijemniku obveznicu ili drugu ispravu o dugu, ako ih ima, kao i druge dokaze o ustupljenom potraživanju i sporednim pravima.</p>



<p>qiradhënësin mbi shfaqjen e të metës, ose mbi rrezikun e lindur për të cilën ky nuk ka ditur humb të drejtën e shpërblimit të dëmit që do të pësonte për shkak të ekzistimit të të metës ose rrezikut të paraqitur për sendin e marrë me qira dhe ka për detyrë ta shpërblejë dëmin që do ta pësonte qiradhënësi për këtë arsye.</p> <p style="text-align: center;">Neni 595 Të drejtat e qiramarrësit kur sendi ka ndonjë të metë</p> <p>1. Në qoftë se sendi i marrë me qira në momentin e dorëzimit ka ndonjë të metë që nuk mund të evitohet, qiramarrësi mundet sipas dëshirës së vet, ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e çmimit të qirasë.</p> <p>2. Kur sendi ka ndonjë të metë që nuk mund të evitohet pa ndërlikime të mëdha për qiramarrësin, ndërsa dorëzimi i sendit në afatin e caktuar nuk ka qenë pjese esenciale e kontratës, qiramarrësi mund të kërkojë nga qiradhënësi ose evitimim e të metës në afatin plotësues, ose zbritjen e çmimit të qirasë.</p> <p>3. Në qoftë se qiradhënësi nuk e eviton të metën në afatin e ri plotësues që ia ka caktuar qiramarrësi, qiramarrësi mund ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë</p>	<p>regarding a defect or occurring danger of which the lessor did not know shall lose the right to the reimbursement of damage incurred because of the defect or danger, and must reimburse the damage incurred for this reason by the lessor.</p> <p style="text-align: center;">Article 595 Lessee's rights if thing has defect</p> <p>1. If upon delivery the leased thing has any defect that cannot be rectified the lessee may choose to withdraw from the contract or demand a reduction in the rent.</p> <p>2. If the thing has any defect that can be rectified without major inconvenience for the lessee and the delivery of the thing by a specific deadline was not an essential component of the contract the lessee may demand that the lessor rectify the defect by an appropriate deadline or reduce the rent.</p> <p>3. If the lessor fails to rectify the defect by the appropriate additional deadline stipulated by the lessee the lessee may withdraw from the contract or demand a</p>	<p>o pojavljenom nedostatku ili o nastaloj opasnosti, za koje ovaj nije znao, gubi pravo na naknadu štete koju bi pretrpeo zbog postojanja nedostatka ili nastale opasnosti za zakupljenu stvar, a dužan je naknaditi štetu koju bi zakupodavac pretrpeo zbog toga.</p> <p style="text-align: center;">Član 595 Prava zakupca kad stvar ima neki nedostatak</p> <p>1. Ako u času predaje zakupljena stvar ima neki nedostatak koji se ne može otkloniti, zakupac može, po svom izboru, raskinuti ugovor ili zahtevati sniženje zakupnine.</p> <p>2. Kad stvar ima neki nedostatak koji se može otkloniti bez većih komplikacija za zakupca, a predaja stvari u određenom roku nije bila bitni element ugovora, zakupac može zahtevati od zakupodavca ili otklanjanje nedostatka u primerenom roku ili sniženje zakupnine.</p> <p>3. Ako zakupodavac ne otkloni nedostatak u naknadnom primerenom roku koji mu je zakupac odredio, zakupac može raskinuti ugovor ili zahtevati sniženje zakupnine.</p>
--	---	---



<p>zbritjen e çmimit të qirasë.</p> <p>4. Sidoqoftë, qiramarrësi ka të drejtë në shpërblimin e dëmit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 596 Kur e meta paraqitet gjatë qirasë dhe kur sendi nuk ka veçori të kontraktuar ose të zakonshme</p> <p>1. Dispozitat e nenit paraprak aplikohen edhe në rastin kur gjatë qirasë paraqitet ndonjë e mete në sendin e marre me qira.</p> <p>2. Ato aplikohen edhe në rastet kur sendi i marrë me qira nuk ka ndonjë veçori që sipas kontratës ose sipas praktikës duhet të kishite, apo kur kjo veçori humbë gjatë qirasë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 597 Përgjegjësia e qiradhënësit për të metat juridike</p> <p>1. Kur dikush i treti pretendon që në sendin e marre me qira, ose në ndonjë pjesë të tij të ushtrijë ndonjë të drejtë dhe i drejtohet me kërkesë të vet qiramarrësit, si dhe në qoftë se arbitrarisht e merr sendin nga qiramarrësi, ky ka për detyrë ta njoftojë për këtë qiradhënësin, përveç nëse ky është tanimë në dijeni për këtë, përndryshe do të përgjigjet për demin.</p>	<p>reduction in the rent.</p> <p>4. In each case the lessee has the right to the reimbursement of damage.</p> <p style="text-align: center;">Article 596 If defect occurs during lease and if thing does not have agreed or customary attributes</p> <p>1. The provisions of the previous article shall also apply if during the lease a defect occurs in the leased thing.</p> <p>2. They shall also apply if the leased thing does not have an attribute that it should have under the contract or that is customary, or if it loses such an attribute during the lease.</p> <p style="text-align: center;">Article 597 Lessor's liability for legal defects</p> <p>1. When a third person owns any right on the leased thing or a part thereof and turns to the lessee with the claim or arbitrarily takes the thing from the lessee the third person must inform the lessee of such, unless the lessee already knows of such; otherwise the third person shall be liable for damage.</p>	<p>4. U svakom slučaju zakupac ima pravo na naknadu štete.</p> <p style="text-align: center;">Član 596 Kad nedostatak nastane u toku zakupa i kad stvar nema ugovoreno ili uobičajeno svojstvo</p> <p>1. Odredbe prethodnog člana primenjuju se i u slučaju kad u toku zakupa nastane neki nedostatak na zakupljenoj stvari.</p> <p>2. One se primenjuju i u slučajevima kad zakupljena stvar nema neko svojstvo koje po ugovoru ili običaju treba da ima ili kad to svojstvo izgubi u toku zakupa.</p> <p style="text-align: center;">Član 597 Odgovornost zakupodavca za pravne nedostatke</p> <p>1. Kad neko treći pretenduje da na zakupljenoj stvari ili na nekom njenom delu vrši neko pravo i obrati se svojim zahtevom zakupcu, kao i ako arbitrarno oduzme stvar od zakupca, ovaj je dužan obavestiti o tome zakupodavca, izuzev kad to ovaj već zna, inače će odgovarati za štetu.</p>
---	--	--



<p>2. Në qoftë se vërtetohet se personit të tretë i takon ndonjë e drejtë e cila përjashton fare të drejtën e qiramarrësit në përdorimin e sendit, kontrata e qirasë zgjidhet vetvetiu ne bazë të ligjit, ndërsa qiradhënësi ka për detyrë që qiramarrësit t'i shpërblejë dëmin e pësuar për këtë arsye.</p> <p>3. Ne rastin kur me të drejtën e personit të tretë vetëm kufizohet e drejta e qiramarrësit, ky mundet sipas dëshirës së vet ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e qirasë, e në çdo rast shpërblimin e dëmit.</p> <p>KREU 3 DETYRIMET E QIRAMARRËSIT</p> <p>Neni 598 Përdorimi i sendeve sipas kontratës</p> <p>1. Qiramarrësi ka për detyrë ta përdorë sendin si ekonomist i mire respektivisht si shtëpiak i mirë.</p> <p>2. Ai mund ta përdore vetëm ashtu sikundër është caktuar me kontratë ose me destinimin e sendit.</p>	<p>2. If it is found that a third person has any right that totally excludes the lessee's right to use the thing the lease contract shall be rescinded by law alone and the lessor must reimburse the damage to the lessee.</p> <p>3. If the third person's right merely limits the lessee's right the lessee may choose to withdraw from the contract or demand a reduction in the rent; in any case the lessee may demand the reimbursement of damage.</p> <p>CHAPTER 3 LESSEE'S OBLIGATIONS</p> <p>Article 598 Use of thing pursuant to contract</p> <p>1. The lessee shall be obliged to use the thing with the diligence of a good businessperson or with the diligence of a good manager.</p> <p>2. The lessee may only use it as stipulated by the contract or in line with the purpose of the thing.</p>	<p>2. Ako se utvrdi da trećem pripada neko pravo koje sasvim isključuje pravo zakupca na upotrebu stvari, ugovor o zakupu se raskida po samom zakonu, a zakupodavac je dužan naknaditi zakupcu štetu nastalu iz ovog razloga.</p> <p>3. U slučaju kad se pravom trećeg samo ograničava zakupčevo pravo, ovaj može, po svom izboru, raskinuti ugovor ili zahtevati sniženje zakupnine, i u svakom slučaju naknadu štete.</p> <p>GLAVA 3 OBAVEZE ZAKUPCA</p> <p>Član 598 Upotreba stvari prema ugovoru</p> <p>1. Zakupac je dužan upotrebljavati stvar kao dobar privrednik, odnosno dobar domaćin.</p> <p>2. On je može upotrebljavati samo onako kako je određeno ugovorom ili namenom stvari.</p>
--	--	--



<p>3. Ai përgjigjet për dëmin e paraqitur nga përdorimi i sendit të marrë me qira në kundërshtim me kontratën ose me destinimin e tij, pavarësisht nëse a e ka përdorur sendin ai ose ndonjë person që punon me urdhër të tij, ose ndonjë person tjetër të cilit ai ia ka bërë të mundur përdorimin e sendit.</p>	<p>3. The lessee shall be liable for damage incurred because the leased thing was used in breach of the contract or contrary to its purpose, irrespective of whether it was used by the lessee, a person working under the lessee's mandate, a sub-lessee or any other person allowed to use the thing by the lessee.</p>	<p>3. On odgovara za štetu koja nastane upotrebom zakupljene stvari protivno ugovoru ili njenoj nameni, bez obzira na to da li je stvar upotrebljavao on, ili neko lice koje radi po njegovom nalogu, podzakupac ili koje drugo lice kome je on omogućio da upotrebljava stvar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 599 Denoncimi për shkak të përdorimit në kundërshtim me kontratën</p>	<p style="text-align: center;">Article 599 Termination because of use contrary to contract</p>	<p style="text-align: center;">Član 599 Otkaz zbog upotrebe protivno ugovoru</p>
<p>Ne qoftë se qiramarrësi edhe pas paralajmërimit të drejtuar nga qiradhënësi, e përdore sendin në kundërshtim me kontratën ose me destinimin e tij, ose e lën pas dore mirëmbajtjen e tij, kështuqë ekziston rreziku i dëmit të konsideruar për qiradhënësin, ky mund ta denoncoj kontratën pa e dhënë afatin e denoncimit.</p>	<p>If after a notice by the lessor the lessee continues to use the thing contrary to the contract or its purpose or if the lessee neglects the maintenance of the thing and there is a danger of considerable damage being incurred by the lessor, the lessor may terminate the contract without notice.</p>	<p>Ako zakupac i posle opomene zakupodavca upotrebljava stvar protivno ugovoru ili njenoj nameni ili zapušta njeno održavanje, te postoji opasnost znatne štete za zakupodavca, ovaj može otkazati ugovor bez davanja otkaznog roka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 600 Pagimi i qirasë</p>	<p style="text-align: center;">Article 600 Payment of rent</p>	<p style="text-align: center;">Član 600 Plaćanje zakupnine</p>
<p>1. Qiramarrësi ka për detyrë ta paguajë qiranë në afatet e caktuara me kontratë ose me ligj e në mungesë të kontratës dhe të ligjit, ashtu siç praktikohet në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit.</p>	<p>1. The lessee shall be obliged to pay the rent by the deadlines stipulated by the contract or by law, that is by the deadlines customary in the place where the thing was delivered to the lessee.</p>	<p>1. Zakupac je dužan plaćati zakupninu u rokovima određenim ugovorom ili zakonom, a u nedostatku ugovora i zakona, kako je uobičajeno u mestu gde je stvar predata zakupcu.</p>
<p>2. Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe ose në vendin e dorëzimit të</p>	<p>2. Unless agreed otherwise or is customary otherwise in the place of</p>	<p>2. Ako nije drukčije ugovoreno ili u mestu predaje stvari uobičajeno, zakupnina se</p>



<p>sendit nuk praktikohet ndryshe, qiraja paguhet për çdo gjashtëmujor kur sendi është dhënë me qira për një ose për disa vjet e në qoftë se është dhënë për një kohë më të shkurtër, atëherë pasi të ketë kaluar kjo kohë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 601 Denoncimi për shkak të mospagimit të qirasë</p> <p>1. Qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën e qirasë, në qoftë se qiramarrësi nuk paguan qiranë dhe këtë gjë nuk e bën as në afatin prej 15 ditësh pasi qiradhënësi ta ketë ftuar që të kryejë pagesën.</p> <p>2. Mirëpo, kontrata do të mbetet në fuqi në qoftë se qiramarrësi e paguan shumën e debituar të qirasë para se t'i komunikohet denoncimi.</p>	<p>delivery, rent shall be paid every six months for a thing leased for one or more years; if the thing is leased for a shorter period it shall be paid after such period.</p> <p style="text-align: center;">Article 601 Termination because of unpaid rent</p> <p>1. The lessor may terminate the lease contract if the lessee fails to pay the rent, even in the fifteen day time limit after lessor demands the payment from him .</p> <p>2. However the contract shall remain valid if the lessee pays the rent owed before receiving notice of the termination.</p>	<p>plaća polugodišnje kad je stvar data u zakup za jednu ili više godina, a ako je data za kraće vreme, po isteku tog vremena.</p> <p style="text-align: center;">Član 601 Otkaz zbog neplaćanja zakupnine</p> <p>1. Zakupodavac može otkazati ugovor o zakupu ako zakupac ne plati zakupninu ni u roku od 15 dana pošto ga je zakupodavac pozvao na plaćanje.</p> <p>2. Međutim, ugovor će ostati na snazi ako zakupac isplati iznos dužne zakupnine pre nego što mu otkaz bude saopšten.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 602 Kthimi i sendit të marrë me qira</p> <p>1. Qiramarrësi ka për detyrë ta ruajë sendin e marrë me qira dhe pas mbarimit të qirasë ta kthejë të padëmtuar.</p> <p>2. Sendi kthehet në vendin ku është dorëzuar.</p> <p>3. Qiramarrësi nuk përgjigjet për</p>	<p style="text-align: center;">Article 602 Return of leased thing</p> <p>1. The lessee shall be obliged to keep the leased thing safe and to return it undamaged after the lease ends.</p> <p>2. The thing shall be returned at the place it was delivered to the lessee.</p> <p>3. The lessee shall not be liable for wear</p>	<p style="text-align: center;">Član 602 Vraćanje zakupljene stvari</p> <p>1. Zakupac je dužan čuvati zakupljenu stvar i po prestanku zakupa vratiti je neoštećenu.</p> <p>2. Stvar se vraća u mestu u kome je bila predata.</p> <p>3. Zakupac ne odgovara za istrošenost</p>



<p>harxhimin e sendit që krijohet nga përdorimi i tij i zakonshëm, si dhe për dëmtimet që rrjedhin nga vjetrimi i tij.</p> <p>4. Në qoftë se gjatë kohës së qirasë ka bërë ndonjë ndryshim në send, ka për detyrë ta kthejë në gjendjen në të cilën ndodhej kur i është dhënë me qira.</p> <p>5. Ai mund ti marre me vete shtesat që ka bërë në send, në qoftë se mund të veçohen pa ndonjë dëmtim të tij, por qiradhënësi mund t'i mbajë po qe se ia shpërblen vlerën e tyre në kohën e kthimit.</p> <p>KREU 3 DETYRIMET E QIRAMARRËSIT</p> <p>Neni 603 Përdorimi i sendeve sipas kontratës</p> <p>1. Qiramarrësi ka për detyrë ta përdorë sendin si ekonomist i mire respektivisht si shtepiak i mirë.</p> <p>2. Ai mund ta përdorë vetëm ashtu sikundër është caktuar me kontratë ose me destinimin e sendit.</p> <p>3. Ai përgjigjet për dëmin e paraqitur nga</p>	<p>and tear to the thing owing to customary use, or for damage incurred because the thing has reached the end of its useful life.</p> <p>4. If during the lease the lessee made any changes to the thing the lessee shall be obliged to return it to the state it was in when received for leasing.</p> <p>5. The lessee may take any additions added to the thing if such can be separated without damaging the thing; however the lessor may keep them by compensating the lessee for their value upon return.</p> <p>CHAPTER 3 LESSEE'S OBLIGATIONS</p> <p>Article 603 Use of thing pursuant to contract</p> <p>1. The lessee shall be obliged to use the thing with the diligence of a good businessperson or with the diligence of a good manager.</p> <p>2. The lessee may only use it as stipulated by the contract or in line with the purpose of the thing.</p> <p>3. The lessee shall be liable for damage</p>	<p>stvari koja nastaje njenom redovnom upotrebom, kao ni za oštećenja koja potiču od njene dotrajalosti.</p> <p>4. Ako je za vreme zakupa izvršio kakve promene na stvari, dužan je vratiti je u stanje u kome je bila kad mu je predata u zakup.</p> <p>5. On može odneti dodatke koje je učinio na stvari ako se mogu odvojiti bez njenog oštećenja, ali ih zakupodavac može zadržati ako mu naknadi njihovu vrednost u vreme vraćanja.</p> <p>GLAVA 3 OBAVEZE ZAKUPCA</p> <p>Član 603 Upotreba stvari prema ugovoru</p> <p>1. Zakupac je dužan upotrebljavati stvar kao dobar privrednik, odnosno dobar domaćin.</p> <p>2. On je može upotrebljavati samo onako kako je određeno ugovorom ili namenom stvari.</p> <p>3. On odgovara za štetu koja nastane</p>
---	--	--



<p>përdorimi i sendit të marrë me qira në kundërshtim me kontratën ose me destinimin e tij, pavarësisht nëse e ka përdorur sendin ai ose ndonjë person që punon me urdhër të tij, ose ndonjë person tjetër të cilit ai ia ka bërë të mundur përdorimin e sendit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 604 Denoncimi për shkak të përdorimit në kundërshtim me kontratën</p> <p>Në qoftë se qiramarrësi edhe pas paralajmërimit të drejtuar nga qiradhënësi, e përdorë sendin në kundërshtim me kontratën ose me destinimin e tij, ose e len pas dore mirembajtjen e tij, kështu që ekziston rreziku i dëmit të konsideruar për qiradhënësin, ky mund ta denoncoj kontratën pa e dhënë afatin e denoncimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 605 Denoncimi për shkak të nënqirasë së palejueshme</p> <p>Qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën e qirasë në qoftë se sendi i marrë me qira është dhënë në nënqira pa lejen e tij kur kjo sipas ligjit, ose sipas kontratës është e nevojshme.</p>	<p>incurred because the leased thing was used in breach of the contract or contrary to its purpose, irrespective of whether it was used by the lessee, a person working under the lessee's mandate, a sub-lessee or any other person allowed to use the thing by the lessee.</p> <p style="text-align: center;">Article 604 Termination because of use contrary to contract</p> <p>If after a notice by the lessor the lessee continues to use the thing contrary to the contract or its purpose or if the lessee neglects the maintenance of the thing and there is a danger of considerable damage being incurred by the lessor, the lessor may terminate the contract without notice.</p> <p style="text-align: center;">Article 605 Termination because of non-permitted sublease</p> <p>The lessor may terminate the lease contract if the lessee subleases the leased thing without the lessor's permission when such is required by law or by the contract.</p>	<p>upotrebom zakupljene stvari protivno ugovoru ili njenoj nameni, bez obzira na to da li je stvar upotrebljavao on, ili neko lice koje radi po njegovom nalogu, podzakupac ili koje drugo lice kome je on omogućio da upotrebljava stvar.</p> <p style="text-align: center;">Član 604 Otkaz zbog upotrebe protivno ugovoru</p> <p>Ako zakupac i posle opomene zakupodavca upotrebljava stvar protivno ugovoru ili njenoj nameni ili zapušta njeno održavanje, te postoji opasnost znatne štete za zakupodavca, ovaj može otkazati ugovor bez davanja otkaznog roka.</p> <p style="text-align: center;">Član 605 Otkaz zbog nedozvoljenog podzakupa</p> <p>Zakupodavac može otkazati ugovor o zakupu ako je zakupljena stvar data u podzakup bez njegove dozvole, kad je ova prema zakonu ili prema ugovoru potrebna.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 606 Kërkesa e drejteperdrejte e qiradhënësit</p> <p>Qiradhënësi mundet për ti arkëtuar kërkesat e veta nga qiramarrësi të krijuara nga qiraja, të kërkojë drejteperdrejte nga nënqiramarrësi pagimin e shumës që ky i debiton qiramarrësit ne bazë të nënqiras.</p>	<p style="text-align: center;">Article 606 Lessor's direct request</p> <p>In order for the lessor's claims arising from the lease to be repaid the lessor may directly request from the sublessee the payment of the amount the latter owes the lessee from the sublease.</p>	<p style="text-align: center;">Član 606 Neposredni zahtev zakupodavca</p> <p>Zakupodavac može, radi naplate svojih potraživanja od zakupca nastalih iz zakupa, zahtevati neposredno od podzakupca isplatu iznosa koje ovaj duguje zakupcu po osnovu podzakupa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 607 Shuarja e nënqirasë në bazë të vetë ligjit</p> <p>Nënqiraja shuhet në çdo rast kur shuhet qiraja.</p> <p style="text-align: center;">KREU 5 TJETËRSIMI I SENDIT TË MARRË ME QIRA</p> <p style="text-align: center;">Neni 608 Tjetërsimi pas dorëzimit me qira</p> <p>1. Në rast te tjetërsimit të sendit i cili para kësaj i është dorëzuar ndonjë tjetrit me qira fituesi i sendit zene vendin e qiradhënësit, kështu që pas kësaj, të drejtat dhe detyrimet nga qiraja linden midis tij dhe për qiramarrësit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 607 Termination of sublease by law alone</p> <p>A sublease shall terminate in any case when the lease terminates.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER 5 ALIENATION OF LEASED THING</p> <p style="text-align: center;">Article 608 Alienation after delivery for leasing</p> <p>1. In the alienation of a thing that prior to this was delivered to another for leasing the acquirer of the thing shall assume the place of the lessor; thenceforth the rights and obligations deriving from the lease shall exist between the acquirer and the</p>	<p style="text-align: center;">Član 607 Prestanak podzakupa po samom zakonu</p> <p>Podzakup prestaje u svakom slučaju kada prestane zakup.</p> <p style="text-align: center;">GLAVA 5 OTUĐENJE ZAKUPLJENE STVARI</p> <p style="text-align: center;">Član 608 Otuđenje posle predaje u zakup</p> <p>1. U slučaju otuđenja stvari koja je pre toga predata nekom drugom u zakup pribavilac stvari stupa na mesto zakupodavca te posle toga prava i obaveze iz zakupa nastaju između njega i zakupca.</p>



<p>2. Fituesi nuk mund të kërkojë nga qiramarrësi që t'ia dorëzojë sendin para se të ketë kaluar koha për të cilën është kontraktuar qiraja e në qoftë se kohëzgjatja e qirasë nuk është caktuar as me kontratë dhe as me ligj, atëherë para skadimit të afatit të denoncimit.</p> <p>3. Për detyrimet e fituesit nga qiraja ndaj qiramarrësit përgjigjet bartësi si dorzan solidar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 609 E drejta e çmimit të qirasë</p> <p>1. Ne qofte se nuk është kontraktuar diçka tjetër, fituesi i sendit të dorëzuar me qira ka të drejtë në çmimin e qirasë, duke filluar që nga afati i parë i ardhshëm pas fitimit të sendit, nëse bartësi ka pranuar qiranë që më parë, bartësi duhet të njëjtën t'ia kthejë fituesit.</p> <p>2. Që nga momenti kur është njoftuar mbi tjetërsimin e sendit të marrë me qira, qiramarrësi mund t'ia paguajë çmimin a qirasë vetëm fituesit.</p>	<p>lessee.</p> <p>2. The acquirer may not demand that the lessee deliver the thing prior to the end of the period for which the lease was agreed, or the end of the period of notice if the duration of the lease is not stipulated by the contract or by law.</p> <p>3. For the obligations of the acquirer from the lease, the transferor is liable as solidary surety.</p> <p style="text-align: center;">Article 609 Right to rent</p> <p>1. The acquirer of a leased thing shall have the right to the rent from the first period after acquiring the thing, unless agreed otherwise; if the lessor received this rent in advance the lessor must deliver it to the acquirer.</p> <p>2. The lessee must pay the rent solely to the acquirer from the moment of being notified of the alienation of the leased thing.</p>	<p>2. Pribavilac ne može zahtevati od zakupca da mu preda stvar pre proteka vremena za koje je zakup ugovoren, a ako trajanje zakupa nije određeno ni ugovorom ni zakonom, onda pre isteka otkaznog roka.</p> <p>3. Za pribaviočeve obaveze iz zakupa prema zakupcu odgovara prenosilac kao solidarni jamac.</p> <p style="text-align: center;">Član 609 Pravo na zakupninu</p> <p>1. Ako nije što drugo ugovoreno, pribavilac stvari predate u zakup ima pravo na zakupninu počev od prvog narednog roka posle pribavljanja stvari, a ako je prenosilac primio tu zakupninu unapred, dužan je da mu je ustupi.</p> <p>2. Od časa kad je obavešten o otuđenju zakupljene stvari zakupac može isplatiti zakupninu samo pribavioču.</p>
--	---	---



<p style="text-align: center;">Neni 610 Tjetërsimi i sendit të marrë me qira para se t'i dorëzohet qiramarrësit</p> <p>1. Në qoftë se sendi për të cilin është lidhur kontrata e qirasë i është dorëzuar fituesit, e jo qiramarrësit, fituesi zëne vendin e qiradhënësit dhe merr përsipër detyrimet e tij ndaj qiramarrësit në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratës mbitjetërsimin ka qenë në dijeni për ekzistimin e kontratës së qirasë.</p> <p>2. Fituesi i cili në momentin e lidhjes së kontratës mbi tjetërsimin nuk ka qenë në dijeni për ekzistimin e kontratës së qirasë, nuk ka për detyrë t'ia dorëzojë qiramarrësit sendin, ndërsa qiramarrësi mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit nga qiradhënësi.</p> <p>3. Për detyrimet e fituesit nga dhënia me qira ndaj qiramarrësit përgjigjet bartësi si dorëzues solidar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 610 Alienation of leased thing prior to delivery to lessee</p> <p>1. If the thing about which a lease contract was concluded is delivered to the acquirer and not the lessee the acquirer shall assume the place of the lessor and take over the lessor's obligations towards the lessee if when the contract on alienation was concluded the acquirer knew of the lease contract.</p> <p>2. An acquirer that did not know of the lease contract when the contract on alienation was concluded shall not be obliged to deliver the thing to the lessee; the lessee may only demand the reimbursement of damage from the lessor.</p> <p>3. For the obligations of the acquirer from the lease towards the lessee, the transferor is liable as solidary surety.</p>	<p style="text-align: center;">Član 610 Otuđenje zakupljene stvari pre predaje zakupcu</p> <p>1. Kad je stvar o kojoj je zaključen ugovor o zakupu predata pribaviocu, a ne zakupcu, pribavilac stupa na mesto zakupodavca i preuzima njegove obaveze prema zakupcu ako je u momentu zaključenja ugovora o otuđenju znao za postojanje ugovora o zakupu.</p> <p>2. Pribavilac koji u momentu zaključenja ugovora o otuđenju nije znao za postojanje ugovora o zakupu, nije dužan predati stvar zakupcu, a zakupac može samo tražiti naknadu štete od zakupodavca.</p> <p>3. Za pribaviočeve obaveze iz zakupa prema zakupcu odgovara prenosilac kao solidarni jamac.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 611 Denoncimi i kontratës për shkak të tjetërsimit të sendit</p> <p>Kur për shkak të tjetërsimit të sendit të marrë me qira të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit kalojnë në fituesin, qiramarrësi mund ta denoncoj kontratën</p>	<p style="text-align: center;">Article 611 Termination of contract because of alienation of thing</p> <p>If because of the alienation of a leased thing the lessor's rights and obligations were transferred to the acquirer the lessee may in any case terminate the contract,</p>	<p style="text-align: center;">Član 611 Otkaz ugovora zbog otuđenja stvari</p> <p>Kad usled otuđenja zakupljene stvari prava i obaveze zakupodavca pređu na pribavioca, zakupac može otkazati ugovor u svakom slučaju, poštujući zakonske</p>



<p>në çdo rast, duke respektuar afatet ligjore të denoncoje.</p> <p>KREU 6 SHUARJA E QIRASË</p> <p>Neni 612 Kalimi i kohës së caktuar</p> <p>1. Kontrata e qirasë e lidhur për një kohe të caktuar shuhet me vetë kalimin e kohës për të cilën është lidhur.</p> <p>2. E njëjta gjë vlen edhe në rastet kur në mungesë të vullnetit të kontraktuesve kohëzgjatja e qirasë është caktuar me ligj.</p> <p>Neni 613 Përtritja heshtazi e qirasë</p> <p>1. Kur pasi të ketë kaluar koha për të cilën është lidhur kontrata e qirasë, qiramarrësi vazhdon ta përdorë sendin, ndërsa qiradhënësi nuk e kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontratë e re e qirasë me kohëzgjatje të pacaktuar, në të njëjtat kushte sikurse edhe në ato paraprake.</p> <p>2. Sigurimet të cilat personat e tretë kanë dhënë për qiranë e parë, shuhen me të</p>	<p>but in so doing must observe the legal periods of notice of termination.</p> <p>CHAPTER 6 TERMINATION OF LEASE</p> <p>Article 612 End of stipulated period</p> <p>1. A lease contract concluded for a stipulated period shall terminate at the end of the period for which it was concluded.</p> <p>2. This shall also apply in cases when the contracting parties did not declare their intentions and the duration of the lease was stipulated by law.</p> <p>Article 613 Tacitly renewed lease</p> <p>1. If following the end of the period for which the lease contract was concluded the lessee continues to use the thing and the lessor does not oppose such, a new lease contract for an indefinite period shall be deemed to have been concluded with the same terms and conditions as the previous contract.</p> <p>2. Security provided by third persons for the first lease shall expire at the end of the</p>	<p>otkazne rokove.</p> <p>GLAVA 6 PRESTANAK ZAKUPA</p> <p>Član 612 Protok određenog vremena</p> <p>1. Ugovor o zakupu zaključen za određeno vreme prestaje samim protokom vremena za koje je zaključen.</p> <p>2. Isto važi i u slučajevima kad je, u nedostatku volje ugovarača, trajanje zakupa određeno zakonom.</p> <p>Član 613 Prećutno obnavljanje zakupa</p> <p>1. Kad po proteku vremena za koje je ugovor o zakupu bio zaključen, zakupac produži da upotrebljava stvar, a zakupodavac se tome ne protivi, smatra se da je zaključen nov ugovor o zakupu neodređenog trajanja, pod istim uslovima kao i prethodni.</p> <p>2. Obezbeđenja koja su treća lica dala za prvi zakup prestaju protekom vremena za</p>
--	---	--



<p>kaluar koha për të cilat është lidhur kontrata e pare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 614 Denoncimi</p> <p>1. Kontrata e qirasë kohëzgjatja e së cilës nuk është caktuar dhe as që mund të caktohet nga rrethanat apo nga zakonet e vendit shuhet me denoncim të cilin secila palë mund t'ia japë tjetrës duke respektuar afatin a caktuar të denoncimit.</p> <p>2. Në qoftë se kohëzgjatja e afatit të denoncimit nuk është caktuar me kontratë ose me ligj apo me zakonet e vendit, ndërsa ajo është tetë ditë por që denoncimi të mos mund të jepet në kohën jo të duhur.</p> <p>3. Në qoftë se sendet e marra me qira janë të rrezikshme për shëndetin, qiramarrësi mund ta denoncoje kontratën pa e dhënë afatin e denoncimit edhe në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratës e ka ditur këtë.</p> <p>4. Qiramarrësi nuk mund të heqë dorë nga e drejta e paraparë në paragrafin 3 të këtij neni.</p>	<p>period for which the lease was concluded.</p> <p style="text-align: center;">Article 614 Termination</p> <p>1. A lease contract whose duration is not stipulated and cannot be determined from the circumstances or local customs shall terminate through notice of termination, which each party may give to the other, observing the stipulated period of notice of termination.</p> <p>2. If the period of notice of termination is not stipulated by the contract, by law or according to local customs, it shall amount to eight days; provided the notice shall not be given at an inappropriate time.</p> <p>3. If the leased things are a health hazard the lessee may terminate the contract without notice, even if this was known when the contract was concluded.</p> <p>4. The lessee may not waive the right specified in the third paragraph of this article.</p>	<p>koje je bio zaključen prvi ugovor.</p> <p style="text-align: center;">Član 614 Otkaz</p> <p>1. Ugovor o zakupu čije trajanje nije određeno niti se može odrediti iz okolnosti ili mesnih običaja prestaje otkazom koji svaka strana može dati drugoj, poštujući određeni otkazni rok.</p> <p>2. Ako dužina otkaznog roka nije određena ugovorom ili zakonom ili mesnim običajima, ona iznosi osam dana, s tim da otkaz ne može biti dat u nevreme.</p> <p>3. Ako su zakupljene stvari opasne po zdravlje, zakupac može otkazati ugovor bez davanja otkaznog roka, čak i ako je u času zaključenja ugovora to znao.</p> <p>4. Zakupac se ne može odreći prava iz stava 3 ovog Člana.</p>
---	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 615 Shkatërrimi i sendeve për shkak të forcës madhore</p> <p>1. Marrja me qira pushon në qoftë se sendi i marrë me qira shkatërrohet nga ndonjë rast i forcës madhore.</p> <p>2. Në qoftë se sendi i marrë me qira shkatërrohet pjesërisht ose vetëm dëmtohet, qiramarrësi mund ta zgjidhë kontratën, ose të mbetet edhe më tej në qiramarrje dhe të kërkojë zbritjen përkatëse të çmimit të qirasë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 615 Destruction of thing by force majeure</p> <p>1. The lease shall terminate if the leased thing is destroyed by force majeure.</p> <p>2. If the leased thing is partly destroyed or merely damaged the lessee may withdraw from the contract or may remain with the lease and demand an appropriate reduction in the rent.</p>	<p style="text-align: center;">Član 615 Propast stvari usled više sile</p> <p>1. Zakup prestaje ako zakupljena stvar bude uništena nekim slučajem više sile.</p> <p>2. Ako zakupljena stvar bude delimično uništena ili samo oštećena, zakupac može raskinuti ugovor ili ostati i dalje u zakupu i zahtevati odgovarajuće sniženje zakupnine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 616 Vdekja</p> <p>Në rast të vdekjes të qiramarrësit ose të qiradhënësit qiraja, vazhdon me trashëgimtarë të tij po që se nuk është kontraktuar ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 616 Death</p> <p>If the lessor or the lessee die and it is not agreed otherwise the lease shall continue with their heirs.</p>	<p style="text-align: center;">Član 616 Smrt</p> <p>U slučaju smrti zakupca ili zakupodavca zakup se nastavlja sa njegovim naslednicima ako nije drukčije ugovoreno.</p>



PJESA X KONTRATA PËR VEPRËN	PART X CONTRACT FOR WORK	DEO X UGOVOR O DELU
KREU 1 DISPOZITA PËRGJITHSHME	CHAPTER 1 GENERAL PROVISIONS	GLAVA 1 OPŠTE ODREDBE
Neni 617 Kuptimi	Article 617 Definition	Član 617 Pojam
<p>Me kontratën për veprën kryerësi i punëve detyrohet të kryejë një punë të caktuar, sikurse është prodhimi ose riparimi i ndonjë sendi ose kryerja e ndonjë pune fizike ose intelektuale e të ngjashme kurse porositësi është i detyruar për atë të paguajë shpërblimin.</p>	<p>Through a contract for work the contractor undertakes to perform a specific transaction such as the manufacture or repair of a thing, or physical or intellectual work, and the ordering party undertakes to pay the contractor for this.</p>	<p>Ugovorom o delu poslenik se obavezuje da obavi određeni posao, kao što je izrada ili opravka neke stvari ili izvršenje nekog fizičkog ili intelektualnog rada i slično, a naručilac se obavezuje da mu za to plati naknadu.</p>
Neni 618 Raporti me kontratën për shitjen	Article 618 Relationship to sales contract	Član 618 Odnos sa ugovorom o prodaji
<p>1. Kontrata me të cilën njëra palë detyrohet të prodhojë një send të caktuar të luajtshëm prej materialit të vet konsiderohet në rast dyshimi kontratë për shitje.</p> <p>2. Kontrata mbetet kontratë për veprën në qoftë se porositësi është detyruar të japë</p>	<p>1. A contract by which one party undertakes to make a specific movable thing from the party's own material shall in case of doubt be deemed a sales contract.</p> <p>2. However a contract shall remain a contract for work if the ordering party</p>	<p>1. Ugovor kojim se jedna strana obavezuje da izradi određenu pokretnu stvar od svog materijala smatra se u sumnji kao ugovor o prodaji.</p> <p>2. Ugovor ostaje ugovor o delu ako se naručilac obavezao dati bitan deo</p>



<p>pjesën thelbësore të materialit të nevojshëm për prodhimin e sendit.</p> <p>3. Në çdo rast kontrata konsiderohet kontratë për vepër, në qoftë se kontraktuesit kanë pas për qëllim veçanërisht punën e kryerësit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 619 Cilësia e materialit të kryerësit</p> <p>1. Në qoftë se është kontraktuar që kryerësi të prodhojë një send prej materialit të vet, ndërsa nuk është caktuar cilësia, sipërmarrësi ka për detyrë të japë material të cilësisë së mesme.</p> <p>2. Ai i përgjigjet porositësit për cilësinë e materialit njësoj si shitësi.</p> <p>KREU 2 MBIKËQYRJA</p> <p style="text-align: center;">Neni 620 Mbikëqyrja</p> <p>Porositësi ka të drejtë të bëjë mbikëqyrjen e kryerjes së punës e të japë udhëzime kur kjo i përgjigjet natyrës së punës, ndërsa kryerësi ka për detyrë t'ia bëjë të mundur këtë.</p>	<p>undertook to supply the essential part of the material required to make the thing.</p> <p>3. In any case a contract shall be deemed a contract for work if the contracting parties primarily had contracted work in mind.</p> <p style="text-align: center;">Article 619 Quality of contractor's material</p> <p>1. If it is agreed that the contractor will make the thing using the contractor's own material and the quality thereof is not stipulated, the contractor shall be obliged to provide material of medium quality.</p> <p>2. He is liable to the ordering party for the quality of the material in the same way as the seller.</p> <p>CHAPTER 2 SUPERVISION</p> <p style="text-align: center;">Article 620 Supervision</p> <p>The ordering party shall have the right to supervise the transaction and to provide instructions if this suits the nature of the transaction; the contractor must facilitate this.</p>	<p>materijala potreban za izradu stvari.</p> <p>3. U svakom slučaju ugovor se smatra ugovorom o delu ako su ugovarači imali u vidu naročito poslenikov rad.</p> <p style="text-align: center;">Član 619 Kvalitet poslenikovog materijala</p> <p>1. Kad je ugovoreno da poslenik izradi stvar od svog materijala, a nije određen kvalitet, poslenik je dužan dati materijal srednjeg kvaliteta.</p> <p>2. On odgovara naručiocu za kvalitet upotrebljenog materijala isto kao prodavac.</p> <p>GLAVA 2 NADZOR</p> <p style="text-align: center;">Član 620 Nadzor</p> <p>Naručilac ima pravo da vrši nadzor nad obavljanjem posla i daje uputstva kad to odgovara prirodi posla, a poslenik je dužan da mu to omogući.</p>
---	--	--



<p>KREU 3 LIDHJA E KONTRATËS ME ANË TË ANKANDIT</p> <p>Neni 621 Ftesa për ankand mbi çmimin e punimeve</p> <p>1. Ftesa e drejtuar numrit të caktuar ose të pacaktuar personash, në kushtet e caktuara dhe me garancione të caktuara, detyron ftuesin të lidhë kontratën për ato punime me atë që ofron çmimin më të ulët, përveç nëse këtë detyrim e ka përjashtuar me ftesën për ankand.</p> <p>2. Në rastin e përjashtimit të detyrimit për të lidhë kontratën, ftesa për ankand konsiderohet si ftesë të interesuarve që ata të bëjnë oferta të kontratës sipas kushteve të shpallura.</p> <p>Neni 622 Ftesa për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të punëve të synuara</p> <p>Ftesa e drejtuar numrit të caktuar ose të pacaktuar personash për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të</p>	<p>CHAPTER 3 CONCLUSION OF CONTRACT AFTER BIDDING</p> <p>Article 621 Invitation to bid for cost of work</p> <p>1. An invitation to bid addressed to a specific or indefinite number of persons, under specific conditions and with specific guarantees, shall bind the inviting party to conclude a contract for such works with the person that offers the lowest price, unless such obligation was excluded in the invitation to bid.</p> <p>2. If the obligation to conclude a contract was excluded, the invitation to bid shall be deemed an invitation to interested parties to prepare offers for the contract according to the published conditions.</p> <p>Article 622 Invitation to bid for artistic or technical solutions for intended works</p> <p>An invitation to bid for artistic or technical solutions for intended works addressed to a specific or indefinite</p>	<p>GLAVA 3 ZAKLJUČIVANJE UGOVORA NADMETANJEM</p> <p>Član 621 Poziv na nadmetanje o ceni radova</p> <p>1. Poziv upućen određenom ili neodređenom broju lica na nadmetanje za izvršenje određenih radova, pod određenim uslovima i uz određene garancije, obavezuje pozivaoca da zaključi ugovor o tim radovima sa onim koji ponudi najnižu cenu, izuzev ako je tu obavezu isključio u pozivu na nadmetanje.</p> <p>2. U slučaju isključenja obaveze da se zaključi ugovor, poziv na nadmetanje smatra se kao poziv zainteresovanima da oni naprave ponude ugovora pod objavljenim uslovima.</p> <p>Član 622 Poziv na nadmetanje za umetničko ili tehničko rešenje nameravanih radova</p> <p>Poziv upućen određenom ili neodređenom broju lica na nadmetanje za umetničko ili tehničko rešenje nameravanih radova</p>
---	--	--



<p>punimeve të synuara, detyrojnë ftuesin që sipas kushteve të përmbajtura në ftesë për ankand të lidhë kontratën me pjesëmarrësin e ankandit, zgjedhja e të cilit është pranuar nga komisioni me përbërjen e shpallur që përpara, përveç nëse këtë detyrim e ka përjashtuar në ftesën e ankandit.</p> <p>KREU 4 DETYRIMET E KRYERËSIT</p> <p>Neni 623 Te metat e materialit</p> <p>1. Kryerësi ka për detyrë ta paralajmërojë porositësin për të metat e materialit që e ka dorëzuar porositësi, që i ka vënë re ose është dashur t i vërejë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin.</p> <p>2. Në qoftë se porositësi i ka kërkuar që sendi të prodhohet prej materialit për të metat e të cilit kryerësi i'a ka treguar, kryerësi ka për detyrë të veprojë sipas kërkesës së tij, përveç nëse është e qartë se materiali nuk është i përshtatshëm për veprën e porositur ose në qoftë se prodhimi prej materiali të kërkuar do të mund t'i bëjë dëm prestigjit të kryerësit , në të cilin rast kryerësi mund ta zgjidhë</p>	<p>number of persons shall bind the inviting party to conclude a contract under the conditions contained in the invitation with the bidding participant whose solution is approved by a commission whose composition is published in advance, unless such obligation was excluded in the invitation to bid.</p> <p>CHAPTER 4 CONTRACTOR'S OBLIGATIONS</p> <p>Article 623 Defects in material</p> <p>1. The contractor shall be obliged to warn the ordering party to any defects in the material that the ordering party delivered, that he noticed or should have noticed; otherwise he shall be liable for damage.</p> <p>2. If the ordering party requested that the thing be made from material with defects to which the contractor had drawn attention the contractor must act in accordance with this request, unless it is clear that the material is not suitable for the work ordered or if making the thing from the requested material could damage the contractor's reputation; in this case the contractor may withdraw from the</p>	<p>obavezuje pozivaoca da pod uslovima sadržanim u pozivu na nadmetanje zaključi ugovor sa učesnikom u nadmetanju čije rešenje prihvati komisija čiji je sastav unapred objavljen, izuzev ako je tu obavezu isključio u pozivu na nadmetanje.</p> <p>GLAVA 4 OBAVEZE POSLENIKA</p> <p>Član 623 Nedostaci materijala</p> <p>1. Poslenik je dužan skrenuti pažnju naručiocu na nedostatke materijala koji mu je naručilac predao, a koje je primetio ili je morao primetiti, inače će odgovarati za štetu.</p> <p>2. Ako je naručilac zahtevao da se stvar izradi od materijala na čije mu je nedostatke poslenik ukazao, poslenik je dužan postupiti po njegovom zahtevu, izuzev ako je očigledno da materijal nije pogodan za naručeno delo ili ako bi izrada od zahtevanog materijala mogla naneti štetu ugledu poslenika, u kom slučaju poslenik može raskinuti ugovor.</p>
---	--	---



<p>kontratën.</p> <p>3. Kryerësi ka për detyrë ta paralajmërojë porositësin për të metat në urdhrin e tij dhe për rrethana të tjera që ishte në dijëni ose duhej të ishte në dijëni të cilat mund të jenë të rëndësishme për veprën e porositur ose për kryerjen në kohë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 624 Detyrimi për ta kryer veprën</p> <p>1. Kryerësi ka për detyrë ta kryejë veprën si është kontraktuar dhe sipas rregullave të punës.</p> <p>2. Ai ka për detyrë ta kryejë veprën për kohën e caktuar, e në qoftë se kjo nuk është caktuar, atëherë për një kohë të arsyeshme që nevojitet për punë të tilla.</p> <p>3. Ai nuk përgjigjet për vonesë, të shkaktuar për shkak se porositësi nuk i'a ka dorëzuar materialin në kohë, apo për shkak se ka kërkuar ndryshime, apo sepse nuk i'a ka paguar paradhënien e kontraktuar dhe në përgjithësi për vonesë të shkaktuar nga sjellja e porositësit.</p>	<p>contract.</p> <p>3. The contractor shall be obliged to warn the ordering party to any deficiencies in the order and to other circumstances of which he knew or should have known and that could be significant to the ordered work or for timely execution; otherwise he shall be liable for damage.</p> <p style="text-align: center;">Article 624 Obligation to execute work</p> <p>1. The contractor shall be obliged to execute the work according to the agreement and according to the rules of the transaction.</p> <p>2. The contractor must execute the work by the deadline stipulated, or in the time reasonably required for such transactions if no deadline is stipulated.</p> <p>3. The contractor shall not be liable for any delay occurring because the ordering party failed to deliver the material thereto on time, because the ordering party requested changes or because the ordering party failed to settle an owed advance payment, or in general for any delay occurring because of the ordering party's action.</p>	<p>3. Poslenik je dužan upozoriti naručioca na nedostatke u njegovom nalogu, kao i na druge okolnosti za koje je znao ili je morao znati, koje mogu biti od značaja za naručeno delo ili za njegovo izvršenje na vreme, inače će odgovarati za štetu.</p> <p style="text-align: center;">Član 624 Obaveza da izvrši delo</p> <p>1. Poslenik je dužan izvršiti delo kako je ugovoreno i po pravilima posla.</p> <p>2. On je dužan izvršiti ga za određeno vreme, a ako ono nije određeno, onda za vreme koje je razumno potrebno za takve poslove.</p> <p>3. On ne odgovara za zadocnjenje nastalo zbog toga što mu naručilac nije predao materijal na vreme, ili zbog toga što je tražio izmene, ili što mu nije isplatio dužan predujam i uopšte za zadocnjenje nastalo ponašanjem naručioca.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 625 Zgjidhja e kontratës për shkak të shmangies nga kushtet e kontraktuara</p> <p>1. Në qoftë se gjatë kryerjes së veprës tregohet se kryerësi nuk u përmbahet kushteve të kontratës dhe në përgjithësi nuk punon si duhet, kështu që vepra e kryer do të ketë të meta, porositësi mund ta paralajmërojë kryerësin për këtë dhe t'i caktojë afat plotësues që punën e vet t'ua përshtatë detyrimeve të veta.</p> <p>2. Në qoftë se deri në skadimin e këtij afati kryerësi i punës nuk vepron sipas kërkesës së porositësit, ky mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 625 Withdrawal from contract because of deviation from agreed conditions</p> <p>1. If during the execution of the work it is shown that the contractor is not keeping to the contractual conditions and is not in general working as the contractor should and that the work executed will have defects, the ordering party may warn the contractor of this and stipulate a deadline by which the work should be adapted to the obligations.</p> <p>2. If the contractor fails to fulfil the ordering party's requirements by this deadline the ordering party may withdraw from the contract and demand the reimbursement of damage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 625 Raskidanje ugovora zbog odstupanja od ugovorenih uslova</p> <p>1. Ako se u toku izvršenja dela pokaže da se poslenik ne drži uslova ugovora i uopšte da ne radi kako treba, te da će izvršeno delo imati nedostatke, naručilac može upozoriti poslenika na to i odrediti mu primeren rok da svoj rad uskladi sa svojim obavezama.</p> <p>2. Ako do isteka tog roka poslenik ne postupi po zahtevu naručioca, ovaj može raskinuti ugovor i zahtevati naknadu štete.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 626 Zgjidhja e kontratës para kalimit të afatit</p> <p>1. Në qoftë se afati është element thelbësor i kontratës, ndërsa kryerësi është aq në vonesë me fillimin ose me kryerjen e punës, sa që është e qartë se nuk do ta kryejë brenda afatit, porositësi mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 626 Withdrawal from contract prior to deadline</p> <p>1. If the deadline is an essential component of the contract and the contractor is so delayed in starting or finishing off the transaction that it is clear that it will not be completed on time the ordering party may withdraw from the contract and demand the reimbursement of damage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 626 Raskidanje ugovora pre isteka roka</p> <p>1. Ako je rok bitan element ugovora, a poslenik je u tolikom zakašnjenju sa započinjanjem ili završavanjem posla da je očigledno da ga neće završiti u roku, naručilac može raskinuti ugovor i zahtevati naknadu štete.</p>



<p>2. Ai ka këtë të drejtë edhe atëherë kur afati nuk është element thelbësor i kontratës në qoftë se për shkak të vonesës së tillë porositësi qartazi nuk do të kishte interes për përbushjen e kontratës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 627 Besimi i kryerjes së punës personit të tretë</p> <p>1. Në qoftë se nga kontrata ose nga vetë natyra e punës nuk rrjedh diçka tjetër, kryerësi nuk e ka për detyrë që punën ta kryejë personalisht.</p> <p>2. Kryerësi edhe me tej i përgjigjet personit për kryerjen e punës edhe kur punën nuk e kryen personalisht.</p> <p style="text-align: center;">Neni 628 Përgjegjësia për bashkëpunëtorët</p> <p>Kryerësi përgjigjet për personat të cilët sipas urdhrorit të tij kanë punuar në punën që e ka marrë përsipër ta kryejë, sikur ta këtë kryer vet.</p>	<p>2. The ordering party shall also have this right when the deadline is not an essential component of the contract if for reason of the delay the ordering party no longer has an interest in the contract being performed.</p> <p style="text-align: center;">Article 627 Entrustment of execution of transaction to third person</p> <p>1. Unless it follows otherwise from the contract or the nature of the transaction, the contractor shall not be obliged to perform the transaction in person.</p> <p>2. The contractor shall remain liable to the ordering party even if not performing the transaction in person.</p> <p style="text-align: center;">Article 628 Liability for associates</p> <p>The contractor shall be liable for persons that worked on the accepted transaction under the contractor's orders as if the contractor had done the work in person.</p>	<p>2. On to pravo ima i kad rok nije bitan element ugovora, ako zbog takvog zakašnjenja naručilac očigledno ne bi imao interesa za ispunjenje ugovora.</p> <p style="text-align: center;">Član 627 Poveravanje izvršenja posla trećem</p> <p>1. Ukoliko iz ugovora ili prirode posla ne proizlazi što drugo, poslenik nije dužan da posao obavi lično.</p> <p>2. Poslenik i dalje odgovara naručiocu za izvršenje posla i kad posao ne obavi lično.</p> <p style="text-align: center;">Član 628 Odgovornost za saradnike</p> <p>Poslenik odgovara za lica koja su po njegovom nalogu radila na poslu koji je preuzeo da izvrši, kao da ga je sam izvršio.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 629 Kërkesa e drejtpërdrejtë e bashkëpunëtorëve të kryerësit ndaj porositësit</p> <p>Për arkëtimin e kërkesave të veta nga kryerësi, bashkëpunëtorët e tij mund t'i drejtohen drejtpërdrejt porositësit dhe të kërkojnë prej tij që t'u paguajë këto kërkesa në ngarkim të shumës të cilën ai në këtë çast i ka borxh kryerësit, në qoftë se këto kërkesa janë pranuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 629 Direct claim on ordering party by contractor's associates</p> <p>The associates may turn directly to the ordering party for their claims towards the contractor and demand that the ordering party settle their claims from the sum owed at that moment to the contractor if they are acknowledged.</p>	<p style="text-align: center;">Član 629 Neposredan zahtev saradnika poslenika od naručioca</p> <p>Za naplatu svojih potraživanja od poslenika njegovi saradnici mogu se obratiti neposredno naručiocu i zahtevati od njega da im isplati ta potraživanja na teret svote koju u tom času duguje posleniku, ako su ta potraživanja priznata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 630 Dorëzimi i sendit të prodhuar porositësit</p> <p>1. Kryerësi ka për detyrë që sendin e prodhuar ose të riparuar t'ia dorëzojë porositësit.</p> <p>2. Kryerësi lirohet nga ky detyrim, në qoftë se sendi që e ka prodhuar ose riparuar shkatërrohet nga një shkak, për të cilin ai nuk përgjigjet.</p>	<p style="text-align: center;">Article 630 Delivery of manufactured thing to ordering party</p> <p>1. The contractor shall be obliged to deliver the manufactured or repaired thing to the ordering party.</p> <p>2. The contractor shall be released from this obligation if the thing that was manufactured or repaired was destroyed for a reason for which the contractor is not liable.</p>	<p style="text-align: center;">Član 630 Predaja izrađene stvari naručiocu</p> <p>1. Poslenik je dužan predati naručiocu izrađenu ili opravlјenu stvar.</p> <p>2. Poslenik se oslobađa ove obaveze ako stvar koju je izradio ili opravio propadne iz uzroka za koji on ne odgovara.</p>



KREU 5 PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT	CHAPTER 5 LIABILITY FOR DEFECTS	GLAVA 5 ODGOVORNOST ZA NEDOSTATKE
<p data-bbox="235 391 688 496">Neni 631 Kontrollimi i veprës së kryer dhe njoftimi i kryesit</p> <p data-bbox="186 537 737 716">1. Porositësi ka për detyrë ta kontrollojë veprën e kryer, nëse sipas rrjedhës së rregullt të të punës ky kontrollim është i mundur dhe për të metat e konstatuara pa shtyrje ta njoftojë kryerësin.</p> <p data-bbox="186 792 737 971">2. Në qoftë se porositësi nuk i përgjigjet ftesës së kryerësit që ta kontrollojë dhe pranojë veprën e kryer pa ndonjë shkak të arsyeshëm, konsiderohet se vepra është pranuar.</p> <p data-bbox="186 1011 737 1230">3. Pas kontrollit dhe pranimit të punës së kryer, kryerësi nuk përgjigjet më për të metat që kanë mund të vërehen me kontroll të zakonshme, përveç se ai ishte në dijeni për ato të meta dhe nuk e ka njoftuar porositësin.</p>	<p data-bbox="814 386 1255 492">Article 631 Inspection of executed work and notification of contractor</p> <p data-bbox="760 532 1312 743">1. The ordering party shall be obliged to inspect the executed work as soon as this is possible following the ordinary course of events and to notify the contractor without delay regarding any defects identified.</p> <p data-bbox="760 784 1312 963">2. If upon the contractor's request to inspect and accept the executed work the ordering party fails to do so without justifiable grounds the work shall be deemed to have been accepted.</p> <p data-bbox="760 1003 1312 1255">3. After the inspection and acceptance of the performed work the contractor shall no longer be liable for defects that could have been noticed during a customary inspection, unless the contractor knew of them and failed to show them to the ordering party.</p>	<p data-bbox="1413 386 1801 492">Član 631 Pregledanje izvršenog dela i obaveštavanje poslenika</p> <p data-bbox="1335 532 1887 719">1. Naručilac je dužan pregledati izvršeno delo, ako je prema redovnom toku stvari takav pregled moguć i o nađenim nedostacima bez odlaganja obavestiti poslenika.</p> <p data-bbox="1335 792 1887 971">2. Ako naručilac, bez opravdanog razloga, ne odgovori na poziv poslenika da pregleda i primi izvršeni rad bez kakvog opravdanog razloga, smatra se da je rad primljen.</p> <p data-bbox="1335 1011 1887 1230">3. Posle pregleda i primanja izvršenog rada poslenik više ne odgovara za nedostatke koji su se mogli opaziti običnim pregledom, izuzev ako je znao za takve nedostatke i nije obavestionaručioca.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 632 Të metat e fshehura</p> <p>1. Në qoftë se më vonë konstatohet ndonjë e metë e cila nuk ka mund të zbulohet me kontroll të zakonshëm, porositësi megjithatë mund të thirret në atë me kusht që për këtë ta njoftojë porositësin sa më parë, por jo më vonë se në afatin prej një muaji nga zbulimi i saj.</p> <p>2. Me kalimin e dy viteve nga pranimi i punës së kryer, porositësi nuk mundet më të thirret në të meta.</p>	<p style="text-align: center;">Article 632 Latent defects</p> <p>1. If any defect that could not have been noticed during a customary inspection later shows itself the ordering party may make reference thereto under the condition that the contractor is notified thereof as soon as possible, that is within a month of the defect being discovered.</p> <p>2. The ordering party may no longer make any reference to defects once two years have passed from the transaction being performed.</p>	<p style="text-align: center;">Član 632 Skriveni nedostaci</p> <p>1. Ako se docnije pokaže neki nedostatak koji se nije mogao otkriti običnim pregledom, naručilac se ipak može pozvati na njega, pod uslovom da o njemu obavesti poslenika što pre, ali ne kasnije nego u roku od mesec dana od njegovog otkrivanja.</p> <p>2. Istekom dve godine od prijema obavljenog posla, naručilac se više ne može pozvati na nedostatke.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 633 Shuarja e së drejtës</p> <p>1. Porositësi i cili e ka njoftuar kryerësin me kohë për të metat e veprës së kryer nuk mund të realizojë të drejtën e vet në rrugë gjyqësore pas kalimit të një viti nga njoftimi i bërë.</p> <p>2. Pas skadimit të këtij afati, porositësi mundet, në qoftë se për të metat e ka njoftuar në kohën e duhur kryerësin e punës, me kundërshtim kundër kërkesës së kryerësit për pagimin e shpërblimit, të theksojë të drejtën e vet për zbritjen e shpërblimit dhe shpërblimin e dëmit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 633 Expiry of right</p> <p>1. An ordering party that notified the contractor on time regarding defects in an executed transaction may no longer exercise rights in court proceedings one year after such notification.</p> <p>2. If the ordering party notified the contractor on time regarding defects, after such deadline passes the ordering party may exercise the right to a reduction in the payment and a reimbursement of the damage via an objection to the contractor's claim for payment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 633 Prestanak prava</p> <p>1. Naručilac koji je poslenika na vreme obavestio o nedostacima izvršenog posla ne može svoje pravo ostvariti sudskim putem po isteku godine dana od učinjenog obaveštenja.</p> <p>2. Po isteku tog roka naručilac može, ako je o nedostacima blagovremeno obavestio poslenika, prigovorom protiv poslenikovog zahteva za isplatu naknada istaći svoje pravo na sniženje naknada i na naknadu štete.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 634</p> <p style="text-align: center;">Rastet kur kryerësi humb të drejtën të thirret në nenet paraprake</p> <p>Kryerësi nuk mund të thirret në ndonjë dispozitë të neneve paraprake kur e meta ka të bëjë me faktet për të cilat ishte në dijeni ose nuk kanë mund t'i mbeten të panjohura, ndërsa për këto nuk e ka njoftuar porositësin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 635</p> <p style="text-align: center;">E drejta e kërkesës për mënjanimin e të metave</p> <p>1. Porositësi i cili e ka njoftuar me rregull kryerësin se puna e kryer ka ndonjë të metë, mund të kërkojë prej tij që të metën ta mënjanojë dhe për të t'ia caktojë afatin e arsyeshëm.</p> <p>2. Ai ka të drejtë edhe për shpërblimin e dëmit që pëson për këtë arsye.</p> <p>3. Në qoftë se mënjanimi i të metës kërkon shpenzime të tepruara, kryerësi mund të refuzojë ta kryejë, por me këtë rast porositësit i takon, sipas zgjedhjes së tij, e drejta e zbritjes së shpërblimit ose zgjidhjes së kontratës si edhe e drejta e shpërblimit të dëmit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 634</p> <p style="text-align: center;">When contractor does not have right to make reference to previous articles</p> <p>The contractor may not make any reference to any provision of the previous articles if the defect relates to facts that were known or could not have remained unknown thereto and the contractor failed to report them to the ordering party.</p> <p style="text-align: center;">Article 635</p> <p style="text-align: center;">Right to demand rectification of defects</p> <p>1. An ordering party that notified the contractor on time that the executed work had a defect may demand that the contractor rectify the defect and may stipulate an appropriate deadline thereof.</p> <p>2. The ordering party shall also have the right to the reimbursement of the damage incurred for this reason.</p> <p>3. If the rectification of the defect would require excessive costs the contractor may refuse to do the work, but in this case the ordering party may choose to reduce the payment or withdraw from the contract, and shall have the right to the reimbursement of damage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 634</p> <p style="text-align: center;">Kad poslenik gubi pravo da se pozove na prethodne članove</p> <p>Poslenik se ne može pozvati na neku odredbu prethodnih članova kad se nedostatak odnosi na činjenice koje su mu bile poznate, ili mu nisu mogle ostati nepoznate, a nije ih saopštio naručiocu.</p> <p style="text-align: center;">Član 635</p> <p style="text-align: center;">Pravo zahtevati uklanjanje nedostataka</p> <p>1. Naručilac koji je uredno obavestio poslenika da izvršeni rad ima neki nedostatak može zahtevati od njega da nedostatak ukloni i za to mu odrediti primeren rok.</p> <p>2. On ima pravo i na naknadu štete koju trpi zbog toga.</p> <p>3. Ako uklanjanje nedostatka zahteva preterane troškove, poslenik može odbiti da ga izvrši, ali u tom slučaju naručiocu pripada, po njegovom izboru, pravo na sniženje naknade ili raskid ugovora, kao i pravo na naknadu štete.</p>
--	--	--



Neni 636 Zgjidhja e kontratës në rastin e veçantë	Article 636 Special case of withdrawal from contract	Član 636 Raskidanje ugovora u posebnom slučaju
<p>Kur puna e kryer ka të metë të tillë sa që veprën e bën të papërdorshme ose është kryer në kundërshtim me kushtet shprehimore të kontratës, porositësi mundet, duke mos kërkuar mënjanimin paraprak të të metave, ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.</p>	<p>If the performed transaction has such a defect that the work is useless or if it was performed in breach of express contractual conditions the ordering party may withdraw from the contract and demand the reimbursement of damage without previously demanding the rectification of the defect.</p>	<p>Kad obavljene posao ima takav nedostatak koji ga čini neupotrebljivim ili je obavljen u suprotnosti sa izričitim uslovima ugovora, naručilac može, ne tražeći prethodno otklanjanje nedostatka, raskinuti ugovor i zahtevati naknadu štete.</p>
Neni 637 E drejta e porositësit në rastin e të metave të tjera të veprës së kryer	Article 637 Ordering party's right regarding other defects in executed transaction	Član 637 Pravo naručioca u slučaju drugih nedostataka izvršenog posla
<p>1. Kur puna e kryer ka të metë, por vepra është megjithatë e përdorshme, respektivisht kur puna nuk është kryer në kundërshtim me kushtet e parapara shprehimisht të kontratës, porositësi ka për detyrë ta lejojë kryerësin që ta mënjanoj të metën.</p> <p>2. Porositësi mund t'i caktojë kryerësit një afat të arsyeshëm për mënjanimin e të metave.</p> <p>3. Në qoftë se kryerësi nuk e mënjanon të metën deri te kalimi i këtij afati, porositësi mundet sipas zgjedhjes se tij ta kryejë mënjanimin në llogari të kryerësit ose ta</p>	<p>1. If the executed transaction has such a defect that the work would not be useless or if the transaction was not executed in breach of express contractual conditions the ordering party shall be obliged to allow the contractor to rectify the defect.</p> <p>2. The ordering party may stipulate an appropriate deadline for the contractor for the rectification of the defect.</p> <p>3. If the contractor fails to rectify the defect by this deadline the ordering party may choose to rectify the defect at the contractor's expense, to reduce the</p>	<p>1. Kad izvršeni posao ima nedostatak zbog koga delo nije neupotrebljivo, odnosno kad posao nije izvršen u suprotnosti sa izričitim uslovima ugovora, naručilac je dužan dopustiti posleniku da nedostatak otkloni.</p> <p>2. Naručilac može odrediti posleniku primeren rok za otklanjanje nedostatka.</p> <p>3. Ako poslenik ne otkloni nedostatak do isteka tog roka, naručilac može, po svom izboru, izvršiti otklanjanje nedostatka na račun poslenika, ili sniziti naknadu, ili</p>



<p>zbres shpërblimin ose ta zgjidhë kontratën.</p> <p>4. Kur është fjala për të metë të parëndësishme, porositësi nuk mund të shërbehet me të drejtën e zgjidhjes së kontratës.</p> <p>5. Në çdo rast ai ka të drejtë edhe për shpërblimin e dëmit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 638 Zbritja e shpërblimit</p> <p>Shpërblimi zbritet në përpjesëtim ndërmjet vlerës së punës së kryer pa të meta në kohën e lidhjes së kontratës dhe vlerës që do të kishte puna e kryer me të meta në atë kohë.</p> <p>KREU 6 DETYRIMET E POROSITËSIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 639 Detyrimi i pranimit të punës</p> <p>Porositësi ka për detyrë ta pranojë punën e kryer sipas dispozitave të kontratës dhe rregullave të punës.</p>	<p>payment or to withdraw from the contract.</p> <p>4. The ordering party may not withdraw from the contract over the matter of an insignificant defect.</p> <p>5. In any case the ordering party shall have the right to the reimbursement of damage.</p> <p style="text-align: center;">Article 638 Reduction of payment</p> <p>The payment shall be reduced in proportion to the value of the executed work without defects when the contract was concluded and the value that the executed work with the defect would then have had.</p> <p>CHAPTER 6 ORDERING PARTY'S OBLIGATIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 639 Obligation to accept work</p> <p>The ordering party shall be obliged to accept work executed according to the provisions of the contract and the rules of the transaction.</p>	<p>raskinuti ugovor.</p> <p>4. Kad se radi o neznatnom nedostatku, naručilac se ne može koristiti pravom na raskid ugovora.</p> <p>5. U svakom slučaju on ima pravo i na naknadu štete.</p> <p style="text-align: center;">Član 638 Sniženje naknade</p> <p>Sniženje naknade vrši se u razmeru između vrednosti izvršenog rada bez nedostatka u vreme zaključenja ugovora i vrednosti koju bi imao u to vreme izvršeni rad sa nedostatkom.</p> <p>GLAVA 6 OBAVEZE NARUČIOCA</p> <p style="text-align: center;">Član 639 Obaveza da primi rad</p> <p>Naručilac je dužan primiti rad izvršen prema odredbama ugovora i pravilima posla.</p>
---	---	---



Neni 640 Caktimi dhe pagimi i shpërblimit	Article 640 Stipulation and execution of payment	Član 640 Određivanje i isplata naknade
<p>1. Shpërblimi caktohet me kontratë, në qoftë se nuk është caktuar me ndonjë tarifë të detyrueshme ose me ndonjë akt tjetër të detyrueshëm.</p> <p>2. Në qoftë se shpërblimi nuk është caktuar, gjykata cakton shpërblimin sipas vlerës së punës, sipas kohës së nevojshme normalisht për punë të tillë dhe sipas shpërblimit të rëndomtë për këtë lloj të punës.</p> <p>3. Porositësi nuk ka për detyrë ta paguajë shpërblimin para se ta ketë kontrolluar dhe lejuar, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.</p> <p>4. E njëjta gjë vlen në qoftë se është kontraktuar kryerja dhe dorëzimi i punëve pjesë-pjesë.</p>	<p>1. The payment shall be stipulated by contract unless stipulated by a mandatory tariff or any other binding legal act.</p> <p>2. If the payment is not stipulated the court shall stipulate it such that it accords with the value of the work, the time customarily required for such a transaction and the customary payment for the type of work.</p> <p>3. The ordering party shall not be obliged to make the payment before inspecting and approving the executed work, unless agreed otherwise.</p> <p>4. This shall also apply if the execution and delivery of the work in parts was agreed.</p>	<p>1. Naknada se odreduje ugovorom, ako nije odredena obaveznom tarifom ili kojim drugim obaveznim aktom.</p> <p>2. Ako naknada nije odredena, utvrdiće je sud prema vrednosti rada, prema normalno potrebnom vremenu za takav posao, kao i prema uobičajenoj naknadi za tu vrstu rada.</p> <p>3. Naručilac nije dužan isplatiti naknadu pre nego što je pregledao izvršeni rad i odobrio ga, izuzev ako je drukčije ugovoreno.</p> <p>4. Isto važi ako je ugovoreno izvršenje i predaja rada u delovima.</p>
Neni 641 Llogaritja me garanci shprehimore	Article 641 Estimate with express guarantee	Član 641 Proračun sa izričitim jemstvom
<p>1. Në qoftë se shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes me garanci shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij, ai nuk mund të kërkojë shtimin e shpërblimit as edhe në qoftë se</p>	<p>1. If the payment was agreed on the basis of an estimate with the contractor's express guarantee as to its accuracy, the contractor may not demand a higher payment even if more work was invested</p>	<p>1. Ako je naknada ugovorena na osnovu proračuna sa izričitim jemstvom poslenika za njegovu tačnost, on ne može da zahteva povećanje naknade čak i ako je u posao uložio više rada i ako je izvršenje posla</p>



<p>në punim ka dhënë më tepër punë dhe në qoftë se kryerja e punës ka kërkuar më tepër shpenzime se sa është parashikuar.</p> <p>2. Me këtë nuk përjashtohet zbatimi i rregullave për zgjidhjen dhe ndryshimin e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave</p> <p>3. Në qoftë se shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes pa garanci shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij dhe gjatë punës tejkalimi i llogarisë tregohet i pashmangshëm, kryerësi duhet për këtë pa shtyrje ta njoftojë porositësin, përndryshe humb çdo kërkesë për shkak të shpenzimeve të shtuara.</p> <p>KREU 7 RREZIKU</p> <p>Neni 642 Kur kryerësi e ka dhënë materialin</p> <p>1. Në rast se kryerësi e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit, kurse sendi dëmtohet ose shkatërrohet për arsye të ndryshme para se t'i dorëzohet porositësit, rrezikun e mban kryerësi dhe nuk ka të drejtë shpërblimin për materialin</p>	<p>in the transaction and execution required higher expenditure than was anticipated.</p> <p>2. This shall not exclude the application of the rules on the rescission and amendment of the contract for reason of changed circumstances.</p> <p>3. If the payment was agreed on the basis of an estimate without the contractor's express guarantee as to its accuracy and during the work it is shown that overspending is unavoidable, the contractor must notify the ordering party of such without delay; otherwise the contractor shall lose any claim for higher costs.</p> <p>CHAPTER 7 RISK</p> <p>Article 642 If material was provided by contractor</p> <p>1. If the material for making a thing was provided by the contractor and the thing was damaged or destroyed for any reason prior to delivery to the ordering party this shall be a matter of the contractor's risk, and the contractor shall not have the right</p>	<p>zahtevalo veće troškove nego što je bilo predviđeno.</p> <p>2. Ovim se ne isključuje primena pravila o raskidanju i izmeni ugovora zbog promjenjenih okolnosti.</p> <p>3. Ako je naknada ugovorena na osnovu proračuna bez izričitog jemstva poslenika za njegovu tačnost, pa se u toku rada prekoračenje proračuna pokaže neizbežnim, poslenik mora o tome bez odlaganja obavestiti naručioca, inače gubi svako potraživanje zbog povećanih troškova.</p> <p>GLAVA 7 RIZIK</p> <p>Član 642 Kad je poslenik dao materijal</p> <p>1. U slučaju kad je poslenik dao materijal za izradu stvari a stvar bude oštećena ili propadne iz bilo kog uzroka pre predaje naručiocu, rizik snosi poslenik, te nema pravo na naknadu za dati materijal, kao ni na naknadu za svoj rad.</p>
---	--	---



<p>e dhënë e as për punën e tij.</p> <p>2. Në qoftë se porositësi e ka kontrolluar punimin e kryer dhe e ka lejuar, konsiderohet se sendi i është dorëzuar, ndërsa te kryerësi ka mbetur në ruajtje.</p> <p>3. Në qoftë se porositësi është vonuar për shkak të mospranimit të sendit të ofruar, rreziku i shkatërrimit ose i dëmtimit të rastësishëm të sendit kalon në atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 643 Kur porositësi e ka dhënë materialin</p> <p>1. Rrezikun e shkatërrimit ose dëmtimit të rastësishëm e bartë kryerësi, në qoftë se ai e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit.</p> <p>2. Në këtë rast, kryerësi ka të drejtë të shpërblimit vetëm në qoftë se sendi është shkatërruar ose dëmtuar pas rënies së porositësit në vonesë ose në qoftë se porositësi nuk i është përgjigjur ftesës të bërë me rregull për ta kontrolluar sendin.</p>	<p>to a refund for the material provided or to payment for the work.</p> <p>2. If the ordering party has inspected and approved the executed work the thing shall be deemed to have been delivered thereto and to have remained in safekeeping with the contractor.</p> <p>3. If the ordering party is in delay because of failure to accept the offered thing the risk of accidental destruction or damage shall be transferred to the ordering party.</p> <p style="text-align: center;">Article 643 If material was provided by ordering party</p> <p>1. If the material for making a thing was provided by the ordering party the ordering party shall assume the risk of its accidental destruction or damage.</p> <p>2. The contractor shall have the right to payment only if the thing was accidentally destroyed or damaged after the ordering party became delayed, or if the ordering party failed to respond to a correct invitation to inspect the thing.</p>	<p>2. Ako je naručilac pregledao izvršeni rad i odobrio ga, smatra se da mu je stvar predata, a da je kod poslenika ostala na čuvanju.</p> <p>3. Ako je naručilac pao u docnju zbog neprimanja ponuđene stvari, rizik slučajne propasti ili oštećenja stvari prelazi na njega.</p> <p style="text-align: center;">Član 643 Kad je naručilac dao materija</p> <p>1. Rizik slučajne propasti ili oštećenja stvari snosi naručilac ako je on dao materijal za izradu.</p> <p>2. U tom slučaju, poslenik ima pravo na naknadu samo ako je stvar propala ili bila oštećena posle dolaska naručioca u docnju, ili ako se naručilac nije odazvao njegovom urednom pozivu da stvar pregleda.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 644 Rreziku në rast të dorëzimit pjesë-pjesë</p> <p>Në qoftë se është kontraktuar se porositësi do ta bëjë kontrollin dhe pranimin e pjesëve të veçanta ashtu si do të prodhohen, kryerësi ka të drejtë shpërblimi për prodhimin e pjesëve që i ka kontrolluar dhe lejuar edhe në qoftë se ato pas tij do të shkatërroheshin tek ai pa fajin e tij.</p> <p>KREU 8 E DREJTA E PENGUT</p> <p style="text-align: center;">Neni 645 E drejta e pengut</p> <p>Për sigurimin e arkëtimit të kërkesave të shpërblimit për punën dhe shpërblimin e materialit të shpenzuar dhe kërkesave të tjera në bazë të kontratës për vepër, kryerësi ka të drejtë pengut në sendet që i ka prodhuar ose riparuar, si dhe në sende të tjera që i'a ka dorëzuar porositësi lidhur me punën e tij, gjithnjë gjersa ato i mban dhe nuk pushon me vullnet t'i mbajë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 644 Risk during delivery in parts</p> <p>If it is agreed that the ordering party will inspect and accept individual parts as they are made the contractor shall have the right to payment for making the parts the ordering party has inspected and approved, even if they were destroyed in the contractor's possession through no fault of the contractor.</p> <p>CHAPTER 8 LIEN</p> <p style="text-align: center;">Article 645 Contractor's lien</p> <p>In order to secure payment for the work, recompense for the material used and other claims deriving from a contract for work, the contractor shall have a lien on the things made or repaired and on other objects delivered thereto by the ordering party in connection with the work, as long as they are in the contractor's possession and the contractor does not relinquish them voluntarily.</p>	<p style="text-align: center;">Član 644 Rizik u slučaju predaje po delovima</p> <p>Ako je ugovoreno da će naručilac vršiti pregled i prijem pojedinih delova kako budu izrađeni, poslenik ima pravo na naknadu za izradu delova koje je naručilac pregledao i odobrio, čak i ako bi oni posle toga propali kod njega bez njegove krivice.</p> <p>GLAVA 8 PRAVO ZALOGE</p> <p style="text-align: center;">Član 645 Pravo zaloge</p> <p>Radi obezbeđenja naplate potraživanja naknade za rad i naknade za utrošeni materijal, kao i ostalih potraživanja po osnovu ugovora o delu, poslenik ima pravo zaloge na stvarima koje je napravio ili opravio, kao i na ostalim predmetima koje mu je predao naručilac u vezi sa njegovim radom, sve dok ih drži i ne prestane dragovoljno da ih drži.</p>
---	---	--



<p>KREU 9 SHUARJA E KONTRATËS</p> <p>Neni 646 Zgjidhja e kontratës me vullnetin e porositësit</p> <p>Derisa vepra e porositësit nuk është kryer, porositësi mund ta zgjidhë kontratën kur të dojë, por në atë rast ka për detyrë t'i paguajë kryerësit shpërblimin e kontraktuar, të zvogëluar për shumën e shpenzimeve që ky nuk i ka bërë e që do të kishte për detyrë t'i bënte po të mos zgjidhej kontrata si edhe për shumën e fitimit që e ka realizuar në anën tjetër ose që me qëllim e ka lëshuar ta realizojë.</p>	<p>CHAPTER 9 TERMINATION OF CONTRACT</p> <p>Article 646 Termination of contract by ordering party's wish</p> <p>Until the ordered transaction is completed the ordering party may withdraw from the contract whenever such party wishes; however in this event the ordering party must pay the agreed payment to the contractor, minus the costs not incurred by the contractor that would have been incurred had the contract not been rescinded, and also that which was earned elsewhere and that which the contractor had no intention of earning.</p>	<p>GLAVA 9 PRESTANAK UGOVORA</p> <p>Član 646 Raskid ugovora voljom naručioca</p> <p>Sve dok naručeni posao nije dovršen naručilac može raskinuti ugovor kad god hoće, ali je u tom slučaju dužan isplatiti posleniku ugovorenu naknadu, umanjenu za iznos troškova koje ovaj nije učinio, a koje bi bio dužan učiniti da ugovor nije raskinut, kao i za iznos zarade koju je ostvario na drugoj strani ili koju je namerno propustio da ostvari.</p>
--	--	--



PJESA XI KONTRATA PËR NDËRTIMIN	PART XI BUILDING CONTRACT	DEO XI UGOVOR O GRAĐENJU
KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	CHAPTER 1 GENERAL PROVISIONS	GLAVA 1 OPŠTE ODREDBE
Neni 647 Nocioni	Article 647 Definition	Član 647 Pojam
<p>1. Kontrata për ndërtim është kontratë me të cilën kryerësi detyrohet sipas projektit të caktuar të ndërtojë në afatin e caktuar ndërtesën e caktuar në tokën e caktuar, apo në një tokë të tillë respektivisht në objektin tashmë ekzistues të kryejë punë të tjera ndërtimi, ndërsa porositësi detyrohet që për këtë t'i paguajë çmimin e caktuar.</p> <p>2. Kontrata për ndërtimin duhet të jetë e lidhur me shkrim.</p>	<p>1. A building contract is a contract for work through which the contractor undertakes to build a specific structure on specific land according to a specific plan by a specific deadline or to carry out any other construction work on such land or on an existing structure, and the ordering party undertakes to pay the contractor a specific fee for the work.</p> <p>2. A building contract must be concluded in written form.</p>	<p>1. Ugovor o građenju je ugovor o delu kojim se izvođač obavezuje da prema određenom projektu sagradi u ugovorenom roku određenu građevinu na određenom zemljištu, ili da na takvom zemljištu, odnosno na već postojećem objektu izvrši kakve druge građevinske radove, a naručilac se obavezuje da mu za to isplati određenu cenu.</p> <p>2. Ugovor o građenju mora biti zaključen u pismenoj formi.</p>
Neni 648 Objektet ndërtimore	Article 648 Building	Član 648 Građevinski objekti
<p>Me fjalën "Objektet ndërtimore" në kuptim të kësaj pjese konsiderohen ndërtesat, digat, urat, ujësjellësi, kanalizimi, rrugët, vijat hekurudhore, tunelet, pusët dhe objekte të tjera ndërtimore, ndërtimi i të cilave kërkon</p>	<p>The term "building" in this part means buildings, dams, bridges, tunnels, water pipes, sewage ducts, roads, railways, wells and other built structures that require major and more complex work.</p>	<p>Pod pojmom „građevinski objekti“, u smislu ovog dela, podrazumevaju se zgrade, brane, mostovi, tuneli, vodovodi, kanalizacije, putevi, železničke pruge, bunari i ostali građevinski objekti čija</p>



<p>punë më të mëdha dhe më të ndërlikuara.</p> <p>Neni 649 Mbikëqyrja e punimeve dhe kontrolli i cilësisë së materialit</p> <p>Kryerësi i punës ka për detyrë t’ia bëjë të mundur porositësit mbikëqyrjen e vazhdueshme të punimeve dhe kontrollin e sasisë dhe cilësisë së materialit të përdorur.</p> <p>Neni 650 Shmangie nga projekti</p> <p>1. Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit respektivisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositësit.</p> <p>2. Ai nuk mund të kërkojë ngritje të çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë.</p> <p>Neni 651 Punimet urgjente të paparashikueshme</p> <p>1. Kryerësi mund t’i kryejë punimet e paparashikuara edhe pa pëlqimin paraprak të porositësit, në qoftë se për shkak të urgjencës së tyre nuk ka pasur mundësi ta marrë këtë pëlqim.</p>	<p>Article 649 Supervision of works and quality control of material</p> <p>The contractor shall be obliged to facilitate for the ordering party constant supervision of the works and control over the quality and quantity of the material used.</p> <p>Article 650 Deviation from plan</p> <p>1. The contractor must have written approval from the ordering party for any deviation from the construction plan or the contracted works.</p> <p>2. The contractor may not demand an increase to the agreed fee for works performed without such approval.</p> <p>Article 651 Urgent unforeseen works</p> <p>1. The contractor may also carry out urgent unforeseen works without the ordering party’s prior approval if this cannot be supplied because of the urgency of the works.</p>	<p>izrada zahteva veće i složenije radove.</p> <p>Član 649 Nadzor nad radovima i kontrola kvaliteta materijala</p> <p>Izvođač je dužan omogućiti naručiocu stalan nadzor nad radovima i kontrolu količine i kvaliteta upotrebljenog materijala.</p> <p>Član 650 Odstupanje od projekta</p> <p>1. Za svako odstupanje od projekta građenja, odnosno ugovorenih radova, izvođač mora imati pismenu saglasnost naručioca.</p> <p>2. On ne može zahtevati povećanje ugovorene cene za radove koje je izvršio bez takve saglasnosti.</p> <p>Član 651 Hitni nepredviđeni radovi</p> <p>1. Nepredviđene radove izvođač može izvesti i bez prethodne saglasnosti naručioca ako zbog njihove hitnosti nije bio u mogućnosti da pribavi tu saglasnost.</p>
---	--	--



<p>2. Punime të paparashikuara janë ato, ndërmarrja e të cilave ka qenë e domosdoshme për shkak të stabilitetit të objektit apo për parandalimin e shkaktimit të dëmit e që janë shkaktuar nga natyra e papritur më e rëndë e tokës me paraqitjen e papritur të ujit ose nga ndonjë ngjarje tjetër e jashtëzakonshme dhe e papritur.</p> <p>3. Kryerësi ka për detyrë që pa vonesë të njoftojë porositësin për këto fenomene dhe për masat e marra.</p> <p>4. Kryerësi ka të drejtë për shpërblim të drejtë për punimet e paparashikueshme që është dashur të kryhen.</p> <p>5. Porositësi mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se për shkak të këtyre punimeve, çmimi kontraktues do të duhej të shtohet konsiderueshëm për të cilën gjë ka për detyrë që pa shtyrje ta njoftojë kryerësin e punimeve.</p> <p>6. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit të punimeve pjesën përkatëse të çmimit për punimet e kryera, si edhe një shpërblim të drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra.</p>	<p>2. Unforeseen works are those that had to be performed urgently to ensure the stability of the structure or to prevent the occurrence of damage, and that were caused by the unexpectedly heavy nature of the land, unexpected water or any other extraordinary, unexpected development.</p> <p>3. The contractor must notify the ordering party without delay regarding such phenomena and the measures taken.</p> <p>4. The contractor shall have the right to fair payment for the unforeseen works it was necessary to perform.</p> <p>5. The ordering party may withdraw from the contract if the agreed fee would be considerably higher owing to such works; the ordering party must notify the contractor of such without delay.</p> <p>6. In the event of withdrawal from the contract the ordering party must pay the contractor an appropriate part of the fee for the work already performed, and a fair reimbursement of the necessary costs.</p>	<p>2. Nepredviđeni radovi su oni čije je preduzimanje bilo nužno zbog osiguranja stabilnosti objekta ili radi sprečavanja nastanka štete, a izazvani su neočekivanom težom prirodom zemljišta, neočekivanom pojavom vode ili drugim vanrednim i neočekivanim događajima.</p> <p>3. Izvođač je dužan bez odlaganja izvestiti naručioca o ovim pojavama i preduzetim merama.</p> <p>4. Izvođač ima pravo na pravičnu naknadu za nepredviđene radove koji su morali biti obavljeni.</p> <p>5. Naručilac može raskinuti ugovor ako bi usled ovih radova ugovorena cena morala biti znatno povećana, o čemu je dužan bez odlaganja obavestiti izvođača.</p> <p>6. U slučaju raskidanja ugovora, naručilac je dužan isplatiti izvođaču odgovarajući deo cene za već izvršene radove, kao i pravičnu naknadu za učinjene neophodne troškove.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;">Neni 652 Çmimi i punimeve</p> <p>Çmimi i punimeve mund të caktohet sipas njësisë së matjes së punimeve të kontraktura (çmimi i njësisë) ose në shumë të tërësishme për tërë objektin (çmimi total i kontraktuar).</p>	<p style="text-align: center;">Article 652 Fee for works</p> <p>The fee for works may be stipulated for a unit of measurement of agreed works (unit fee) or in a total sum for the entire structure (total agreed fee).</p>	<p style="text-align: center;">Član 652 Cena radova</p> <p>Cena radova se može odrediti po jedinici mere ugovorenih radova (jedinčna cena) ili u ukupnom iznosu za ceo objekat (ukupno ugovorena cena).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 653 Ndryshimi i çmimit</p> <p>1. Në qoftë së me kontratë lidhur me ndryshimin e çmimit nuk është parashikuar diçka tjetër, kryerësi që e ka kryer detyrimin e vet në afatin e parashikuar mund të kërkojë rritjen e çmimit të punimeve në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës e të përmbushjes së saj kanë ndryshuar çmimet e elementeve në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve, kështu që do të duhej që ky çmim të ishte më i madh për më shumë se dy për qind.</p> <p>2. Në rastin kur kryerësi i punimeve me faj të vet nuk i ka kryer punimet në afatin e parashikuar me kontratë, ai mund të kërkojë rritjen e çmimit të punimeve në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe ditës kur sipas kontratës është dashur të përfundoheshin punimet e elementeve në bazë të të cilave është</p>	<p style="text-align: center;">Article 653 Change in fee</p> <p>1. Unless stipulated otherwise in the contract regarding a change in the fee, a contractor that performs the obligation by the contractual deadline may demand a higher fee for the works if between the conclusion and the performance of the contract the price of elements on which the fee was based rises such that the fee should be more than two per cent higher.</p> <p>2. If the contractor fails to carry out the works by the contractual deadline for reasons for which the contractor is liable, the contractor may demand a higher fee for the works if between the conclusion of the contract and the day the works under contract were due to be completed the price of elements on which the fee was</p>	<p style="text-align: center;">Član 653 Izmena cene</p> <p>1. Ako ugovorom u pogledu izmene cene nije predviđeno što drugo, izvođač koji je svoju obavezu ispunio u predviđenom roku može zahtevati povećanje cene radova ako su se u vremenu između zaključenja ugovora i njegovog ispunjenja povećale cene elemenata na osnovu kojih je određena cena radova, tako da bi trebalo da ta cena bude veća za više od dva procenta.</p> <p>2. U slučaju da izvođač svojom krivicom nije izveo radove u roku predviđenom ugovorom, on može zahtevati povećanje cene radova ako su se u vremenu između zaključenja ugovora i dana kad je prema ugovoru trebalo da radovi budu završeni povećale cene elemenata na osnovu kojih je određena cena radova, tako da bi</p>



<p>caktuar, kështu që ky do të duhej sipas çmimeve të reja të këtyre elementeve të ishte më i madh për më se pesë për qind.</p> <p>3. Në rastet nga paragrafët e mësipërm, kryerësi mund të kërkojë vetëm diferencën në çmimin e punimeve që tejkalon dy përkatësisht pesë për qind.</p> <p>4. Kryerësi nuk mund të thirret në rritjen e çmimit të elementeve në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, në qoftë se deri te rritja e çmimit ka ardhur pas ardhjes së tij në vonesë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 654 Dispozitat për pandryshueshmërinë e çmimeve</p> <p>1. Në qoftë se është kontraktuar së çmimi i punimeve nuk do të ndryshojë, në rastin kur pas lidhjes së kontratës rriten çmimet e elementeve, në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, kryerësi mund të kërkojë megjithëse ekziston një dispozitë e tillë e kontratës, ndryshimin e çmimit të punimeve, në qoftë se çmimet e elementeve janë rritur në atë masë që çmimi i punimeve do të duhej të ishte më i madh se dhjetë për qind.</p> <p>2. Mirëpo, edhe në këtë rast kreyrsi mund</p>	<p>based rises such that under the new prices for such elements the fee should be more than five per cent higher.</p> <p>3. In the cases specified in the preceding paragraphs the contractor may request only the difference in price of works that exceeds two or five per cent.</p> <p>4. The contractor may not make reference to a higher price for elements on which the fee for the works was based if the prices rose after the contractor became delayed.</p> <p style="text-align: center;">Article 654 Provision on invariability of fee</p> <p>1. If it was agreed that the fee for the works would not be changed when the prices for elements on which the fee was based rise after the contract was concluded, the contractor may demand such a change despite such a contractual provision if the prices for elements rise such that the fee for the works should be more than ten per cent higher.</p> <p>2. However in this case the contractor</p>	<p>trebalo da ona, prema novim cenama tih elemenata, bude veća za više od pet procenata.</p> <p>3. U slučajevima iz prethodnih stavova izvođač može zahtevati samo razliku u ceni radova koja prelazi dva, odnosno pet procenata.</p> <p>4. Izvođač se ne može pozivati na povećanje cena elemenata na osnovu kojih je određena cena radova, ako je do povećanja cene došlo nakon njegovog dolaska u docnju.</p> <p style="text-align: center;">Član 654 Odredbe o nepromenljivosti cena</p> <p>1. Ako je ugovoreno da se cena radova neće menjati u slučaju da se posle zaključenja ugovora povećaju cene elemenata na osnovu kojih je ona određena, izvođač može, i pored ovakve odredbe ugovora, zahtevati izmenu cene radova ako su se cene elemenata povećale u tolikoj meri da bi trebalo da cena radova bude veća za više od deset procenata.</p> <p>2. Međutim, i u ovom slučaju izvođač</p>
--	---	--



<p>të kërkojë vetëm diferencën në çmimin që tejkalon dhjetë për qind, përveç nëse shtimi i çmimit të elementeve ka ardhur si pasojë e vonesës së tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 655 Zgjidhja e kontratës për shkak të rritjes së çmimit</p> <p>1. Në qoftë se në rastet nga nenet paraprahe çmimi kontraktues do të duhej të rritej konsiderueshëm, porositësi mund ta zgjidhë kontratën.</p> <p>2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit pjesën përkatëse të çmimit të kontraktuar për punimet e kryera gjer atëherë, si edhe shpërblimin e drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra.</p> <p style="text-align: center;">Neni 656 E drejta e porositësit për të kërkuar zbritjen e çmimit të kontraktuar</p> <p>1. Në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe përbushjes së detyrimit të kryerësit janë zbritur çmimet e elementeve në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve për më tepër se 2 për qind, kurse punimet janë kryer brenda afatit të kontraktuar, porositësi ka të drejtë të kërkojë zbritjen përkatëse të çmimit të</p>	<p>may only demand the shortfall in the fee for the works that exceeds ten per cent, unless the prices for such elements rose after the contractor became delayed.</p> <p style="text-align: center;">Article 655 Withdrawal from contract because of higher fee</p> <p>1. If in the cases specified in the previous articles the agreed fee would rise significantly the ordering party may withdraw from the contract.</p> <p>2. In the event of withdrawal from the contract the ordering party must pay the contractor an appropriate part of the agreed fee for the work performed to date, and a fair reimbursement for necessary costs.</p> <p style="text-align: center;">Article 656 Ordering party's right to demand reduction in agreed fee</p> <p>1. If in the time between the conclusion of the contract and the performance of the contractor's obligation the prices for elements on which the fee was based fell by more than two per cent and the work was performed by the agreed deadline the ordering party shall have the right to demand an appropriate reduction in the</p>	<p>može zahtevati samo razliku u ceni koja prelazi deset procenata, osim ako je do povećanja cene elemenata došlo posle njegovog dolaska u docnju.</p> <p style="text-align: center;">Član 655 Raskid ugovora zbog povećane cene</p> <p>1. Ako bi u slučajevima iz prethodnih članova ugovorena cena morala biti znatno povećana, naručilac može raskinuti ugovor.</p> <p>2. U slučaju raskida ugovora naručilac je dužan isplatiti izvođaču odgovarajući deo ugovorene cene za dotle izvršene radove, kao i pravičnu naknadu za učinjene neophodne troškove.</p> <p style="text-align: center;">Član 656 Pravo naručioca da traži sniženje ugovorene cene</p> <p>1. Ako su se u vreme između zaključenja ugovora i ispunjenja obaveze izvođača cene elemenata na osnovu kojih je određena cena radova snizile za više od dva procenta, a radovi su izvršeni u ugovorenom roku, naručilac ima pravo da traži odgovarajuće sniženje ugovorene cene radova iznad tog procenta.</p>
--	---	--



<p>kontraktuar të punimeve mbi këtë përqindje.</p> <p>2. Në qoftë se është kontraktuar pandryshueshmëria e çmimit të punimeve, ndërsa këto janë kryer në afat të kontraktuar, porositësi ka të drejtë për zbritje të kontraktuar në rastin kur çmimet e elementeve, në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, janë zbritur aq sa çmimi do të ishte më i vogël për më tepër se dhjetë për qind e pikërisht për diferencën në çmim prej më se dhjetë për qind.</p> <p>3. Në rastin e vonesës së kryesit të punimeve, porositësi ka të drejtë për zbritjen proporcionale të çmimit të punimeve për çdo zbritje të çmimit të elementeve, në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve.</p> <p>KREU 2 KONTRATA PËR NDËRTIMIN ME DISPOZITË TË VEÇANTË</p> <p>Neni 657 Kontrata për ndërtimin me dispozitë të veçantë</p> <p>1. Në qoftë se kontrata për ndërtimin përmban dispozitën "çelësi në dorë" ose</p>	<p>agreed fee for the works above such a percentage.</p> <p>2. If it was agreed that the fee for the works would not be changed and the work was performed by the agreed deadline the ordering party shall have the right to a reduction in the agreed fee when the prices for elements on which the fee was based fell such that the fee would be more than ten per cent lower, the reduction being for the difference above ten per cent.</p> <p>3. If the works contractor is in delay the ordering party shall have the right to a proportionate reduction in the fee for the works for each fall in the price of elements on which the fee was based.</p> <p>CHAPTER 2 BUILDING CONTRACT WITH SPECIAL PROVISION</p> <p>Article 657 Fee stipulated with turnkey clause</p> <p>1. If a building contract contains a turnkey provision or any similar provision the</p>	<p>2. Ako je ugovorena nepromenljivost cene radova, a oni su izvršeni u ugovorenom roku, naručilac ima pravo na sniženje ugovorene cene, u slučaju da su se cene elemenata na osnovu kojih je određena cena smanjile za toliko da bi cena bila niža za više od deset procenata, i to za razliku u ceni preko deset procenata.</p> <p>3. U slučaju docnje izvođača radova naručilac ima pravo na srazmerno sniženje cene radova za svako sniženje cene elemenata na osnovu kojih je cena radova određena.</p> <p>GLAVA 2 UGOVOR O GRAĐENJU SA POSEBNOM ODREDBOM</p> <p>Član 657 Ugovor o građenju sa posebnom odredbom</p> <p>1. Ako ugovor o građenju sadrži odredbu "ključ u ruke" ili neku drugu sličnu</p>
--	---	---



<p>ndonjë dispozitë tjetër të ngjashme, kryerësi detyrohet në mënyrë të pavarur që të kryejë së bashku të gjitha punimet e nevojshme për ndërtimin dhe përdorimin e objektit të caktuar të tërësishëm.</p> <p>2. Në këtë rast çmimi i kontraktuar përfshin edhe vlerën e të gjitha punimeve të paparashikuara e të tepricës së punimeve, ndërsa përjashton ndikimin e mungesave të punimeve në çmimin e kontraktuar.</p> <p>3. Në qoftë se në kontratën "çelësi në dorë" marrin pjesë disa kryerës si palë kontraktuese, përgjegjësia e tyre ndaj porositesit është solidare.</p> <p>KREU 3 PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT</p> <p>Neni 658 Zbatimi i rregullave të kontratës për veprën</p> <p>Në qoftë se në këtë pjesë nuk është caktuar ndryshe, për përgjegjësinë për të metat e godinës zbatohen dispozitat përkatëse të kontratës për veprën.</p>	<p>contractor independently undertakes to carry out all the works required for the construction and use of a specific structure.</p> <p>2. In this case the agreed fee shall also cover the value of unforeseen and excess works, and shall exclude the influence of missing works thereon.</p> <p>3. If several contractors participate as contracting parties in a turnkey contract their liability towards the ordering party shall be joint and several.</p> <p>CHAPTER 3 LIABILITY FOR DEFECTS</p> <p>Article 658 Application of rules on contract for work</p> <p>Unless stipulated otherwise in this part, the corresponding rules covering the contract for works shall apply to liability for defects in a building.</p>	<p>odredbu izvođač se samostalno obavezuje da izvrši skupa sve radove potrebne za izgradnju i upotrebu određenog celovitog objekta.</p> <p>2. U tom slučaju ugovorena cena obuhvata i vrednost svih nepredviđenih radova i viškova radova, a isključuje uticaj nedostataka radova na ugovorenu cenu.</p> <p>3. Ako u ugovoru "ključ u ruke" učestvuje kao ugovorna strana više izvođača, njihova odgovornost prema naručiocu je solidarna.</p> <p>GLAVA 3 ODGOVORNOST ZA NEDOSTATKE</p> <p>Član 658 Primena pravila ugovora o delu</p> <p>Ukoliko u ovom delu nije drukčije određeno, za odgovornost za nedostatke građevine primenjuju se odgovarajuće odredbe ugovora o delu.</p>
--	---	---



<p>Neni 659 Kalimi i të drejtave nga përgjegjësia për të metat</p>	<p>Article 659 Transfer of rights from liability for defects</p>	<p>Član 659 Prelazak prava iz odgovornosti za nedostatke</p>
<p>Të drejtat e porositësit ndaj kryerësit për shkak të të metave të godinës kalojnë edhe në të gjithë fituesit e mëvonshëm të godinës ose të pjesës së saj, por fitueseve të mëvonshëm nuk u rrjedh afati i ri për njoftim dhe padi, por u llogaritet afati i paraardhësve.</p>	<p>The ordering party's rights against the contractor for reason of defects in a structure shall also be transferred to all subsequent acquirers of the structure or parts thereof, although such that a new period for notification and suit shall not run for subsequent acquirers; the predecessors' period shall count towards theirs.</p>	<p>Prava naručioca prema izvođaču zbog nedostatka građevine prelaze i na sve docnije dobitnike građevine ili njenog dela ali s tim da docnijim dobitnicima ne teče novi rok za obaveštenje i tužbu, već im se uračunava rok prethodnika.</p>
<p>KREU 4 PËRGJEGJËSIA E KRYERËSIT DHE E PROJEKTUESIT PËR SOLIDITETIN E GODINËS</p>	<p>CHAPTER 4 LIABILITY OF CONTRACTOR AND DESIGNER FOR SOLIDITY OF STRUCTURE</p>	<p>GLAVA 4 ODGOVORNOST IZVOĐAČA I PROJEKTANTA ZA SOLIDNOST GRAĐEVINE</p>
<p>Neni 660 Nga çka përbëhet</p>	<p>Article 660 Where liability lies</p>	<p>Član 660 U čemu se sastoji</p>
<p>1. Kryerësi përgjigjet për të metat e ndërtimit të godinës që i përkasin soliditetit të saj, në qoftë se këto të meta do të paraqitëshin për një kohë prej 10 vjetësh nga dorëzimi dhe pranimi i punimeve.</p> <p>2. Kryerësi përgjigjet edhe për të metat e tokës në të cilën është ngritur godina, të</p>	<p>1. The contractor shall be liable for any defects in the execution of the structure concerning its solidity if such defects show themselves within ten years of the delivery and takeover of works.</p> <p>2. The contractor shall also be liable for any deficiencies in the land on which the</p>	<p>1. Izvođač odgovara za nedostatke u izradi građevine koji se tiču njene solidnosti, ukoliko bi se ti nedostaci pokazali za vreme od deset godina od predaje i prijema radova.</p> <p>2. Izvođač odgovara i za nedostatke zemljišta na kome je podignuta građevina,</p>



<p>cilat do të tregoheshin për një kohë prej dhjetë vjetësh nga dorëzimi dhe pranimi i punimeve, përveç nëse organizata e specializuar e ka dhënë mendimin profesional se toka është e përshtatshme për ndërtim, kurse gjatë ndërtimit nuk janë paraqitur rrethana që e vëjnë në dyshim bazueshmërinë e mendimit profesional.</p> <p>3. E njëjta gjë vlen edhe për projektuesin në qoftë se e meta e godinës rrjedh nga ndonjë e metë në plan.</p> <p>4. Ata janë përgjegjës sipas paragrafëve të mësipërm jo vetëm ndaj porositësit por edhe çdo fituesi tjetër të godinës.</p> <p>5. Kjo përgjegjësi e tyre nuk mund të përjashtohet e as të kufizohet me kontratë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 661 Detyra e njoftimit dhe humbja e të drejtave</p> <p>1. Porositësi ose fituesi tjetër ka për detyrë që për të metat ta njoftojë kryerësin dhe projektuesin e punimeve në afat prej gjashtë muajsh, prej kur e ka konstatuar të metën, përndryshe humb të drejtën që të thirret në te.</p>	<p>structure is built that show themselves within ten years of the delivery and takeover of works, unless a specialist organisation gave an expert opinion that the land was suitable for construction and during construction no circumstances arose to awaken any doubt over the justification of the expert opinion.</p> <p>3. This shall also apply to the designer, if the defect in the structure originates from any defect in the plan.</p> <p>4. Under the provisions of the previous paragraphs the two shall be liable not only to the ordering party, but also to any other acquirer of the structure.</p> <p>5. It shall not be possible to exclude or limit their liabilities by contract.</p> <p style="text-align: center;">Article 661 Obligation to notify and loss of right</p> <p>1. The ordering party or other acquirer shall be obliged to notify the contractor and designer regarding defects within six months of discovering the defect; otherwise the ordering party or acquirer shall lose the right to make reference thereto.</p>	<p>koji bi se pokazali za vreme od deset godina od predaje i prijema radova, osim ako je specijalizovana organizacija dala stručno mišljenje da je zemljište podobno za građenje, a u toku građenja se nisu pojavile okolnosti koje dovode u sumnju osnovanost stručnog mišljenja.</p> <p>3. Isto važi i za projektanta ako nedostatak građevine potiče od nekog nedostatka u planu.</p> <p>4. Oni su odgovorni prema odredbama prethodnih stavova ne samo naručiocu, nego i svakom drugom kasnijem sticaocu građevine.</p> <p>5. Ova njihova odgovornost ne može se ugovorom ni isključiti ni ograničiti.</p> <p style="text-align: center;">Član 661 Dužnost obaveštavanja i gubitak prava</p> <p>1. Naručilac ili drugi dobitnik dužan je o nedostacima obavestiti izvođača i projektanta u roku od šest meseci od kad je nedostatak ustanovio, inače gubi pravo da se pozove na njega.</p>
---	--	--



<p>2. E drejta e porositësit ose e fituesit tjetër ndaj kryerësit respektivisht ndaj projektuesit sipas bazës së përgjegjësisë së tyre për të metat shuhet brenda një viti duke llogaritur nga dita kur porositësi respektivisht fituesi e ka njoftuar projektuesin, përkatësisht kryerësin e punimeve për të metën.</p> <p>3. Kryerësi i punimeve apo projektuesi nuk mund të referohet në dispozitat e paragrafëve të mësipërm nëse defekti ka të bëjë me faktet që kanë qenë të njohura apo nuk kanë mundur të ngelin të panjohura dhe se kanë dështuar të njoftojnë porositësin, respektivisht fituesin tjetër, ose përmes veprimit të tyre ata e kanë keqinformuar porositësin, respektivisht fituesin, në atë mënyrë që ta bëjnë atë të mos ketë mundësi ta shfrytëzojnë këtë të drejtë me kohë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 662 Zvogëlimi dhe përjashtimi i përgjegjësisë</p> <p>1. Kryerësi nuk lirohet nga përgjegjësia në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak se gjatë kryerjes së punimeve të caktuara ka vepruar sipas kërkesave të porositësit.</p> <p>2. Në qoftë se para kryerjes së punës së</p>	<p>2. The right of the ordering party or other acquirer against the contractor or designer deriving from their liability for defects shall expire one year after the day the contractor or designer was notified regarding the defect.</p> <p>3. The contractor or designer may not make reference to the provisions of the previous paragraphs if the defect relates to facts that were known or could not have remained unknown thereto and that they failed report to the ordering party or other acquirer, or if through their action they misled the ordering party or other acquirer into failing to exercise the rights on time.</p> <p style="text-align: center;">Article 662 Reduction and exclusion of liability</p> <p>1. The contractor shall not be released from liability if the defect occurred because during the execution of individual works the contractor acted according to the ordering party's requirements.</p> <p>2. However if prior to the execution of</p>	<p>2. Pravo naručioca ili drugog dobitnika prema izvođaču, odnosno projektantu po osnovu njihove odgovornosti za nedostatke prestaje za godinu dana računajući od dana kad je naručilac, odnosno dobitnik obavestio projektanta, odnosno izvođača o nedostatku.</p> <p>3. Izvođač ili projektant se ne može pozivati na odredbe prethodnih stavova ako se nedostatak odnosi na činjenice koje su bile poznate ili nisu mogle ostati nepoznate i o tome nisu obavestili naručioca, odnosno kasnijeg dobitnika, ili su svojom radnjom pogrešno informisali naručioca, odnosno kasnijeg dobitnika, na način da oni nisu imali mogućnosti na vreme iskoristiti to pravo na vreme.</p> <p style="text-align: center;">Član 662 Smanjenje i isključenje odgovornosti</p> <p>1. Izvođač se ne oslobađa odgovornosti ako je šteta nastala zbog toga što je pri izvođenju određenih radova postupao po zahtevima naručioca.</p> <p>2. Ako je pre izvršenja određenog rada po</p>
--	---	---



<p>caktuar sipas kërkesës së porositësit ia ka tërhequr vërejtjen për rrezikun nga dëmi, përgjegjësia e tij zvogëlohet dhe sipas rrethanave të rastit konkret, mundet edhe të përjashtohet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 663 Regresi</p> <p>1. Kur për dëmin janë përgjegjës kryerësi dhe projektuesi, përgjegjësia e secilit prej tyre caktohet sipas madhësisë së fajit të tij.</p> <p>2. Projektuesi që e ka hartuar projektin e godinës dhe të cilit i është besuar mbikëqyrja e kryerjes së punimeve të planifikuara përgjigjet edhe për të metat në punimet e bëra të shkaktuara me faj të kryerësit të punimeve, në qoftë se ka mundur t'i vinte re me mbikëqyrjen normale dhe të arsyeshme të punimeve, por ka të drejtë të kërkojë nga kryerësi i punimeve shpërblimin përkatës.</p> <p>3. Kryerësi i punimeve që e ka shpërblyer dëmin e shkaktuar për shkak të të metave në punimet e kryera ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga projektuesi në masën në të cilën të metat në punimet e kryera</p>	<p>individual work according to the ordering party's requirements the contractor warned the former regarding the risk of defects occurring the contractor's liability shall be reduced, and may also be excluded under the circumstances of the case in question.</p> <p style="text-align: center;">Article 663 Recourse</p> <p>1. If in the relationship with the ordering party the contractor and designer are liable for a defect their liability shall be joint and several.</p> <p>2. A designer that formulated the plan for the structure and that was entrusted with supervising the execution of the works shall also be liable for defects in the executed works that occurred because of reasons for which the contractor is liable if they could be noticed during customary and appropriate supervision of the works, but shall have the right to demand appropriate reimbursement from the contractor.</p> <p>3. A contractor that reimbursed damage inflicted because of a defect in the executed works shall have the right to demand reimbursement from the designer in the extent to which the defects in the</p>	<p>zahtevu naruçioca upozorio ovog na opasnost od štete, njegova odgovornost se smanjuje, a prema okolnostima konkretnog slučaja može se i isključiti.</p> <p style="text-align: center;">Član 663 Regresi</p> <p>1. Kad su za štetu odgovorni izvođač i projektant, odgovornost svakog od njih određuje se prema veličini njegove krivice.</p> <p>2. Projektant koji je izradio projekat građevine i kome je poveren nadzor nad izvršenjem planiranih radova odgovara i za nedostatke u izvršenim radovima nastale krivicom izvođača ako ih je mogao opaziti normalnim i razumnim nadgledanjem radova, ali ima pravo zahtevati od izvođača odgovarajuću naknadu.</p> <p>3. Izvođač koji je naknadio štetu nastalu usled nedostataka u izvršenim radovima ima pravo zahtevati naknadu od projektanta u meri u kojoj nedostaci u izvršenim radovima potiču od nedostataka</p>
---	--	---



<p>rrjedhin prej të metave në projekt.</p> <p>4. Nëse për të metën është përgjegjës një person, të cilit kryerësi i'a ka besuar kryerjen e një pjese të punës, atëherë kryerësi duhet – nëse dëshiron shpërblim prej atij personi - të njoftojë për ekzistimin e të metës në afat prej 2 muajsh, duke e llogaritur nga dita kur ai vet ka qenë i njoftuar nga porositësi për të njëjtën të metë.</p> <p>PJESA XII KONTRATA PËR TRANSPORTIN</p> <p>KREU 1 DISPOZITA PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 664 Nocioni</p> <p>1. Me kontratën për transportin detyrohet transportuesi që të transportojë në vendin e caktuar ndonjë person ose send, ndërsa udhëtari, respektivisht dërguesi detyrohet që për këtë t'i paguajë shpërblimin e caktuar.</p>	<p>executed works originate from defects in the plan.</p> <p>4. If a person entrusted with part of the transaction by the contractor is liable for a defect the contractor must, if intending to demand reimbursement therefrom, notify such person regarding the defect within two months of being notified by the ordering party.</p> <p>PART XII CONTRACT OF CARRIAGE</p> <p>CHAPTER 1 GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 664 Definition</p> <p>1. Through a contract of carriage a carrier undertakes to transport a person or a thing to a specific place, and the passenger or sender undertakes to make a specific payment thereto for this.</p>	<p>u projekt.</p> <p>4. Kad je za nedostatak odgovorno lice kome je izvođač poverio obavljanje jednog dela posla, izvođač - ako hoće da od njega zahteva naknadu - mora da ga obavesti o postojanju nedostatka u roku od 2 meseca, računajući od dana kad je on sam obavešten od naručioca o istom nedostatku.</p> <p>DEO XII UGOVOR O PREVOZU</p> <p>GLAVA 1 OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 664 Pojam</p> <p>1. Ugovorom o prevozu obavezuje se prevozilac da preveze na određeno mesto neko lice ili neku stvar, a putnik, odnosno pošiljalac se obavezuje da mu za to isplati određenu naknadu.</p>
---	---	--



<p>2. Transportuesi sipas këtij ligji konsiderohet si personi i cili merret me transport si punë të rregullt të tij, ashtu edhe çdo person tjetër i cili detyrohet me kontratë të kryejë transportin me shpërblim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 665 Detyrimet e transportuesit në transportin liniar</p> <p>1. Transportuesi i cili kryen transportin në një linjë të caktuar (transporti liniar) ka për detyrë që rregullisht dhe në gjendje të rregullt të mbajë linjën e shpallur.</p> <p>2. Ai ka për detyrë të pranojë për transport çdo person dhe çdo send që përmbushin kushtet e caktuara me kushtet e përgjithshme të shpallura.</p> <p>3. Në qoftë se mjetet e rregullta të transportit të transportuesit nuk mjaftojnë për kryerjen e të gjitha transporteve të kërkuara, përparësi kanë personat ose sendet për të cilat kjo është parashikuar me dispozita të veçanta, ndërsa përparësia e mëtejshme caktohet sipas radhës së kërkesave, por midis kërkesave të njëkohshme përparësia caktohet sipas gjatësisë më të madhe të transportit.</p>	<p>2. In terms of the present Law the carrier shall mean both a person dealing with carriage as his regular business activity, and any other person assuming an obligation by contract to perform carriage for remuneration.</p> <p style="text-align: center;">Article 665 Carrier's obligations in route transport</p> <p>1. A carrier that performs transport on a specific route (route transport) shall be obliged to regularly and correctly maintain the published route.</p> <p>2. A carrier shall be obliged to accept for transport any person and any thing that fulfils the conditions stipulated in the published general terms and conditions.</p> <p>3. If the carrier's ordinary means of transport do not suffice for all the required transport priority shall be given to persons and things for which priority is stipulated in special regulations, and further priority shall be stipulated in the order of the requests; in so doing the longer transport shall be decisive in ascribing priority to requests made simultaneously.</p>	<p>2. Kao prevoznik, u smislu ovog zakona, smatra se kako lice koje se bavi prevozom kao svojim redovnim poslovanjem, tako i svako drugo lice koje se ugovorom obaveže da izvrši prevoz uz naknadu.</p> <p style="text-align: center;">Član 665 Obaveze prevoznika u linijskom prevozu</p> <p>1. Prevoznik koji obavlja prevoz na određenoj liniji (linijski prevoz) dužan je da redovno i uredno održava objavljenu liniju.</p> <p>2. On je dužan da primi na prevoz svako lice i svaku stvar koji ispunjavaju uslove određene u objavljenim opštim uslovima.</p> <p>3. Ako redovna prevozna sredstva prevoznika nisu dovoljna za izvršenje svih zahtevanih prevoza, prvenstvo imaju lica ili stvari za koje je to posebnim propisima predviđeno, a dalje prvenstvo se određuje prema redu zahteva, s tim da se između istovremenih zahteva prvenstvo određuje prema većoj dužini prevoza.</p>
---	---	---



<p style="text-align: center;">Neni 666 Denoncimi i kontratës</p> <p>1. Dërguesi, respektivisht udhëtari mund të denoncojë kontratën para se të fillojë përmbushja e saj, por ka për detyrë ta shpërblejë dëmin të cilin transportuesi do ta pësonte për këtë shkak.</p> <p>2. Kur transportuesi vonon me fillimin e transportit aq sa pala tjetër nuk ka më interes për transportin e kontraktuar, ose kur transportuesi nuk mund ose nuk don të kryejë transportin e kontraktuar, pala tjetër mund të denoncoj nga kontrata dhe të kërkojë kthimin e shpërblimit të paguar për transportin.</p>	<p style="text-align: center;">Article 666 Withdrawal from contract</p> <p>1. The sender or passenger may withdraw from the contract before it begins to be performed, and must reimburse the damage incurred for this reason by the carrier.</p> <p>2. If at the beginning of transport the carrier is so delayed that the agreed transport no longer has any meaning for the other party or if the carrier cannot or does not wish to perform the agreed transport the other party may withdraw from the contract and demand the return of that which was paid for the transport.</p>	<p style="text-align: center;">Član 666 Odustanak od ugovora</p> <p>1. Pošiljalac, odnosno putnik može odustati od ugovora pre nego što počne njegovu izvršenje, ali je dužan naknaditi štetu koju bi prevozilac pretrpeo usled toga.</p> <p>2. Kad prevozilac kasni sa započinjanjem prevoza, toliko da druga strana više nema interesa za ugovoreni prevoz, ili kad prevozilac neće ili ne može da izvrši ugovoreni prevoz, druga strana može odustati od ugovora i tražiti da se vrati plaćena naknada za prevoz.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 667 Shuma e shpërblimit për transport</p> <p>1. Në qofte se shuma e shpërblimit për transport është caktuar me tarifë ose me ndonjë akt tjetër detyruet të shpallur, nuk mund të kontraktohet shpërblimi më i madh.</p> <p>2. Në qoftë se shuma e shpërblimit për transport nuk është caktuar me tarifë ose me ndonjë akt detyruet tjetër të shpallur e as me kontratë, transportuesi ka të drejtë për shpërblim të zakonshëm për këtë lloj transporti.</p>	<p style="text-align: center;">Article 667 Size of payment for transport</p> <p>1. If the size of the payment for transport is stipulated by a tariff or any other published binding legal act, a higher payment may not be pronounced by the contract.</p> <p>2. If the size of the payment for transport is not stipulated by a tariff, any other published binding legal act or by the contract the carrier shall have the right to the customary payment for the type of transport.</p>	<p style="text-align: center;">Član 667 Visina naknade za prevoz</p> <p>1. Ako je visina naknade za prevoz određena tarifom ili kojim drugim objavljenim obaveznim aktom ne može se ugovoriti veća naknada.</p> <p>2. Ako iznos naknade za prevoz nije određen tarifom ili kojim drugim objavljenim obaveznim aktom, a ni ugovorom, prevozilac ima pravo na uobičajenu naknadu za tu vrstu prevoza.</p>



<p>3. Në pjesën tjetër në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për shpërblimin të përmbajtura në pjesën e këtij ligji për kontratën për veprën.</p> <p style="text-align: center;">Neni 668 Kufizimi i zbatimit të dispozitave të kësaj pjese</p> <p>Dispozitat e kësaj pjese zbatohen në të gjitha llojet e transportit, në qoftë se me ligj për lloje të veçanta nuk është caktuar ndryshe.</p> <p>KREU 2 KONTRATA PËR TRANSPORTIN E SENDEVE</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 1</u> <u>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 669 Dorëzimi i sendeve</p> <p>Transportuesi ka për detyrë që sendin të cilin e ka pranuar për transport t'ia dorëzojë në vendin e caktuar dërguesit ose personit të caktuar (marrësit).</p>	<p>3. The sense of the provisions on payment in the part of the present Law on the contract for work shall apply to other matters.</p> <p style="text-align: center;">Article 668 Limitation of application of provision of this part</p> <p>The provisions of this part shall apply to all types of transport, unless stipulated otherwise by law for individual types of transport.</p> <p>CHAPTER 2 CONTRACT ON CARRIAGE OF FREIGHT</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 1</u> <u>GENERAL PROVISIONS</u></p> <p style="text-align: center;">Article 669 Delivery of thing</p> <p>The carrier shall be obliged to deliver the thing accepted for transport to the sender or a specific person (the recipient) in a specific place.</p>	<p>3. U ostalom, shodno se primenjuju odredbe o naknadi sadržane u delu ovog zakona o ugovoru o delu.</p> <p style="text-align: center;">Član 668 Ograničenje primene odredbi ovog dela</p> <p>Odredbe ove delu primenjuju se na sve vrste prevoza, ako zakonom za pojedine vrste nije drukčije određeno.</p> <p>GLAVA 2 UGOVOR O PREVOZU STVARI</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 1</u> <u>OPŠTE ODREDBE</u></p> <p style="text-align: center;">Član 669 Predaja stvari</p> <p>Prevozilac je dužan da stvar koju je primio u cilju prevoza preda na određenom mestu pošiljaocu ili određenom licu (primaocu).</p>
--	--	--



Neni 670 Detyrat e dërguesit për ta njoftuar transportuesin	Article 670 Regarding what sender must notify carrier	Član 670 Obaveza pošiljaoca da obavesti prevozioca
<p>1. Dërguesi ka për detyrë ta njoftojë transportuesin për llojin e dërgesës dhe për përmbajtjen dhe sasinë e saj dhe t'i komunikojë se ku duhet të transportohet dërgesa, emrin dhe adresën e marrësit të dërgesës, emrin dhe adresën e vet, si dhe çdo gjë të nevojshme që transportuesi të mund t'i përmbushë detyrimet e veta pa shtyrje dhe pengesa.</p> <p>2. Kur në dërgesë ndodhen sende të çmueshme, letra me vlerë ose sende tjera të shtrenjta, dërguesi ka për detyrë që për këtë ta njoftojë transportuesin në momentin e dorëzimit të tyre për transport dhe t'ia komunikojë vlerën e tyre.</p> <p>3. Kur është fjala për transportin e sendeve të rrezikshme ose të sendeve për të cilat nevojiten kushte të veçanta të transportit, dërguesi ka për detyrë që për këtë ta njoftojë transportuesin me kohë, kështu që ai do të mund të ndërmerre masa përkatëse të veçanta.</p> <p>4. Në qoftë se dërguesi nuk i jep transportuesit të dhënat nga paragrafi 1 dhe 3 të këtij neni, ose i jep gabimisht përgjigjet për dëmin që do të shkaktohej</p>	<p>1. The sender must notify the carrier regarding the type of consignment and the contents and quantity thereof, and must report where the consignment is to be transported, the name and address of the recipient, the name and address of the sender and everything else necessary for the carrier to be able to perform the obligation without delay or obstacles.</p> <p>2. If the consignment contains valuables, securities or other expensive things the sender must notify the carrier of such when handing it over for transport and must report the value thereto.</p> <p>3. If it is a matter of the transport of a dangerous thing or a thing that requires special conditions of transport the sender must notify the carrier of such on time so that the carrier is able to take appropriate measures.</p> <p>4. A sender that fails to provide the carrier with the information specified in the first and third paragraphs of this article or provides erroneous information shall be</p>	<p>1. Pošiljalac je dužan obavestiti prevozioca o vrsti pošiljke i o njenj sadržini i količini, i saopštiti mu kuda pošiljka treba da bude prevezena, ime i adresu primaoca pošiljke, svoje ime i svoju adresu, kao i sve drugo što je potrebno da bi prevozilac mogao ispuniti svoje obaveze bez odlaganja i smetnji.</p> <p>2. Kad se u pošiljci nalaze dragocenosti, hartije od vrednosti ili druge skupocene stvari, pošiljalac je dužan obavestiti o tome prevozioca u času njihove predaje na prevoz i saopštiti mu njihovu vrednost.</p> <p>3. Kad se radi o prevozu opasne stvari ili stvari za koju su potrebni posebni uslovi prevoza, pošiljalac je dužan da o tome obavesti prevozioca na vreme tako da bi on mogao preduzeti odgovarajuće posebne mere.</p> <p>4. Ako pošiljalac prevoziocu ne dostavi podatke iz stava 1 i 3 ovog člana ili mu ih da pogrešno, odgovara za štetu koja bi usled toga nastala.</p>



<p>për shkak të kësaj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 671 Fletëngarkesa</p> <p>1. Kontraktuesit mund të merren vesh që për dërgesën e dorëzuar për transport të përpilohet fletëngarkesa.</p> <p>2. Fletëngarkesa duhet të përmbajë emrin dhe adresën e dërguesit e të transportuesit, llojin, përmbajtjen dhe sasinë e dërgesës, si dhe vlerën e sendeve të çmueshme dhe sendeve të tjera të shtrenjta, vendin e destinimit, shumën e shpërblimit për transport, respektivisht shënimin se shpërblimi është parapaguar, dispozitën për shumën me të cilën është ngarkuar dërgesa, vendi dhe dita e lëshimit të fletëngarkesës.</p> <p>3. Në fletëngarkesë mund të futen edhe dispozita të tjera të kontratës për transportin.</p> <p>4. Fletëngarkesa duhet të jetë e nënshkruar nga të dy kontraktuesit.</p> <p>5. Fletëngarkesa mund të përmbajë dispozitën "sipas urdhrin" ose të jetë e shënuar në prurësin.</p>	<p>liable for damage incurred for this reason.</p> <p style="text-align: center;">Article 671 Bill of freight</p> <p>1. The contracting parties may agree to compile a bill of freight on a consignment handed over for transport.</p> <p>2. The bill of freight must contain the name and address of the sender and the carrier, the type, contents and quantity of the consignment, the value of any valuables and other expensive things, the place of destination, the sum of payment for the transport or a note that payment was made in advance, a provision on the amount by which the consignment was encumbered, and the place and day of issue of the bill of freight.</p> <p>3. Other provisions of the contract of carriage may be recorded in the bill of freight.</p> <p>4. Both contracting parties must sign the bill of freight.</p> <p>5. The bill of freight may contain a "by order" provision or may be made out to the bearer.</p>	<p style="text-align: center;">Član 671 Tovarni list</p> <p>1. Ugovarači se mogu sporazumeti da se o pošiljci predatoj na prevoz sačini tovarni list.</p> <p>2. Tovarni list treba da sadrži: ime i adresu pošiljaoca i prevozioca, vrstu, sadržaj i količinu pošiljke, kao i vrednost dragocenosti i drugih skupocenih stvari, mesto opredeljenja, iznos naknade za prevoz, odnosno zabeležku da je naknada plaćena unapred, odredbu o svoti kojom je pošiljka opterećena, mesto i dan izdavanja tovarnog lista.</p> <p>3. U tovarni list mogu biti unesene i druge odredbe ugovora o prevozu.</p> <p>4. Tovarni list mora biti potpisan od oba ugovarača.</p> <p>5. Tovarni list može sadržati odredbu "po naredbi" ili glasiti na donosioca.</p>
--	---	---



<p style="text-align: center;">Neni 672 Kontrata për transportin dhe fletëngarkesa</p> <p>Ekzistimi dhe vlefshmëria juridike e kontratës për transportin janë të pavarura nga ekzistimi i fletëngarkesës dhe nga saktësia e saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 673 Vërtetimi për marrjen në dorëzim për transport</p> <p>Në qoftë se nuk është dhënë fletëngarkesa, dërguesi mund të kërkojë nga transportuesi që t'i lëshojë vërtetimin për marrjen e dërgesës për transport me të dhënat që duhet t'i përmbajë fletëngarkesa.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 2</u> <u>MARRËDHËNIA E DËRGUESIT</u> <u>DHE TRANSPORTUESIT</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 674 Paketimi</p> <p>1. Dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, kështu që të mos shkaktohet ndonjë dëm ose të rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave.</p>	<p style="text-align: center;">Article 672 Contract of carriage and bill of freight</p> <p>The existence and validity of the contract of carriage shall be independent of the existence and correctness of the bill of freight.</p> <p style="text-align: center;">Article 673 Confirmation of acceptance for transport</p> <p>If a bill of freight is not issued the sender may request that the carrier issue a confirmation of the acceptance of the consignment for transport with the information that must be contained in the bill of freight.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 2</u> <u>RELATIONSHIP</u> <u>BETWEEN SENDER AND CARRIER</u></p> <p style="text-align: center;">Article 674 Packing</p> <p>1. The sender shall be obliged to pack the thing in the prescribed or customary manner such that no damage will occur and the safety of people and property will not be threatened.</p>	<p style="text-align: center;">Član 672 Ugovor o prevozu i tovarni list</p> <p>Postojanje i punovažnost ugovora o prevozu nezavisni su od postojanja tovarnog lista i njegove tačnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 673 Potvrda o prijemu za prevoz</p> <p>Ako nije izdat tovarni list, pošiljalac može zahtevati od prevozioca da mu izda potvrdu o prijemu pošiljke za prevoz sa podacima koje treba da sadrži tovarni list.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 2</u> <u>ODNOS POŠILJAOCA I</u> <u>PREVOZIOCA</u></p> <p style="text-align: center;">Član 674 Pakovanje</p> <p>1. Pošiljalac je dužan upakovati stvari na propisani ili uobičajeni način kako ne bi došlo do nastanka kakve štete ili ugrožavanja sigurnosti ljudi ili dobara.</p>
---	---	---



<p>2. Transportuesi ka për detyrë të paralajmërojë dërguesin për të metat e paketimit që mund të vihen re, përndryshe përgjigjet për dëmtimin e dërgesës që do të shkaktohej për shkak të këtyre të metave.</p> <p>3. Transportuesi nuk përgjigjet për dëmtimin e dërgesës në qoftë se dërguesi, megjithëse iu ka tërhequr vërejtja për të metat e paketimit, ka kërkuar që transportuesi ta pranojë dërgesën për transport me këto të meta.</p> <p>4. Transportuesi ka për detyrë që të refuzojë dërgesën në qoftë se të metat në paketimin e saj janë të tilla sa që mund të rrezikohet siguria e personave ose e të mirave, ose të shkaktohet ndonjë dëm.</p> <p>5. Për dëmin që për shkak të metës në paketim e pësojnë personat e tretë deri sa sendi ndodhet te transportuesi, përgjigjet transportuesi, ndërsa ky ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga dërguesi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 675 Shpërblimi për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin</p> <p>1. Dërguesi ka për detyrë t'i paguajë transportuesit shpërblimin për transport</p>	<p>2. The carrier shall be obliged to draw the sender's attention to any deficiencies in packing that can be noticed; otherwise the carrier shall be liable for damage to the consignment inflicted for this reason.</p> <p>3. However the carrier shall not be liable for damage to the consignment if despite being warned regarding deficient packing the sender demands that the carrier accept the consignment for transport with the deficiencies.</p> <p>4. The carrier shall be obliged to refuse the consignment if the deficiencies in the packing there of are such that they could endanger people or property or cause any damage.</p> <p>5. The carrier shall be liable for damage inflicted on third persons for reason of deficiencies in packing while the thing is with the carrier, but shall have the right to demand compensation from the sender.</p> <p style="text-align: center;">Article 675 Payment for transport and costs in connection with transport</p> <p>1. The sender shall be obliged to pay the carrier for transport and costs in</p>	<p>2. Prevozilac je dužan skrenuti pažnju pošiljaocu na nedostatke pakovanja koji se mogu opaziti, inače odgovara za oštećenje pošiljke koje bi se desilo zbog tih nedostataka.</p> <p>3. Prevozilac ne odgovara za oštećenje pošiljke ako je pošiljalac, iako mu je skrenuta pažnja na nedostatke pakovanja, zahtevao da prevozilac primi pošiljku na prevoz sa tim nedostacima.</p> <p>4. Prevozilac je dužan odbiti pošiljku ako su nedostaci u njenom pakovanju takvi da može biti ugrožena sigurnost lica ili dobara ili prouzrokovana kakva šteta.</p> <p>5. Za štetu koju zbog nedostatka u pakovanju pretrpe treća lica za vreme dok se stvar nalazi kod prevozioca, odgovara prevozilac, a on ima pravo zahtevati naknadu od pošiljaoca.</p> <p style="text-align: center;">Član 675 Naknada za prevoz i troškovi u vezi sa prevozom</p> <p>1. Pošiljalac je dužan isplatiti prevoziocu naknadu za prevoz i troškove u vezi sa</p>
---	---	---



<p>dhe shpenzimet në lidhje me transportin.</p> <p>2. Në qoftë se në fletëngarkesë nuk është theksuar se dërguesi paguan shpërblimin për transport dhe shpenzimet e tjera lidhur me transportin, supozohet se dërguesi ka udhëzuar transportuesin që shpërblimin ta arkëtojë nga marrësi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 676 Disponimi me dërgesën</p> <p>1. Dërguesi mund të disponojë me dërgesën edhe t'i ndryshojë urdhërat e përmbajtura në kontratë dhe mund t'i urdhërojë transportuesit ta ndalë transportin e mëtejshëm të dërgesës, t'ia kthejë dërgesën, t'ia dorëzojë marrësit tjetër ose ta udhëzojë në një vend tjetër.</p> <p>2. E drejta e dërguesit për t'i ndryshuar urdhërat shuhet pas arritjes së dërgesës në vendin e destinacionit, kur transportuesi i'a dorëzon marrësit fletëngarkesën ose kur transportuesi e fton marrësin që të marrë dërgesën, ose kur marrësi e kërkon vet dorëzimin e saj.</p> <p>3. Në qoftë se është lëshuar fletëngarkesa sipas urdhrit, respektivisht në prurësin, të dhënat e dërguesit nga paragrafi paraprak i takojnë ekskluzivisht zotëruesit të</p>	<p>connection with transport.</p> <p>2. If the bill of freight does not cite that the sender is paying for transport and the other costs in connection with transport the sender shall be presumed to have instructed the carrier to charge such costs to the recipient.</p> <p style="text-align: center;">Article 676 Disposal of consignment</p> <p>1. The sender may dispose of the consignment and alter the order specified in the contract, and may instruct the carrier to cease further transport of the consignment, return it thereto, deliver it to another recipient or send it to any other place.</p> <p>2. The sender's right to alter the order shall expire when the consignment reaches the place of destination, when the carrier delivers the bill of freight to the recipient, when the carrier requests that the recipient accept the consignment, or when the recipient demands the delivery thereof.</p> <p>3. If the bill of freight was issued by order or to the bearer the holder of the bill of freight shall exclusively hold the sender's rights specified in the previous paragraph.</p>	<p>prevozom.</p> <p>2. Ako u tovarnom listu nije navedeno da pošiljalac plaća naknadu za prevoz i ostale troškove u vezi sa prevozom, pretpostavlja se da je pošiljalac uputio prevozioca da ih naplati od primaoca.</p> <p style="text-align: center;">Član 676 Raspolaganje pošiljkom</p> <p>1. Pošiljalac može raspolagati pošiljkom i menjati naloge sadržane u ugovoru, te može naložiti prevoziocu da obustavi dalji prevoz pošiljke, da mu pošiljku vrati, da je preda drugom primaocu ili da je uputi u neko drugo mesto.</p> <p>2. Pravo pošiljaoca da menja naloge prestaje posle prispeća pošiljke u mesto opredeljenja kad prevozilac preda primaocu tovarni list, ili kad prevozilac pozove primaoca da preuzme pošiljku, ili kad primalac sam zatraži njenu predaju.</p> <p>3. Ako je izdat tovarni list po naredbi, odnosno na donosioca, prava pošiljaoca iz prethodnog stava pripadaju isključivo imaocu tovarnog lista.</p>
--	---	---



<p>fletëngarkesës.</p> <p>4. Personi i autorizuar që shfrytëzon të drejtën e dhënies së urdhëresave të reja transportuesit ka për detyrë t’ia shpërblejë shpenzimet dhe dëmin që i ka pasur për shkak të kësaj dhe që me kërkesën e tij t’i japë dorëzani se shpenzimet dhe dëmi do t’i shpërblehen.</p> <p style="text-align: center;">Neni 677 Drejtimi i transportit</p> <p>1. Transportuesi ka për detyrë ta kryejë transportin në mënyrën e kontraktuar.</p> <p>2. Në qoftë se nuk është kontraktuar se në cilën rrugë duhet të bëhet transporti, transportuesi ka për detyrë që ta bëjë në atë rrugë që i përgjigjet më tepër interesave të dërguesit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 678 Pengesat gjatë kryerjes së transportit</p> <p>1. Transportuesi ka për detyrë ta njoftojë dërguesin për të gjitha rrethanat që do të kishin ndikim në kryerjen e transportit dhe të veprojë sipas udhëzimeve që i merr nga ai.</p> <p>2. Transportuesi nuk është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të dërguesit,</p>	<p>4. An entitled person that exploits the right and gives the carrier a new order must reimburse the costs and damage incurred by the carrier because of this, and at the carrier’s request shall give a guarantee that the costs and damage will be reimbursed thereto.</p> <p style="text-align: center;">Article 677 Direction of transport</p> <p>1. The carrier must perform the transport according to the agreed route.</p> <p>2. If it was not agreed along which route the transport must be performed the carrier must perform the transport along the route that best suits the interests of the sender.</p> <p style="text-align: center;">Article 678 Obstacles to transport</p> <p>1. The carrier must notify the sender regarding all circumstances that could influence the transport, and act according to the sender’s instructions.</p> <p>2. The carrier shall not be obliged to act according to the sender’s instructions if</p>	<p>4. Ovlašćeno lice koje se posluži pravom da daje nove naloge prevoziocu, dužno je da mu naknadi troškove i štetu koje je imao zbog toga, kao i da mu na njegov zahtev pruži jemstvo da će mu troškovi i šteta biti naknađeni.</p> <p style="text-align: center;">Član 677 Pravac prevoza</p> <p>1. Prevozilac je dužan izvršiti prevoz ugovorenim putem.</p> <p>2. Ako nije ugovoreno kojim putem treba da se izvrši prevoz, prevozilac je dužan izvršiti ga onim putem koji najviše odgovara interesima pošiljaoca.</p> <p style="text-align: center;">Član 678 Smetnje pri izvršenju prevoza</p> <p>1. Prevozilac je dužan obaveštavati pošiljaoca o svim okolnostima koje bi bile od uticaja na izvršenje prevoza i postupiti po uputstvima koje od njega dobije.</p> <p>2. Prevozilac nije dužan postupiti po uputstvima pošiljaoca čije bi izvršenje</p>
---	---	--



<p>zbatimi i të cilave do të mund të rrezikonte sigurinë e personave ose të të mirave.</p> <p>3. Në qoftë se rasti do të ishte i tillë sa të mos mund të priten udhëzimet e dërguesit, transportuesi ka për detyrë të veprojë siç do të vepronte ekonomisti i mirë përkatësisht shtëpiaku i mirë në të njëjtën situatë dhe për këtë ta njoftojë dërguesin e të kërkojë udhëzimet e tij të mëtejshme.</p> <p>4. Transportuesi ka të drejtë për shpërblimin e shpenzimeve që kanë ndodhur për shkak të pengesave të dalura pa fajin e tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 679 Shpërblimi në rastin e ndërprerjes së transportit</p> <p>1. Në qoftë se për ndonjë shkak për të cilin përgjegjet transportuesi është ndërprerë transporti ai ka të drejtë në pjesën proporcionale të shpërblimit për transportin e kryer, por ka për detyrë që ta shpërblejë dëmin që do të krijohet për palën tjetër për shkak të ndërprerjes së transportit.</p> <p>2. Në qoftë se transporti është ndërprerë për ndonjë shkak për të cilin nuk përgjigjet askush nga personat e</p>	<p>the fulfillment thereof could endanger people or property.</p> <p>3. If the case is such that it is not possible to wait for the sender's instructions the carrier must act as the carrier would in such a position with the diligence of a good businessperson or the diligence of a good manager, and must notify the sender of such and request the sender's further instructions.</p> <p>4. The carrier shall have the right to reimbursement of the costs incurred because of obstacles arising through no fault of the carrier.</p> <p style="text-align: center;">Article 679 Payment during interruption in transport</p> <p>1. If for any reason for which the carrier is liable the transport is interrupted, the carrier shall have the right to a proportion of the payment for the transport performed, but must reimburse any damage incurred by another party because of the interruption.</p> <p>2. If the transport was interrupted for a reason for which none of the parties concerned was liable the carrier shall have</p>	<p>moglo ugroziti sigurnost lica ili dobara.</p> <p>3. Ako bi slučaj bio takav da se ne bi mogla čekati pošiljaočeva uputstva, prevoznik je dužan postupiti kako bi postupio dobar privrednik, odnosno dobar domaćin u istoj situaciji, i o tome obavestiti pošiljaoca i tražiti njegova dalja uputstva.</p> <p>4. Prevoznik ima pravo na naknadu troškova koje je imao zbog smetnji nastalih bez njegove krivice.</p> <p style="text-align: center;">Član 679 Naknada u slučaju prekida prevoza</p> <p>1. Ako je prevoz prekinut, iz nekog uzroka za koji odgovara prevoznik, on ima pravo na srazmeran deo naknade za izvršeni prevoz, ali je dužan naknaditi štetu koja bi nastala za drugu stranu usled prekida prevoza.</p> <p>2. Ako je prevoz prekinut iz nekog uzroka za koji ne odgovara niko od zainteresovanih lica, prevoznik ima pravo</p>
---	--	---



<p>interesuar, transportuesi ka të drejtë në diferencën midis shpërblimit të kontraktuar për transport dhe shpenzimeve të transportit nga vendi ku është ndërprerë transporti deri në vendin e destinimit.</p> <p>3. Transportuesi nuk ka të drejtë as në një pjesë të shpërblimit, në qoftë se gjatë transportit dërgesa shkatërrohet për shkak të fuqisë madhore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 680 Kur dërgesa nuk mund të dorëzohet</p> <p>1. Në qoftë se marrësi nuk mund të njoftohet për arritjen e dërgesës ose refuzon ta pranojë dhe në përgjithësi në qoftë se dërgesa nuk mund të dorëzohet ose në qoftë se marrësi nuk i'a paguan transportuesit shpërblimin që e ka për detyrë dhe shumat e tjera që e ngarkojnë dërgesën, transportuesi ka për detyrë ta njoftojë për këtë dërguesin, të kërkojë prej tij udhëzime dhe të ndermerrë masa të duhura për llogari të tij për ruajtjen e sendit.</p> <p>2. Në qoftë se brenda afatit të arsyeshëm personi i autorizuar nuk pranon dërgesën, transportuesi ka të drejtë ta shesë dërgesën sipas rregullave për shitjen e sendit në</p>	<p>the right to the difference between the agreed payment for the transport and the transport costs from the place where the transport was interrupted to the place of destination.</p> <p>3. The carrier shall not have the right to a part of the payment if during transport the consignment was destroyed because of force majeure.</p> <p style="text-align: center;">Article 680 If consignment cannot be delivered</p> <p>1. If it is not possible to notify the recipient regarding the arrival of the consignment, if the recipient does not wish to accept it, if it is not possible to deliver the consignment or if the recipient fails to pay the carrier the payment owed and other sums charged on the consignment, the carrier must notify the sender of such, request the sender's instructions and take all measures necessary to ensure the safekeeping of the thing at the sender's expense.</p> <p>2. If an entitled person fails to take any measures in respect of the consignment by an appropriate deadline the carrier shall have the right to sell the thing under the</p>	<p>na razliku između ugovorene naknade za prevoz i troškova prevoza od mesta gde je prevoz prekinut do mesta opredeljenja.</p> <p>3. Prevoznik nema pravo ni na deo naknade ako u toku prevoza pošiljka propadne usled više sile.</p> <p style="text-align: center;">Član 680 Kad pošiljka ne može da bude predata</p> <p>1. Ako primalac ne može da bude obavestjen o prispeću pošiljke, ili odbije da je primi, i uopšte ako pošiljka ne može da bude predata, ili ako primalac ne isplati prevoziocu dužnu naknadu i ostale svote koje terete pošiljku, prevoznik je dužan obavestiti o tome pošiljaoca, tražiti od njega uputstva i preduzeti za njegov račun potrebne mere za čuvanje stvari.</p> <p>2. Ako u primerenom roku ovlašćeno lice ne preduzme ništa sa pošiljkom, prevoznik ima pravo da je proda prema pravilima o prodaji dugovane stvari u</p>
--	---	---



<p>rastin e vonesës së kreditorit dhe të arkëtojnë kërkesat e veta nga çmimi i realizuar, ndërsa mbetjen ka për detyrë ta depozitojë në gjykatë për personin e autorizuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 681 Përgjegjësia e transportuesit ndaj dërguesit</p> <p>Në qoftë se transportuesi i'a ka dorëzuar dërgesën marrësit, ndërsa nuk e ka arkëtuar prej tij shumën me të cilën ka qenë e ngarkuar, ka për detyrë t'ia paguajë këtë shumë dërguesit, por ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga marrësi.</p> <p style="text-align: center;"><u>NËNKREU 3</u> <u>MARRËDHËNIA E</u> <u>TRANSPORTUESIT DHE</u> <u>MARRËSIT</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 682 Njoftimi i marrësit për arritjen e dërgesës</p> <p>1. Transportuesi ka për detyrë ta njoftojë marrësin pa vonesë se dërgesa ka arritur, t'ia vejë në dispozicion si është kontraktuar dhe t'i paraqesë fletëngarkesën, nëse një fletëngarkesë e tillë është lëshuar.</p>	<p>rules on the sale of an indebted thing in the event of the creditor's delay and to pay off the claims from the revenue acquired; the remainder must be deposited with the court for the entitled person.</p> <p style="text-align: center;">Article 681 Carrier's liability towards sender</p> <p>A carrier that delivered the consignment to the recipient but failed to charge the sum that was charged on the consignment must pay the sum to the sender, but shall have the right to demand reimbursement from the recipient.</p> <p style="text-align: center;"><u>SUBCHAPTER 3</u> <u>RELATIONSHIP BETWEEN</u> <u>CARRIER AND RECIPIENT</u></p> <p style="text-align: center;">Article 682 Recipient's notification of consignment's arrival</p> <p>1. The carrier must notify the recipient without delay that the consignment has arrived, place it at the latter's disposal as agreed and submit the bill of freight, if issued, to the latter.</p>	<p>slučaju docnje poverioca, i da naplati svoja potraživanja iz postignute cene, a ostatak je dužan položiti kod suda za ovlašćeno lice.</p> <p style="text-align: center;">Član 681 Odgovornost prevozioca prema pošiljaocu</p> <p>Ako je prevozilac predao pošiljku primaocu, a nije naplatio od njega svotu kojom je bila opterećena, dužan je isplatiti tu svotu pošiljaocu, ali ima pravo da traži naknadu od primaoca.</p> <p style="text-align: center;"><u>PODGLAVLJE 3</u> <u>ODNOS PREVOZIOCA I PRIMAOCA</u></p> <p style="text-align: center;">Član 682 Obaveštenje primaoca o prispeću pošiljke</p> <p>1. Prevozilac je dužan obavestiti primaoca bez odlaganja da je pošiljka prispela, staviti mu je na raspolaganje kako je ugovoreno i podneti mu tovarni list ako je izdat.</p>
--	--	--



